

**UNITED
NATIONS**
United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

**T R A N S K R I P T I
I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS
TË MBAJTUR MË 12.07.2007**

**T R A N S K R I P T
SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA
ODRŽANE 12.07.2007.GODINE**

KORRIK –JULI 2007

REND DITE

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të 28 dhe 29 qershorit 2007,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore,
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për organizmat e modifikuara gjenetikisht,
6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët nr. 2003/11,
7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës,
8. Shqyrtimi i Propozimit për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores së punës të Kuvendit të Kosovës.

DNEVNI RED

1. Usvajanje zapisnika sa predhodne sednice od 28 i 29 juna. 2007 gogine.,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta zakona o prodaji stanova za koje se poseduje stanarsko pravo,
4. Prvo razmatranje Nacrta zakona o sprečavanju sukoba interesa u obavljanju javnih funkcija,
5. Prvo razmatranje Nacrta zakona o genetski modifikovanim organizmima,
6. Prvo razmatranje Nacrta zakona o izmeni i dopuni Zakona o putevima br.2003/11,
7. Razmatranje preporuke Komisije za obrazovanje, nauku, tehnologiju, kulturu, omladinu i sport za imenovanje članova Nacionalnog odbora za nauku,
8. Razmatranje predloga za izmene i dopune Poslovnika Skupštine Kosova.

AGENDA

1. Approval of the minutes of the plenary session of date 28 and 29 Jun 2007,
2. Time for Parliamentary Questions,
3. First reading of Draft Law for Apartment sale that have Property right,
4. First reading of Draft Law for preventing conflict of interest in exercising public functions,
5. First reading of Draft Law for organisms genetically modified,

6. First reading of Draft Law for additions and changes of Law for the Roads no.2003/11,
 7. Review of the recommendation of Committee of Education, Science, Technology, Culture, Youth and Sport for anointment of members for National Science Council,
 8. Reviewing the proposal for additions and changes of Rules of Procedure of the Assembly of Kosovo.
-

KRYETARI KOLË BERISHA – Të nderuar kolegë deputetë, të nderuar ministra. Mirë se keni ardhur në seancën e sotme plenare të Kuvendit të Kosovës. Ju njoftoj se në sallë janë 73 deputetë që do të thotë se janë plotësuar kushtet për të filluar me punë. Që në fillim ju njoftoj se në pajtim me rregullën 6.2 dhe 23 të Rregullores së punës Kryesia e Kuvendit në marrëveshje me grupet parlamentare ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka propozuar rendin e ditës për seancën e sotme plenare. Xhevat Bislimi e ka kërkuar fjalën.

XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar Qeveria tashma e ka privuar qytetarin tonë nga dritat, nga energjia elektrike, por po e privon edhe nga e drejta për t'i regjistruar makinat e tyre dhe e ka privuar edhe nga një e drejtë elementare, nga e drejta për t'u informuar, prandaj unë kërkoj që Kryesia e Kuvendit dhe ju personalisht ta obligoni Qeverinë që gjatë seancave qytetarët dhe Kosova të furnizohet me energji elektrike dhe të mos privohet qytetari edhe nga kjo e drejtë elementare që e ka të garantuar me të gjitha normat dhe dokumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit, shkojmë me radhë me pikat e rendit të ditës. Fjalën e kërkon Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit. I nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë. Jeni në dijeni se tani disa herë radhazi po bëj përpjekje që në rend të ditës të shqyrtimit për t'u debatuar në këtë Kuvend Çështja e ndërtimeve ilegale kolektive të financuar nga Qeveria e Serbisë në Veriun e Kosovës nuk po zen vend. Andaj ju lutemi që vërtet këtë çështje ta marrim seriozisht duke u bazuar në kërkesat e mia paraprakisht të parashtruara më 27.03.2007 me kërkesën po ashtu të Grupit Parlamentar të LDD-së dhe të nënshkruar nga 16 deputeë të datës 10.05.2007 me vendimin e Kryesisë për t'u debatuar si pikë e rendit të ditës të datës 28 qershor si dhe kërkesës për t'u debatuar me material të prezantuar, andaj unë kërkoj nëse vërtet Kryesia e Kuvendit dhe Qeveria e Kosovës nuk e kanë materialin ashtu siç e ka dhënë në përgjigje edhe Ministria e Planifikimit Hapësinor se nuk ka mundësi të komunikojë me UNMIK-un për ta vizituar atë pjesë dhe e dyta nuk ka raporte nga Kuvendi i komunës së Mitrovicës kisha lutur edhe njëherë ju personalisht deputetët prezent që të votojnë sot që vërtet kjo çështje e rendit të ditës të merret vendim që të hyjë në rend dite dhe të përgatitet materiali me atë që unë kam propozuar dhe me atë që ju do të keni mundësi ta kompletoni për seancën e ardhshme më së largu. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Ju e dini se Kryesia e përgatit rendin e ditës dhe kjo është paraparë siç thatë edhe ju të hyjë në rend dite në një prej seancave të radhës. Nuk mendoj se ka nevojë që të votojmë tash si parlament, por në qoftë se vërtet e marrim materialin nga Qeveria dhe nga Komuna e Mitrovicës në seancën e radhës do të jetë pikë e rendit të ditës për të cilën do të debatohet.

RAMADAN KELMENDI – Kryetar, po rezulton se nëse e marrim, por nëse nuk e marrim, por unë kërkoja që e morëm se morëm me materialin që është prezantuar të debatohet dhe të merret vendimi i Kuvendit sot nga deputetë që janë prezent. Me votën e tyre le të konfirmojmë se a dëshirojmë të hyjmë dhe unë ma me këtë çështje nuk do të merrem. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Fjalën e ka Alush Gashi.

ALUSH GASHI – Faleminderit z. kryetar. Grupi Parlamentar i LDK si dhe të zgjedhurit e grupit parlamentar të LDK në Kryesinë e Kuvendit të Kosovës e ka mbështetur këtë kërkesë dhe si e tillë kjo pikë ka hyr në rendin e ditës në seancën plenare. Atë ditë nuk është debatuar dhe nuk janë kushtet që të debatohet pa përgatitje të materialit. Andaj nuk e shohim të arsyeshme që për këtë çështje të votohet, pasi që ne kemi votuar që kjo të jetë në rend të ditës dhe për ne kjo pikë debatohet menjëherë pas marrjes së materialeve. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Në seancën e kaluar kjo pikë me kërkesën e Grupit Parlamentar të AAK-së është shtyr për një seancë dhe mendoj që do të duhej kjo çështje sot të debatohet për faktin se vërtet po të vazhdojmë me shtyerje një ditë do të hiqet krejt prej rendit të ditës. Unë do ta kisha mbështetur dhe Grupi Parlamentar i PDK-së e mbështet debatin për këtë çështje pasi që Qeveria është përgjegjës se nuk ka informacione për atë pjesë, mendoj se Parlamenti duet bërë diçka për atë çështje. Dhe një çështje që dua ta shtroj dhe të kërkoj nga ju z. kryetar. Në mbledhjen e fundit të Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare është caktuar që në fillim të javës së ardhshme të debatohet për kërkesën e Grupit Parlamentar të PD për debatin që ka të bëjë me procesin politik dhe do të ishte mirë që të informohen deputetët se cila ditë është caktuar në mënyrë që deputetët për seancë të jenë të përgatitur.

KRYETARI KOLË BERISHA- Fjalën e ka Gjylnaze Syla

GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Grupi Parlamentar i Aleancës është i përkushtuar dhe e mbështet çështjen e debatit të Mitrovicës, por konsiderojmë se duhet ta kemi një bazë mbi cilën duhet diskutuar. Prandaj ne do ta mbështesim këtë që sa po të merret materiali menjëherë të vihet në diskutim në seancën e Kuvendit të Kosovës. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Teuta Sahatqija

TEUTA SAHATQIU – Faleminderit z. kryetar. Në mbledhjen e kaluar ,në të cilën e shty kjo pikë e rendit të ditës Grupi ynë Parlamentar ka qenë kundër, pasi është aprovuar në Kryesi dhe pasi ka hyrë në rend të ditës ka pasur arsye të njejtë sikurse edhe sot edhe herën e kaluar të debatohet apo të mo debatohet, d.m.th kjo shtyrje prej seancës së kaluar e deri në këtë seancë në fakt nuk ka sjellë asgjë të re dhe nuk është asnjë risi në krahasim me seancën e kaluar. Prej Ministrisë prej së cilës është kërkuar materiali nuk ka pasur mundësi siç është shprehur në shkresë për një material i cili do të kishte shërbyer për diskutim në këtë seancë, por mendoj që përveç asaj ministrie Qeveria i ka resurset tjera me të cilat kishte pasur mundësi të sigurojë një lloj të materialit në bazë të cilit do të diskutohet. Janë ministritë e tjera edhe janë kompetencat e tjera të Qeverisë të cilat do të ishte dashur të siguronin material të nevojshëm për këtë. Prandaj, kjo shtyrje dhe kjo mungesë e materialit është e pakuptimtë , është njësoj sikur që është e pa kuptimtë që Qeveria nuk ka pasur para të paguajë një autobus për 20 e më shumë muaj për banorët e Mitrovicës së Veriut, prandaj në qoftë se shtyhet dhe ajo varet përsëri prej propozuesit, atëherë do të duhej kërkuar prej Qeverisë që të ofrojë material e herën tjetër pa marrë parasysh me material apo pa material kjo çështje nuk mund të injorohet, çështja dhe jetesa e banorëve të Mitrovicës së Veriut nuk mund të injorohen për kurrfarë arsye dhe mbështes kërkesën që herën e ardhshme pa marrë parasysh.....

KRYETARI KOLË BERISHA- Fjalën e ka Xhezair Murati

DŽEZAIR MURATI – G. Predsedniče, kolege poslanici. Mi smo načelno prihvatali da konačno ova tema dođe na dnevni red Skupštine Kosova ali kako su i kolege naglasili uz jednu detalnu analizu i materiale koji će nam biti dostavljen od resornog ministarstva od opštine Mitrovica i od kabineta premirera, tako da mislimo da je naredna Skupštinska sednica prilika da uz takvu pripremu konačno raspravljamo i o problemima koji imaju građani mitrovice, tako da mi u načelu prihvatamo ovo ali uz pripremu materiala koji će na vreme biti dostavljeni. Hvala!.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ramadan a pajtohem i kështu. Fjalën e ka Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI - Doli dhe është shumë e qartë se çdo shtyrje është vonesë, me gjithë atë për hir të së vërtetës për t'u përgatitur nga institucionet të cilat janë përgjegjëse për këtë pajtohem që të shtyhet, por më së largu deri sot një javë. Ai material mund të grumbullohet dhe mund t'i adresohet çdo deputeti. Ju faleminderit!, por të votohet që të hyn edhe një herë, në mënyrë që të dihet se të gjithë deputetët janë për këtë çështje. Ju faleminderit!.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, unë kërkoj sqarim dhe dua që edhe grupet parlamentare edhe Parlamenti të dinë se ne e kemi pasur kërkesën për debat për çështjen e procesit politik. Mbledhja e Kryesisë me shëfat e grupeve parlamentare e ka caktuar për javën e ardhshme. Unë dëshiroj ta di se a do të mbahet seanca në ditën e hënë , debat lidhur me procesin politik, unë kërkoj sqarimin që unë si grup parlamentar e kam bërë kërkesën

duke i përfill të gjitha procedurat. Unë dua ta di dhe grupi parlamentar dëshiron ta din se a do të mbahet seanca apo jo, për ndryshe ne mbi bazën e përgjegjes do të marrim obligimet tona që i kemi si grup parlamentar.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Profesor Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI – Pyetja e kolegut Krasniqi iu ka drejtuar kryetarit të Kuvendit, por edhe unë po e shoh që ai direkt edhe herën e dytë nuk u përgjigj, unë ndiej përgjegjësi si anëtar i Kryesisë t'i them dy fjalë: Unë e kam përkrahur idenë për të biseduar për situatën politike rreth statusit në Kuvend. Gjithmonë, jam prej atyre që kam kërkuar përgjegjësi në çdo etapë dhe natyrisht se nuk kishte pse të mos e pranoja dhe të mos e përkrahja një ide të shfaqur në mënyrë institucionale nga Grupi Parlamentar i PDK-së.

LDK-ja përmes anëtarëve të Kryesisë dhe kryetarit të grupit parlamentar e ka përkrah këtë ide në mbledhje të Kryesisë. Sepse po kemi qef me qenë transparentë dhe unë dua të jem transparent totalisht para opinionit dhe Kuvendit.

Kryesia e Kuvendit e ka mbajtur një mbledhje, një pjesë të mbledhjes së bashku me kryetarët e grupeve parlamentare dhe një pjesë vetëm me Kryesinë, sepse ashtu e do rregullorja. Të gjithë kryetarët e grupeve parlamentare e kanë përkrahur idenë që të bisedohet, natyrisht afat nuk ka qenë e mundur të caktohet, është biseduar për mënyrën se si do të bisedohet që është e domosdoshme, që në të nuk duhet të vonohet, d.m.th. përkrahja ka qenë totale. Në mbledhjen e ngushtë të Kryesisë së vërtetë të zgjedhur të Kuvendit Ne ve na ka dalë një problem tjetër, sepse është përfaqësuesi i PDK-së që thotë se nuk është mirë që të bahet shpejt kjo dhe unë i thërras dy përfaqësuesit, tre apo sa i ka PDK-ja, ju lutem shumë mos na qitni në lojë Parlamentin, merruni vesh, a jeni ju shumë të interesuar që kjo çështje të diskutohet shpejt apo jeni të interesuar ta bëni një gjysmë propagande publike, ndërsa çështja të shtyhet, kur të merreni ju vesh si propozues, neve na keni aleat për bisedime me të gjitha kapacitetet e koncentrimin të dijeve dhe të përgjegjësive në Kuvend. Po ju them haptas ju i keni pasur dy qëndrime, nëse jo dy qëndrime, atëherë keni pasur një qëndrim, por ne u ankuam. Ju kërkon, jam unë në Kryesi që jam përpjekur me qit afate, ata që janë anëtarë të Kryesie le ta dëshmojnë dhe jam përpjekur që ta bie sa më afër nesh dhe e kam propozuar 16-shin që i bie e hane. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Z. kryetar, të nderuar deputetë. Kërkesa e Partisë Demokratike të Kosovës e nënshkruar nga shefi i grupit pas konsultimeve me grupin kemi bërë kërkesën për debat. Unë edhe një herë po e jap arsyen. Nëse gjithë bota flet për shtyrjen, për pasojat e shtyrjes dhe të një shstyrje pa kufi, për mua është e pakuptimtë që edhe deri më tani kjo çështje nuk është debatuar seriozisht në këtë Kuvend. Kërkesa zyrtare e Grupit të Partisë Demokratike të Kosovës është për të debatuar, bile jemi vonuar. Nëse individë kanë shfaqur bindjet e tyre, nuk di mbi çarë baze, por jo në Grupin e Partisë Demokratike të Kosovës ajo mund të jetë shumë individuale dhe shumë personale dhe ne si grup nuk mbajmë përgjegjësi. Unë jam shef i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike dhe zyrtarisht në këtë Parlament unë e përfaqësoj Grupin Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës dhe çdo thënie tjetër në emër të Grupit Parlamentar të

Partisë Demokratike qoftë edhe individuale për mua është e papranueshme, pa marrë parasysh se nga cili nivel ka ardhur kërkesa për shtyrje. Z. Hamiti të jem i qartë, për mua dhe Grupin Parlamentar që inicion në këtë seancë, çdo kërkesë për shtyrje është private, ta kemi parasysh dhe nuk guxon askush, as ta privatizojë procesin politik, as ta privatizojë Parlamentin dhe asnjë institucion tjetër, ju lutem është në nderin e juaj të, nderuar deputet dhe në nderin e popullit të Kosovës që ta ndërpresim sa më shpejt tendencën për ta privatizuar edhe institucionet edhe Parlamentin edhe procesin politik. Procesi politik nuk është i individit, secili e ka pjesën e vet, secili e ka hisen e vet, prandaj nëse dikujt i ka konvenuar një kërkesë private është diçka tjetër, por kërkesë zyrtare e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike që zyrtarisht e përfaqësoj unë është që ky debat të mbahet të hënën dhe ky Parlament duhet të përcaktohet sot për këtë, se çka kush thotë privatisht është çyshtje e tyre. Unë po ju them se kam deklaruar nga një kërkesë për ta shtyr debatin. Unë jam i obliguar t'u përgjigjem vetëm interesave të qytetarëve të Kosovës, asnjë interes tjetër nuk kam ardhur për ta përfaqësuar në Kuvend, kush dotë përfaqësojë edhe interesa tjera le të përfaqësojë Grupi Parlamentar dhe shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Demokratike po e them edhe një herë zëshëm e përfaqësojnë interesin e qytetarëve të Kosovës të cilët na kanë pru në këtë Kuvend, kush do ta përfaqësojë edhe t'i mbrojë interesat tjera le t'i mbrojë, ne nuk jemi të obliguar.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Një sqarim Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI – Më ka entuziazmuar z. Krasniqi që e përfaqëson vullnetin e popullit, na le edhe ne ta përfaqësojmë aq sa kemi vota vullnetin e popullit, ti e përfaqëson aq sa e ke fuqinë normalisht, për idealitete këtu nuk po flasim, këtu jemi në Kuvend. E dyta, është problemi z. Krasniqi mua më ke aleat të fortë që të bisedohet për ato probleme këtu. Unë ta thashë edhe një herë, meqë jemi në Parlament të bëhemi transparentë . Ti ende nga anëtarët e atij ekipit të famshëm që i thotë vetit strategjik e politik, d.m.th je brenda në rrjedhë. Kryetarin e partisë sate e ke në atë që quhet Grup Uniteti edhe në mbledhjen e Kryesisë me kryetarë të grupeve dhe në mbledhje të Kryesisë së Parlamentit është thënë që duhet të Parlamenti paraprakisht me atë ekip të famshëm të Unitetit, ti e di që ai ekip nuk ka mund të mblidhet. Dhe të bëhemi konkretë unë jam të bisedohet për këto probleme sa më shpejt që është e mundur, d.m.th unë ty të uroj që ta kesh grupin me vete, unë nuk e di, nuk po hy në punët e juaja, por ne jemi në Parlament dhe po them e kemi mbështetjen, tash unë po them si përfaqësues, ti fole për disa privatizime, këtu privat nuk jemi askush, e di që nuk e kishe me mue, por në princip jemi përfaqësues, s'ka përfaqësues privat, pra e kemi mbështetjen, por ekzistojnë rregullat që i keni paraqitur ju që duhet të bisedojmë me ekipin negociator ose të Unitetit si të doni quane, para se të dalim në Parlament. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit, është e vërtetë që atë ditë kur e kemi caktuar si Kryesi rendin e ditës, pasi kanë daë nga salla shefat e Grupeve Parlamentare është marrë qëndrim që Kryesia ta ketë një takim të përbashkët me Grupin Negociator dhe pastaj të caktohet seanca për debat. Me qenë se ajo mbledhje është mbajtur të enjten kur kryetari i Kosovës nuk ka qenë këtu, bashkë me kryetarin e Partisë Demokratike që kanë pasur të udhëtojnë jashtë dhe tash momentalisht janë edhe kryetari i Kosovës edhe kryeministri Çeku janë jashtë Kosovës nuk ka pasur mundësi të takohet Kryesia me

Grupin Negociator. Në momentin kur ata kthehen unë prapë do të bie në kontakt me ta dhe do të jenë të gatshëm të ulemi dhe bisedojmë për këtë çështje.

Edhe unë e shoh shumë të rëndësishme që të bisedohet dhe Kuvendi duhet të lëviz në këtë drejtim si e keni propozuar ju, por ky ka qenë qëndrimi i Kryesisë me rastin e caktimit të rendit të ditës, po përsëris, paraprakisht të takohet Kryesia me Grupin Negociator dhe pastaj të caktohet seanca e Kuvendit ku do të debatohet për këtë pikë, kjo është e tëra.

JAKUP KRASNIQI – Unë thashë për veti dhe për grupin e përfaqësojnë qytetarët e Kosovës. Një pjesë të qytetarëve të Kosovës jam i vetëdijshëm sa e përfaqësoj, por unë kam përfaqësuar edhe më pak sesa përfaqësoj tani në Parlamentin e Kosovës dhe mendoj që nuk kam bërë keq, kjo është një çështje tjetër. Sa i përket pjesëmarrjes time në grupin strategjik është diçka tjetër, unë kam qenë sekretari i Grupit të Unitetit dhe mendoj se edhe aty kam dhënë kontributin tim, por nuk dua të flas për të, por unë nuk kam qenë në pjesën vendimmarrëse, po të isha në pjesën vendimmarrëse sigurisht që do të kishte vendime të tjera, unë e kam përfillur fuqinë e vendimmarrjes edhe në Parlament, por dua të them se secili prej nesh e përfaqëson një pjesë të zgjedhësve të vetë dhe unë nuk po flas për atë pjesën e zgjedhësve të tjerëve, por unë mendoj se është interesi i qytetarëve të Kosovës që ky proces, procesi i përmbylljes së njohjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës është i të gjithë qytetarëve të Kosovës, e jo i zgjedhësve të mi, prandaj nuk është mirë që ne të luajmë tash, ta gjuajmë topin këndeje – andej, ky Parlament duhet të marrë vendim dhe nuk ka nevojë ky Parlament ta presë Grupin Negociator se kur do të jetë i gatshëm të debatohet, ne kemi përgjegjësinë tjetër, Grupi Negociator e ka përgjegjësinë e vet.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka Emrush Xhemajli.

EMRUSH XHEMAJLI – Z. kryetar. Unë po i kuptoj këto shtyrje për statusin e Kosovës në Këshillin e Sigurimit, por nuk po mund t'i kuptoj dhe nuk besoj që mund t'i kuptojëdikush prej deputetëve dhe qytetarëve këto shtyrje të njëpasnjëshme tuajat, për të debatuar në Kuvendin e Kosovës lidhur me shtyrjet që po ndodhin, se nuk janë sot këto kërkesa për t'u bërë debat dhe për t'u marrë vendime në Kuvend, jo vetëm për të bërë debat formalisht. Nga muaji qershor, në muajin qershor kanë kërkuar Grupi i Integritetit, për afërsisht të njëjtën temë, pastaj kemi kërkuar tetë deputet, atë e heshtët dhe nuk po e përmendni edhe krejt deputetët janë që të ecet përpara e jo në këtë formë. Barrën e krejt shtyrjeve është duke e bartë qytetari i thjeshtë që ajo barrë do të vjen edhe tek ne edhe te të gjitha iostitucionet, nuk është duke e paguar askush as Serbia këtë barrë të shtyrjeve as ata që ia kanë dhënë veton Serbisë në Këshillin e Sigurimit, jemi ne duke e paguar, prandaj ftoj që edhe kur të bëhet debat lidhur me shtyrjen, lidhur me procesin politik, por edhe të merren vendime të nevojshme, përkatësisht nuk po kërkoj datën e zgjedhjeve në Kosovë, por datën për shpalljen e pavarësisë së Kosovës, këtë po e kërkoj, d.m.th kjo vlen me u cekë, jo vetëm për të bërë debat, sepse të gjithë janë duke vepruar në mënyrë unilaterale, të mvetësishme për Kosovën, edhe ne që jemi Kosova nuk jemi duke vepruar në atë mënyrë, kjo nuk është në rregull.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Fjalën e ka kërkuar Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA – Faleminderit z. kryetar. Ashtu si edhe grupet e tjera, shefat e grupeve dhe Kryesia që e ka përkrah debatin për statusin e Kosovës edhe ne e kemi përkrahë dhe ashtu si e tha z. Hamiti, marrëveshja ka qenë që Kryesia të caktojë datën për të biseduar me ekipin e unitetit dhe sa më shpejt pastaj të mbahet seanca e veçantë e Kuvendit të Kosovës me të vetmën pikë të rendit të ditës, prandaj ne si grup konsiderojmë se Kryesia do të intensifikojë përpjekjet që sa më parë të takohet me Ekipin e Unitetit dhe sa më parë në Kuvendin e Kosovës të mbahet një seancë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Unë mendoj se duhet të vazhdojmë sipas pikës së parë të rendit të ditës.
Fjalën e kërkon Bislim Hoti.

BISLIM HOTI – Faleminderit z. kryetar. Unë e kam parasysh rrjedhën se si duhet të procedohet në Kuvendin e Kosovës, por dua ta ngreh para jush një shqetësim, shqetësim ky që ka të bëjë me çështjen e sigurisë e .Kjo çështje e ka kapluar tërë territorin e Hasit. Në kohën e fundit të nderuar kolegë deputetë në këtë zonë të Hasit me mbi 30.000 banorë janë shprehur me të madhe personat e maskuar, unë nuk do t'i them disa raste, por po e përmend vetëm rastin e fundit që ka ndodhur në një familje të fshatit Damjan ku personat e maskuar përveç plaçkitjeve që kanë bërë kanë marrë edhe të gjitha femrat e asaj shtëpie, kanë ushtruar dhunë, kanë maltretuar dhe kanë bërë gjënë më të keqe ashtu siç kanë bërë edhe gjatë luftës paramilitarët serb, e kam parasysh z. kryetar, por kërkoj pasi është edhe ministri këtu, policia pasi të shkoj në vendin e ngjarjes për 15 minuta, ka shkuar mbas 4 orëve vetëm e vetëm që janë ankuar se nuk kanë makina, ato të paktat makina që janë në Shërbimin Policor të Kosovës eprorët policor i marrin dhe i mbajnë nëpër shtëpi, prandaj është një gjendje e tensionuar, është një gjendje shumë e alarmuar në këto zona dhe mendoj se në një të ardhme shumë të afërt duhet të diskutohet kjo çështje për arsye se banorët e kësaj zone janë shumë të brengosur edhe ka hy paniku.. Në këto zona kanë qenë stacionet policore dhe sot nuk respektohen dhe nuk bëhen. Unë e përfundoj me kaq me që së shpejti do të dal edhe një raport ku do të procedohet në këtë Kuvend. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Fjalën e ka Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI – Faleminderit z. kryetar. Jemi në pikën shqyrtimi i rendit të ditës dhe do të duhej që diskutimi të mbahet në mënyrë strikte brenda kësaj çështje. Pa lejuar tash të hapet dhe të kthehet në debat për çështje që nuk janë të rendit të ditës. Unë mendoj që edhe me kërkesën e z. Kelmendi edhe këtu po harrohet rregulla 5 e Rregullores e cila kërkon shprehimisht prej Kryesisë që kur një grup parlamentar ose një grup deputetësh nga gjashtë e mëtejshëm bën një mocion dhe kërkon që një çështje të shtrohet në rend dite thotë shprehimisht siguron që ajo të jetë në agjendë, nuk lejon mundësi që ajo të diskutohet prej Kryesisë a duhet apo nuk duhet, nuk e ka Kryesia këtë kompetencë z. kryetar dhe kolegë të nderuar deputet, pamvarsisht se çka mendon dhe kush çka thotë dhe a ka të drejtë apo nuk ka të drejtë, është e drejtë ekskluzive e Grupit të deputetëve që nëpërmjet Kryesisë ta ketë në agjendë, Kuvendi pastaj merr vendime për debatin e pas

debatit për çështjen dhe unë mendoj që për të dy rastet duhet t'i përmbahemi kësaj fryme të rregullores, kaq kisha z. kryetar!

KRYETARI KOLË BERISHA – Faleminderit. Nazim Jashari e ka fjalën.

NAZIM JASHARI - Z. kryetar edhe unë dua të bisedoj për rend dite dhe dua të bisedoj për pikën që parasheh ndryshimin e rregullores së punës. Mendoj se kërkesat që kanë dalë nga takimi i Kryesisë me shefat e grupeve parlamentare që të hartohet dhe të diskutohet për ato ndërrime brenda komisionit të Kuvendit në mënyrë që të arrijmë një pajtueshmëri të plotë paraprakisht, para se të votohet, janë kërkesa të arsyeshme dhe kisha kërkuar nga ju që për deri sa është çështja e rendit të ditës, ajo pikë e rendit të ditës të hiqet nga rendi i ditës deri sa të ndërtohet një pajtueshmëri paraprake para se të votohet që të mos vijmë në një situatë kur rregullorja e punës ndryshohet me shumicë votash, nuk është praktikë e mirë, nuk është mënyrë e mirë e punës, rregullorja e punës duhet të na shërbej të gjithëve dhe të na siguroj kushtet e barabarta për punë, prandaj është shumë e rrugës që fillimisht të ndërtohet një pajtueshmëri e më pastaj të kalojmë në votim.

KRYETARI KOLË BERISHA- Urdhëroni prof. Daci.

NEXHAT DACI – Unë desha vetëm t'i përkujtoj deputetët dhe të pranishmit që seanca plenare është institucioni më i lartë parlamentar. Është Kryesia e Parlamentit, është kryetari i Parlamentit dhe askush tjetër, dhe po ngriten ndonjëherë tensione ose temperatura pa asnjë arsye dhe pa asnjë argument. Në qoftë se do të ishim në plotni përmbajtja e njejtë e propozuesit z. Krasniqi si shef i grupit parlamentar dhe i prof. Hamitit si anëtar anëtar i Kryesisë për përmbajtjen, nuk e shoh asnjë arsye që të mos aprovohet kërkesa që të vendoset tajmingu, të vendoset data, kur seanca plenare do të debatohet për çështjen ndoshta më të rëndësishmen prej themelimit të institucioneve të përkohshme. Me këtë seanca plenare nuk do të bënte presion në Ekipin e Unitetit, por përkundrazi do ta ndihmonte që ai të jetë i pranishëm në qoftë se e vlerëson që është e nevojshme, për ndryshe asnjë dokument nuk e obligon as Ekipin e Unitetit, as seancën plenare që njëri tjetrin ta presin. Në qoftë se janë konvergjente ato çështje duhet të kemi mirëkuptim, d.m.th në qoftë se nuk ka pajtueshmëri atëherë seanca plenare duhet ta kryej punën e vetë, në qoftë se janë tangenciale d.m.th në qoftë se përputhet Ekipi i Unitetit me propozimin e Grupit Parlamentar që e ka iniciuar këtë, nuk është e rëndësishme se a do të debatohet të hënën apo të martën, d.m.th të gjindet një kohë në qoftë se nuk janë ata të pranishëm, prandaj mos ja merrni të drejtën z. kryetar seancës plenare se për krejt kohën e funksionimit të këtij Parlamenti gjithmonë në fazat kritike të Kosovës dhe të Parlamentit kjo seancë plenare ka marrë vendim dhe është treguar gjithmonë që deputetët kanë pjekuri politike, prandaj ju them se ju e mbroni edhe autoritetin tuaj që të vendoset dhe le të votohet për një ditë që ju e shihni të arsyeshme, a është e hënë, marte apo e mërkure, unë besoj se do të ketë mirëkuptim. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Fjalën e ka Gani Koci.

GANI KOCI – Faleminderit z. kryetar, tash ma është e ditur se ky Kuvend nuk po kryen misionin dhe funksionin e vet që e ka, është shndërruar në një Hajt –pak që nënkupton folçka të duash dhe si të duash dhe mos merr asnjë vendim, në qoftë se pavarësia e Kosovës është bërë peng e të fortëve që nuk mvaret shumë prej nesh, unë konsideroj se ky Kuvend nuk do të duhej të bahet peng i çfarëdo ekipi qoftë. Të gjitha institucionet në Kosovë, por edhe Ekipi i Unitetit kanë dalë nga ky Kuvend dhe duhet t'i përgjigjen këtij Kuvendi dhe ato institucione nuk mund të përcaktojnë në asnjë rast dhe në asnjë kohë agjendën dhe punën e këtij Kuvendi. Kërkesa e Grupit Parlamentar ishte shumë e qartë, kur do të mbahet mbledhja që të diskutohet për statusin sipas kërkesës që është shtruar në të gjitha procedurat e mundshme dhe nuk do të duhej të ishte peng se kur të kthehen nga Gjermania ose nga BE sepse me fytirat që i kemi pa mbrëmë në Televizion me përfaqësuesin e politikë së jashtme të Bashkimit Evropian nuk do të na sjellin shumë lajme të mira këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA- Fjalën e ka Gjergj Dedaj.

GJERGJ DEDAJ – Faleminderit shumë z. kryetar. Të nderuar ministra, koleg deputet. Unë e kam një pyetje për ju z. kryetar nëse mundesh me u përgjigj. Që në fillim të seancës kur grupet parlamentare u deklaruan për propozimin e deputetit Kelmendi në emër të Lidhjes Demokratike të Dardanisë e kam kërkuar fjalën, nuk kam asgjë kundër që disave ua dhe fjalën nga 2-3 herë ajo është krejt në rregull, pse nuk ma jep fjalën kur e kërkoj në emër të Grupit Parlamentar për Integritim, ndërsa sa i përket çështjes së debatit për statusin asgjë nuk ka të keqe që Grupi i Unitetit që të jetë transparent e posaçërisht në Kuvend që është mirë, e Kuvendi të jetë transparent me qytetarët e Kosovës me gjithë atë nuk them asgjë të mençur as të madhe nëse i ftoj kolegët deputet që në këtë fazë të jemi shumë fleksibil, të jemi partner me miqtë tanë dhe ta ruajmë energjinë pozitive sepse kemi hyrë në një fazë shumë serioze ku sinjoralisht duhet të tregojmë jo vetë unitet në fjalë, por unitet në veprime duke e vu këtë çështje mbi çfarëdo interesi partiak dhe mbi çfarëdo interesi grupor. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Nuk jam unë ai që po mbaj peng çështjen e Kosovës ose të ndonjë pike që duhet të debatohet në Kuvend. Nuk jam unë ai që e pengoj ose e ngulfas të drejtën e debatit, përkundrazi ju dhash të drejtë të gjithëve kush kërkoi fjalën deri tash të deklarohet për atë që i intereson. Po them edhe njëherë ne mund ta caktojmë datën edhe sot, por vendimi i Kryesisë ka qenë që paraprakisht të takohet grupi negociator me Kryesinë e Kuvendit dhe ta caktoj datën kur do të mbahet Kuvendi, nuk është vendim i imi ky, është vendim i Kryesisë. Unë do të nguli këmbë që të kontaktoj me Grupin Negociator dhe të caktohet takim me ta në mënyrë që të caktohet data e një seance për të debatuar rreth propozimit të juaj që është njëkohësisht propozim i secilit deputet këtu e edhe i imi.

Sa i përket kërkesës së Mitrovicës ne u morëm vesh që me propozimin e kryetarit të grupit parlamentar që në seancën e radhës të debatohet për te dhe nuk di se çka ka nevojë tash që të votohet apo të mos votohet.

Fjalën e kërkon z. Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Në mbledhjen që ka qenë me shefat e grupeve parlamentare dhe Kryesinë, seanca e radhës është seancë e veçantë për debatin, d.m.th kjo ka mbetur dhe kjo duhet të respektohet. Çështje tjetër që dua të them po e sqaroj se unë nuk kam probleme me Grupin e Unitetit, Grupi i Unitetit e ka kryer punën e vetë, ne kemi problem me statusin politik dhe kërkesa është për të debatuar për statusin politik çka do të bëjë Kosova dhe ky Parlament që e ka përgjegjësinë kryesore. Ne nuk kemi çka të merremi as me partnerët në këtë proces, s'kemi problem as me partnerët, ne dihet se me ke e kemi problemin dhe dihet që është obligim i yni. Ky parlament sot është në nderin e tij, me gjithë atë vendos shumica, ne e respektojmë vullnetin e shumicës dhe e kemi respektuar edhe deri më tani, por duhet ta caktoj të hënën, të martën e mërkura do të ishte larg për të debatuar, prandaj nuk kemi çka konsultohemi me asnjë anëtar të Grupit të Unitetit, e as me Grupin e Unitetit, Grupi i Unitetit nuk është problemi, prandaj nuk e di pse po e futni këtu Grupin e Unitetit. Ky Parlament duhet ta bën rendin e ditës dhe të punës së tij dhe dikush jashtë këtij Parlamenti.

KRYETARI KOLË BERISHA- Fjalën e ka Xhevat Bislimi.

XHEVAT BISLIMI – Z. kryetar. Unë dua të shpreh pakënaqësinë dhe njëherit protestën time për mënyrën se si e udhëheqni dhe e caktoni rendin e ditë së Kuvendit. Nuk e keni të drejtën as kryetari e as Kryesia që atributet e Kuvendit t'ia kaloni Grupit Negociator absolutisht askush nuk ua ka dhënë këtë të drejtë. Nuk e keni të drejtën që Kuvendin e Kosovës ta shndërroni në servil të Grupit Negociator absolutisht ata duhet të jenë në shërbim të këtij Kuvendi dhe të vijnë këtu sa herë t'i fton Kuvendi e jo saherë të duan ata të thirret seanca, ju jeni të obliguar ta zbatoni rregulloren dhe rregullorja ju obligon që ju ta thirrni seancën kur e ka kërkuar një grup sipas kritereve që janë caktuar, nuk jeni ju ata që mbi bazën e voluntarizmit tuaj vendosni se kur do të mbledhet Kuvendi, por ka rregulla për këtë punë. Në qoftë se vazhdoni kështu do të thotë se e keni privatizuar dhe e keni shndërruar në një servil të Grupit Negociator e Grupi Negociator në një servil të dikujt tjetër e kështu me radhë dhe Kosova po mbetet peng i njërit dhe tjetrit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA- Ju faleminderit. Bajram Kosumi e ka fjalën.

BAJRAM KOSUMI – I nderuari kryetar, unë po besoj se të gjithë po pajtohen edhe deputetët edhe Kryesia që duhet të debatohet shumë shpejt të hënën ose të martën. Në Kryesi keni vendosur që të takoheni me Ekipin e Unitetit, shumë e kuptueshme, por ju do ta sqaroni deri në fund pozicionin për këtë takim, ky takim pse kërkohet, nëse është vetëm për t'u caktuar dasta, atëherë mendoj se datat e takimit i caktojmë ne këtu, mirren vesh sekretaria, i koordinojnë punët dhe caktojnë takimin, por unë e përkrash takimin e Kryesisë me Grupin e Unitetit para seancës, për një arsye: Grupi i Unitetit duhet të vijë në seancë dhe të bëjë një raport me shkrim dhe të tregoj vizionin e vetë, konceptin e vetë, ta sjell strategjinë e vetë se qysh do të dalim prej kësaj situatë. Grupi i Unitetit duhet të vijë këtu dhe të thotë: Z. deputet ne mendojmë se prej kësaj situatë dalim kështu, kështu, ose duhet të thonë se nuk kemi vizion dhe nuk dimë si të dalim prej situatës, ne debatojmë këtu dhe mundohemi me gjetë, me kriju vizionin se qysh do të dalim ne prej situatës, për ndryshe takimi me Grupin e Unitetit pa e kërku këtë strategji të Grupit të

Unitetit nuk ka kuptim, ndërsa vetëm për datë, ne e caktojmë datën këtu, prandaj unë kisha propozue që të votohet dita se kur do të mbajmë seancën, Kryesia e Kuvendit të takohet me Ekipin e Unitetit dhe të kërkoj nga Ekipi i Unitetit që të vijë në Kuvend me një qëndrim, me një strategji qysh do të dalim ne prej kësaj situate. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – A mendon se duhet ta dimë ne datën kur të takohemi me Grupin e Uniteti.
Fjalën e kërkon Jakup Krasniqi.

JAKUP KRASNIQI – Ne në kërkesën tonë nuk kemi kërkuar raport nga Grupi i Unitetit, ne kemi kërkuar debat në Parlament për çështjen e statusit politik, për shtyerjen e tij dhe natyrisht mbi bazën e debatit ky Kuvend duhet të merrë vendime qoftë rezolutë, qoftë deklaratë, qoftë rekomandime, por dua ta sqaroj Kuvendin ne nuk kemi kërkuar raport nga Grupi i Unitetit dhe Grupi i Unitetit mundet edhe fare mos me ardhë në Parlament vetëm nëse ata janë deputet dhe pjesë e Parlamentit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Këtë vendim e ka marrë Kryesia.
E kemi një propozim nga përfaqësuesi i Orës, që të hiqet nga rendi i ditës pika për ndryshimin e rregullores së punës.

P a u z a

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju lutem zini vendet dhe fillojmë me punë.
Të nderuar deputet. Në pauzën që kishin edhe për shkak të elektronikës e shfrytëzuam rastin që së bashku me Kryesinë dhe shefat e grupeve parlamentare të takohemi edhe njëherë dhe të bisedojmë për pikën e rendit të ditës të cilën PDK-ja e ka parashtruar. Ishte mendim i të gjithëve unanim që kjo pikë, respektivisht të bëhet përpjekje që nesër të takohemi Kryesia me Grupin Negociator në mënyrë që të caktohet data e mbajtjes së seancës për debat.

Kemi një propozim tjetër tash, propozimin e Orës që u përpoqëm të votojmë herën e parë por nuk kishte elektronikë.

Partia Reformiste Ora propozon që të hiqet nga rendi i ditës pika për ndryshimin e rregullores.

Në sallë janë 65 deputet.

Kush është për atë që të hiqet nga rendi i ditës, në bazë të propozimit të Orës.

Për18

Fjalën e kërkon Nazim Jashari.

NAZIM JASHARI – I nderuari kryetar, të nderuar koleg deputet, nuk kemi nevojë ta politizojmë sepse nuk është çështje që të politizohet. Është një çështje shumë praktike shumë e rëndësishme për mbarëvajtjen e punëve në Kuvend të Kosovës. Në mbledhjen e fundit që e kemi pasur me Kryesinë me përfaqësuesit e grupeve parlamentare kjo pikë nuk është trajtuar në pjesën që e kemi mbajtur bashkarisht, unë kam qenë përfaqësues i grupit, është vendosur që të përfshihet në rend dite pasi që kemi dalë ne. Me sa mora vesh

nga shefja e grupit tim parlamentar në Kryesi në konsultime para kësaj seance ka pasur ide që të hiqet nga rendi i ditës në mënyrë që t'i jepet mundësia një komisioni të këtij Kuvendi i cili do të përbëhet nga deputetë të këtij Kuvendi që t'i procesojë këto ndryshime edhe t'i përvetësoj, ndryshimet janë kryesisht të mira, janë plotësisht të banueshme, mirëpo për hirë të korrektësisë, për hirë të praktikës së punës në këtë Kuvend ne duhet ta ndërtojmë praktikën që të gjitha ndryshimet në rregullore të punës të mos na shkojnë pa një qëndrim paraprak të komisioneve të Kuvendit lidhur me ndryshimet e propozuara.....seanca funksionon normalisht me votë nuk kemi nevojë të shkojmë me mbivotim kur mundemi të ndërtojmë pajtueshmëri të gjërë, pra ta ndërtojmë pajtueshmërinë e gjërë në mënyrë që ta kemi dokumentin e pakontestueshëm, mbivotimet nuk na duhen kur nuk ka nevojë të kemi mbivotime.

KRYETARI KOLË BERISHA – Propozimet e deputetëve duhet të hudhen në votim.
Fjalën e ka z. Gashi.

ALUSH GASHI – I nderuari z. kryetar. Kuvendi i Kosovës punon sipas rregullores së punës. Ne këtë rend dite e kemi miratu në Kryesi me shefat e grupeve parlamentare sipas rregullores ju keni të drejtë me shkrim me kërku që kjo të hiqet e kjo nuk ka ndodh. Sipas rregullores aktuale deputeti, Kryesia mund të jepin propozime për ndërrimet të cilat vijnë në seancën plenare, ne nuk kishte me na pengu sikur të ishte shëtitur nëpër komisione tjera, por hiqet nga rendi i ditës në këtë mënyrë, edhe ju po harroni se ne kemi pasur zgjedhje edhe këto çështje nuk janë çështje që duhet koncenzus, ky është Kuvend, është e vërtetë që ne kemi treguar një zemërgjërsi për çështje statusore, por ju mos i përzini çështjet.

KRYETARI KOLË BERISHA - Urdhëroni.

NAZIM JASHARI – Nuk jam për të bërë politikë me këtë temë. Në mbledhje me përfaqësues të grupeve parlamentare nuk është marrë vendimi z. Gashi, e ki pikën e rendit të ditës se a ka qenë apo jo, ka dëshmitar tjerë, nuk kemi qenë vetëm unë e ti, nuk ka nevojë me thanë po apo jo, kjo mund të vërtetohet fare lehtë, prandaj faleminderit për zemërgjërsinë e juaj për të ndërtuar unitet, Kuvendi duhet të punoj me pajtueshmëri, sa ka mundësi, kur nuk ka mundësi mbivotimi është i ligjshëm, por në këtë rast duke marrë parasysh çështjen për të cilën po debatojmë është mirë të kemi pajtueshmëri se vini ju në situatë nesër kur jeni pakicë e ju hup në qaf sikur neve.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit. Propozimi i Orës duhet të hudhet në votim.

Votojmë me elektronikë.

Kush është për heqjen nga rendi i ditës së kësaj pike.

Votojmë tash:

Për	33
Kundër	38
Abstenime	6

Miratohet rendi i ditës.

Unë dhe shefat e grupeve parlamentare kemi një takim dysorësh jashtë ndërtesës, marrim pauzën prej 2 orësh për drek. Seanca fillon në orën 14,00.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Vazhdojmë me seancën e sotme. Sipas rendit të ditës fillojmë me miratimin e procesverbalit të seancës plenare të 28 dhe 29 qershorit 2007. Procesverbali i seancës plenare të 28 dhe 29. qershorit 2007 u është shpërndarë të gjithë deputetëve.

Pyes deputetët a kanë vërejtje në këtë procesverbal?. Zoti. Fadil Geci. Deputetit Fadil Geci, mikrofonin

FADIL GECI – Ju faleminderit! I nderuar kryesues. Unë kam vërejtjen në procesverbal. Nuk është thënë ajo që e kam thënë unë. Unë kam thënë që “klasa politike është e pandërgjegjshme si në kohën e Rrahman Morinës”. Askund nuk funksionon këtu. Unë kam qenë i vetëdijshëm çka kam thanë dhe qëndroj pas asaj. Prandaj, kërkoj prej Sekretarisë dhe këtyre që asnjë gërmë nuk kanë mundësi me e hekë ato çka e them. Në transkript është fjala. E kam thënë , qëndroj pas asaj dhe duhet të jetë aty.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Edhe unë mendoj njësoj që nuk duhet të hiqet nga transkripti asnjë fjalë e deputetëve që e thonë. Sekretaria duhet ta rishikojë edhe një herë incizimin dhe ta bëjë përmirësimin e tekstit. Ndonjë vërejtje tjetër? Nuk ka vërejtje tjetër. Konstatoj se procesverbali i seancës plenare të 28 dhe 29 qershorit me vërejtjet që u dhanë është miratuar. Urdhëro. Në rregull është.

Pika e dytë i rendit të ditës është

2. Koha për pyetje parlamentare

Kryeministrit Agim Çeku i kanë bërë pyetje deputetët: Xhevat Bislimi, Fetah Berisha dhe deputetja Safete Hadërgjonaj.

Meqenëse kryeministri nuk është këtu, ai s’ ka se si t’u përgjigjet. Pyes deputetët a janë dakord që për seancën e ardhshme të përgjigjet kryeministri apo mendojnë ta thonë ndonjë fjalë lidhur me pyetjet. Mendoj se mungesa e kryeministrit është e arsyeshme.

Konstatoj që pyetjet për kryeministrin shtyhen për seancën e ardhshme. Deputetja Sala Berisha -Shala ka pyetje për ministrin e Brendshëm, Blerim Kuçi. Urdhëroni.

DEPUTETJA SALA BERISHA- SHALA – Ju faleminderit z. kryesues. Unë këtë pyetje ia kam shtruar shumë kohë më herët, gati se një muaj ditë ministrit të Punëve të Brendshme. Pyetja ka qenë në lidhje me funksionimin e Zyrës të Regjistrimit Civil në Drenas. Nuk po e përsëris pyetjen se ka qenë edhe herën e kaluar, por për ministrin e Punëve të Brendshme kam një sugjerim. Unë e kam marrë përgjigjen se nuk është përgatitur me u përgjigje në pyetjen time, ngase paska qenë i zënë me punë tjera, me nënshkrimin e Memorandumit në lidhje me kushtëzimin e regjistrimit të automjeteve me fatura të rrymës. Në njëfarë mënyre , nuk është marrë me kryerjen e punëve të veta

që janë në kuadër të Ministrisë, por është marrë me inkasimin e rrymës etj. Unë e kam shtruar në seancën e kaluar pyetjen. Tash nuk e di a mundem të jap përgjigje ministri në lidhje me atë apo jo.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Z. ministër ,a e keni pyetjen?

MINISTRI BLERIM KUQI – Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë. E nderuara deputete Sala Berisha. Mua më duhet t’i jap vetëm disa sqarime që Sekretaria e Kuvendit, pyetjen që ju e keni parashtruar e ka, unë e kam marrë një ditë para se të mbahet seanca. Në pamundësi teknike, nuk kemi pasur mundësi teknike për t’u dhënë përgjigje. Kjo është arsyeja që në seancën e kaluar nuk i kemi dhënë përgjigje pyetjes së parashtruar. Për sot, normalisht që jam i përgatitur të jap përgjigje, sepse koha ka qenë e mjaftueshme edhe e duhur për të ma mundësuar t’ju jap përgjigje.

Sipas statistikave të vitit të kaluar për punën në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Drenas, gjatë muajve: qershor, korrik dhe gusht rritet intensiteti i vëllimit të punëve edhe numri i kërkesave për AJD-i dhe dokument të udhëtimit. Mirëpo, mbarëvajtja e punës në Qendrën Komunale të Regjistrimit Civil në Drenas është në nivelin e duhur. Kërkesat e qytetarëve janë realizuar sipas procedurave të parapara.

Ministria e Punëve të Brendshme për muajt e sezonit veror edhe këtë vit ka ndërmarrë masa për të siguruar ofrim më të mirë të shërbimeve për qytetarët e sidomos për ata që përkohësisht jetojnë jashtë Kosovës, duke hartuar programin për përsheptimin e procedurës për lëshimin e dokumente të udhëtimit për muajt: qershor, korrik dhe gusht, për qytetarët kosovarë që përkohësisht jetojnë jashtë Kosovës. Për të ndërmarrë hapa të veçantë me qëllim të ofrimit të shërbimeve më të mira në lëmin e regjistrimit dhe dokumentacionit civil, janë paraparë masat si në vijim. Në secilën qendër komunale të regjistrimit civil është caktuar një person përgjegjës për informim dhe për përkrahjen e qytetarëve nga diaspora. Është kufizuar orari i pushimeve për nëpunësit e departamenteve dhe qendrave, përveç transportit të rregullt, është siguruar transport kujdestar. Janë caktuar personat kontaktues për komunikim në mënyrë elektronike dhe telefonike me qytetarët. Është emëruar Grupi Mbikëqyrës i Ministrisë së Punëve të Brendshme për realizimin e programit. Janë hartuar forma të veçanta të raportimit në qendrat komunale të regjistrimit civil. Janë ndërmarrë veprime për informim më të mirë të qytetarëve për afatet dhe për procedurat.

Më 5.7.2007 është realizuar vizita në komunën e Drenasit ku është biseduar me kryeshefin ekzekutiv dhe me drejtorin e administratës qendrore. Në takim ishin prezentë edhe kryetari dhe zëvendëskryetari i Kuvendit Komunal të Drenasit lidhur me ndërmarrjen e masave për shtimin e efikasitetit, në ofrimin e shërbimeve më të mira për qytetarët, duke ofruar punëtorë përkrahës nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe komuna. Në takim jemi pajtuar që të ofrojmë nga një nëpunës për ndihmë dhe përkrahje qendrave komunale të regjistrimit civil.

Ministria e Punëve të Brendshme ka caktuar dhe vendosur një nëpunës për ndihmën dhe përkrahjen e qendrës komunale të regjistrimit civil. Po ashtu është duke shikuar mundësinë e dërgimit edhe një nëpunësit tjetër për të ofruar përkrahje në burim njerëzor Qendrës në Drenas. Po ashtu, nëse më lejon kryesuesi unë desha ta jap një informatë

plotësuese lidhur me informatën që e dha para jush z. Bislim Hoti, deputet i Parlamentit të Kosovës.

Shfrytëzoj rastin edhe t'iu them lidhur me këtë informatë, se në Has me rastin e keqtrajtimit të një familje, policia brenda dhjetë minutave ka qenë me dy patrulla në vendin e ngjarjes. Policia pas një kohe relativisht të shkurtër ka arrestuar dy të dyshuar kryesor. Policia nuk ka ...

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. ministër! Zonja deputete, deputetja Sala Berisha- Shala

SALA BERISHA SHALA – Ju faleminderit! Z. ministër për takimin që e keni pasur me institucionet e Kuvendit Komunal të Drenasit, jam në dijeni, po ju nuk e keni plotësuar obligimin tuaj, që 6 muaj është i zbrazët vendi për koordinator të Zyrës të Regjistrimit Civil. Punën e koordinatorit e kryen një zyrtar i thjeshtë, një ushtrues detyre, që edhe ashtu është mjaft i ngarkuar me punë. Nuk është e kuptueshme as për mua as për qytetarët atje, pse mbetet ai vend i zbrazët kur konkursi ka qenë i shpallur diku në dhjetor të vitit 2006.

Tjetër, Kuvendi Komunal ka shprehur gatishmëri për të ndihmuar në këtë rast për të vetmen arsye që t'u ofrojë shërbime cilësore qytetarëve të Drenasit. Përgjegjësia dhe obligimi është i Ministrisë suaj, përndryshe kushtet e punës dhe zyrat ku punojnë ata janë jashtëzakonisht të vështira

KRYESUEI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Fjalën e ka ministri

MINISTRI BLERIM KUQI – Është e vërtetë se konkursi ka qenë i shpallur më herët, por asnjëri prej kandidatëve që ka konkurruar në këtë konkurs nuk i ka plotësuar kriteret. Ne jemi detyruar ta përsërisim këtë konkurs. Obligimet tona ne i kryejmë ashtu siç janë paraparë me procedurat, që ekzistojnë, por ju duhet ta dini se Zyrën Qendrore për Regjistrim ende e menaxhon dhe është përgjegjës UNMIK-u. Për të gjitha procedurat rreth dokumentacionit civil ende është përgjegjës UNMIK-u. Të gjitha procedurat i përcakton kjo qendër.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Z. ministër, mendoj se neve na keni mbetur borxh procesverbalin. E keni thënë një deklaratë lidhur me suksesin e policisë në Has. Ka mbetur e paregjistruar- mendoj pjesa e fundit- kush janë aktorët e kapur nga policia?

MINISTRI BLERIM KUQI – Ju faleminderit kryesues. Unë edhe një herë do t'iu them disa detale lidhur me problemet që kanë ndodhur në Has kur një familje është keqtrajtuar dhe maltretuar prej disa personave të dyshimtë. Policia në vendin e ngjarjes ka qenë brenda dhjetë minutash, edhe atë dy patrulla. Policia në një kohë relativisht të shkurtër ka arrestuar dy të dyshimtë kryesor. Ekzistojnë edhe të dyshuar të tjerë. Asnjëherë nga të dyshuarit nuk janë nga Shqipëria.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit z. ministër. Vazhdojmë me pyetjen për zëvendësministrin Tomë Hajdaraj. Deputeti Nahit Hasani ka në pyetje.

NAIT HASANI – Ju faleminderit kryesues. Ka një muaj që është bërë pyetja, por megjithatë mua më intereson, ministër, për fshatin Vrellë të komunës së Istogut, ku kanë ndodhur vërshimet nga të reshurat atmosferike nga gryka e lumit. Për qytetarët e Vrellës është me interes, nga Ministria e Kosovës të ndërtohet një digë, e cila do ta mbrojë fshatin nga vërshimet në të ardhmen. Pyetja është: A është në dijeni Ministria për këto vërshime dhe çfarë masash do të ndërmarrë për të plotësuar kërkesat dhe për t'i ndihmuar banorët e këtij fshati për mbrojtjen nga vërshimet tjera të mundshme?

ZËVENDËSMINISTËRI I BUJQËSISË, TOMË HAJDARAJ – Ju faleminderit z. kryesues. Të nderuar deputetë, ministra, deputet Hasani, është me vend pyetja e parashtruar, por më duket se edhe brenda suazave të mundësive të Ministrisë janë ndërmarrë aktivitete lidhur me këtë rast me sukses. Në bazë të asaj që ne kemi marrë nga Kuvendi Komunal i Istogut për vërshimet në fshatin Vrellë, është formuar komisioni në nivel të përbashkët, i udhëhequr nga kryeshefi ekzekutiv dhe anëtarët, gjegjësisht zyrtarët e Ministrisë për Bujqësi, është konstatuar gjendja pas vërshimeve, flas për pjesën që i përket agrarit.

Sa i përket dëmeve në fushën e bujqësisë është bërë vlerësimi, se nga vërshimet e përrenjve janë mbulua me prurje të ujërave, do të thotë rrëzë, gurë dhe mbeturina tjera, është dëmtuar sipërfaqja prej 6.70 hektarë livadhe, perime e kultura 80 ari, misër 3.2 hektarë dhe jonxhe 0.80 hektarë, do të thotë 80 ari. Nga vlerësimet, do me thënë kemi tabelën e vlerësimit, që sipas të dhënave dhe çmimet momentale shprehur në euro kemi 8528 euro dëme të shkaktuara në sferën e agrarit. Ndërsa sa i përket pjesës tjetër, çka ka ndërmarrë Ministria e Bujqësisë për të evituar raste të tjera eventuale para Parlamentit shpreh që të hënën Ministria e Bujqësisë, në mbledhjen e stafit të lartë ka ndarë 30 mijë euro për ngritjen e digës apo pritës në Grykë të fshatit Vrellë dhe e njëjta është në procedurë dhe së shpejti do të ngritët, në mënyrë që efekti i saj të jetë i dyfishtë. Njëra të jetë për pritat, do të thotë për të mos ardhur deri te fatkeqësitë në Grykën e Mullirit që duhet dhe tjetra për ujitjen e sipërfaqeve të konsiderueshme në komunën e Istogut, gjegjësisht në fshatin Vrellë. Ju faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. zëvendësministër. Z. deputet nuk keni pyetje shtesë. Deputetja Hatixhe Hoxha ka pyetje për ministrin Bujar Dugolli. Z. Dugolli ka vënë një arsyetim që ka menduar se para dite do të kryhet kjo, e ka lënë për pas dite një takim, kështu që e shtyjme për seancën e ardhshme me miratim të deputetes. E njëjta situatë është edhe me pyetjen për ministrin Agim Veliu. Keni diçka shtesë, zonja deputete? Deputetja Hatixhe Hoxha e ka fjalën

HATIXHE HOXHA - Ju faleminderit. Po për ministrin e Arsimit megjithatë kisha dashur ta lexoj pyetjen, edhe po lexoj para jush z. kryesues. Duke pasur parasysh faktin se është nënshkruar një memorandum i mirëkuptimit në janar 2007, në mes të Universitetit të Prishtinës, Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale për lirimimin e ndërtesës së re të Fakultetit Ekonomik që gjendet në kompleksin e Universitetit të Prishtinës, duke pasur parasysh faktin se Universiteti po përballet, ndër të tjera edhe me mungesë hapësirash,

atëherë pyetja ime është për ministrin Velu - Çka po bën ai që të përshpejtohet puna, që viti i ri akademik të fillojë në ndërtesën e re të Fakultetit Ekonomik?

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Siç e dini, sipas Rregullores të gjitha pyetjet që brenda dy seancave nuk marrin përgjigje, botohen në Buletinin e radhës së Kuvendit. Mendoj që edhe kjo pikë e rendit të ditës u krye. Z. Ramadan Kelmendi është paraqitur. Keni diçka për procedurë.

RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit kryesues. Unë e dëgjova përgjigjen para se ta shtroj pyetjen. Megjithatë, që nga data 21.03 e këndej në dy pyetje të pashtuara unë nuk marr përgjigje. Është e padrejtë që ato të botohen, por kërkoj që për këto pyetje të më përgjigjeni. Ju faleminderit. Mundësi ka edhe bazë në Rregullore ka. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit! Sipas rregullit unë e citova Rregulloren, ju ndoshta mund t'i përsëritni edhe një herë të njëjtat pyetje, t'ua ndryshoni datën veç. Ju faleminderit.

Po vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për shitjen e banesave, në të cilat ekziston e drejta banesore.

Projektligji i është shpërndarë deputetëve më 11 qershor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministrin, ministri nuk qenka këtu. Kalojmë në pikën e radhës.

Pika e katërt

4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në shqyrtimin e funksionit publik.

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 14 qershor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim. Ftoj ministren Melihate Tërmkolli, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit ta prezantojë Projektligjin. Zonja ministre e keni fjalën
Ju informoj se në sallë janë 78 deputetë.

MINISTRJA MELIHATE TËRMKOLLI - Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar deputetë. Mendoj se ka herë është shtruar nevoja që të përgatitet dhe të rregullohet me ligj një fushë shumë e rëndësishme për funksionimin demokratik të institucioneve të Kosovës, respektimit të ligjshmërisë dhe shtimit të besimit të qytetarëve në institucione dhe punën zyrtarëve në to.

Në kohën kur konflikti i interesave gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare ka marrë përmasa shqetësuese apo së paku supozimet shkojnë në këtë drejtim, nxjerrja e këtij ligji fiton

peshë dhe rëndësi të veçantë, në radhë të parë në përcaktimin dhe definimin e konfliktit të interesit, në evitimin e tij, si dhe masat dhe mekanizmat për luftimi e tij e deri te ndëshkimet në rast të mos respektimit të ligjit, në rastet kur ekziston konflikti i interesit. Projektligji në esencë ka për qëllim mbrojtjen e interesit publik, pra gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare. Në Projektligj janë përcaktuar zyrtarë të zgjedhur, por edhe ata të emëruar në nivelin nacional, pra edhe lokal, të cilët u nënshtrohen dhe duhet t'i respektojnë rregullat e ligjit dhe Kodin e Mirësjelljes gjatë ushtrimit të detyrës zyrtare, duke pas për bazë interesin publik për çka janë zgjedhur apo emëruar.

Në Projektligj janë përcaktuar raportet ndërmjet interesit publik dhe atij privat të zyrtarit, si dhe detyrimet, kufizimet dhe ndalesat për zyrtarin në ushtrimin e funksionit publik.

Projektligji dhe zbatimi i tij në radhë të parë është në funksion të forcimit të besimit të qytetarëve në institucione dhe zyrtarët e tyre dhe, gjithashtu, në kontrollin e shtuar të institucioneve dhe qytetarëve në punën e zyrtarëve. Unë mund të them se Projektligji është në përputhje me parimet e legjislacionit të Bashkësisë Evropiane, ndërsa në planin financiar nuk prek në shtim të mjeteve financiare për zbatimin e tij. Megjithatë, më lejoni që të jap një shpjegim para Parlamentit rreth këtij projektligji dhe ta njoftojë Parlamentin se Projektligji çfarë është dërguar në Qeveri ndryshon nga ai që ka ardhur në Parlamentin e Kosovës dhe ato ndryshime mua më vjen keq që nuk janë bërë në harmoni me, as me kërkesat e mija dhe as me pajtimin tim për faktin se është ndryshuar mekanizmi, i cili do të bëjë zbatimin e këtij Projektligji. Përpyekjet e mia kanë qenë, që në zbatimin e këtij Projektligji të shtohet roli i Parlamentit të Kosovës përmes mekanizmave të tij dhe në rastet kur vjen tek shkëlja, mandej ajo t'i dërgohet Agjencisë Anti Korrupsion. Kjo me do qatipë po fatkeqësisht që ndodh ndonjëherë edhe në punën e Qeverisë e tjerë, qatipë që ua merr mendja ndonjëherë se janë edhe mbi Qeverinë edhe mbi krejt shtetin. I japin vetes të drejtë me bërë edhe ndryshime esenciale të natyrës së tillë edhe si tillë unë mendoj që Parlamenti i Kosovës duhet ta trajtoj seriozisht edhe thjeshtë përmes amendamentimit ta vë në suaza të asaj çfarë realisht duhet të vihet. Pra, mendoj se substanca e ligjit nënkupton miratimin e tij në parim dhe do të kërkoj nga Parlamenti që të miratohet në parim. Natyrisht për pjesën e mekanizmave për zbatimin e këtij projektligji, i cili mendoj se do të bëhet ligj, Parlamenti ta bëjë amendamentimin dhe t'i përcaktojë mekanizmat përkatës dhe ata mekanizma që mendon se më së miri do të mund ta kryenin funksionin në këtë drejtim.

Me këtë rast më duhet të kërkoj falje para deputetëve, para Parlamentit, do të thotë për këtë lëshim për mendim timin që është i papranueshëm, por gjithsesi Parlamenti është ai që do ta vendosë këtë. Unë do ta lusja Parlamentin që ta bëjë zgjidhjen më tumirë në këtë drejtim. Unë do t'i ofroj edhe Komisionit edhe të tjerëve versionin, i cili ka qenë i paraparë nga ai që ka ardhur në Parlament rreth mekanizmave, pra për zbatimin e këtij ligji. Edhe një herë po e përsëris. Mendoj se ka një substancë shumë të mirë, shumë të fuqishme dhe një nevojë emergjente që Parlamenti të miratojë një projektligj të këtillë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Ju faleminderit zonja ministre! E hapim debatin për diskutim në parim lidhur me Ligjin. Sipas renditjes dhe Rregullores fjalën e kanë përfaqësuesit e grupeve parlamentare. Zonja Nekibe Kelmendi, në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

NEKIBE KELMENDI – Ju faleminderit z. kryesues. Si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës, gjatë shqyrtimit të këtij projektligji kemi ardhur në përfundim se është hartuar një projektligj shumë i mirë dhe i rëndësishëm me të cilin rregullohen çështjet që shkojnë në dobi të funksionimit më të mirë të zyrtarëve që ushtrojnë funksione publike.

Ky projektligj, siç u tha në Memorandumin shpjegues është në përputhshmëri me parimet e legjislacionit të Bashkimit Evropian. Nga ana tjetër, sipas Kornizës Kushtetuese, Kuvendi i Kosovës është kompetent për ta nxjerrë këtë ligj dhe për t'i rregulluar çështjet, ashtu siç janë adresuar në vetë Projektligjin.

Rëndësia e këtij ligji konsiston edhe në nevojën e ndarjes së mirëfilltë të interesave publike nga interesat private dhe në krijimin e mekanizmave për parandalimin e konfliktit të mundshëm midis këtyre interesave, në ç'mënyrë do të forcohet besimi i qytetarëve në zyrtarët, të cilët ushtrojnë funksione publike, besimin në vet institucionet publike. Do të përmirësohet sjellja e zyrtarëve të institucioneve publike ndaj qytetarëve. Do të parandalohet nepotizmi në institucionet publike dhe do të krijohet një mekanizëm për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik siç është kufizimi i zyrtarëve të këtyre institucioneve për t'u marrë me veprimtari tjera.

Në këtë fazë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës ka një vërejtje për të cilën pak a shumë foli edhe sponsorja e ligjit. Kjo vërejtje ka të bëjë me pjesën e Ligjit që mban titullin: Përgjegjësitë për zbatimin e këtij ligji, konkretisht me nenet 18 deri 23 të këtij projektligji, duke gjetur se kjo çështje është e rregulluar edhe me Ligjin kundër korrupsionit nr. 2004, fraksion 34, dt. 22. prill 2005, sipas të cilit me kreun 3 të tij është rregulluar çështja e konfliktit të interesit me 9 nene. Mendojmë se e njëjta çështje nuk mund të rregullohet në mënyrat e ndryshme me dy ligje, prandaj duhet të gjendet një zgjidhje tjetër përkritazi me përgjegjësinë për zbatimin e Projektligjit, të cilin e kemi sot në rend dite. Pavarësisht nga kjo vërejtje, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet në parim dhe propozon këtë Projektligj që të miratohet në lexim të parë, kurse në fazat e më tutjeshme do ta japë kontributin e vet me amendamentimet që do t'i bëjë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit zoja deputete! Në emër të PDK-së, z. Hydajet Hyseni

HYDAJET HYSENI – Zoti kryesues, zonja dhe zotërinj deputetë. Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mirëpret dhe e përshëndet sjelljen në Kuvend të këtij ligji me rëndësi të veçantë, vërtet, jo vetëm për imazhin e Kosovës së re, siç jemi të prirur ta sforcojmë me të drejtë tash, por edhe për funksionimin e shoqërisë së re demokratike dhe sundimin e ligjit.

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e ka konsideruar prej fillimit si nevojë të pa shtyeshme rregullimin me ligj të kësaj fushe, prandaj edhe e ka iniciuar shumë kohë më parë. Pikërisht pse e konsiderojmë çështje shumë të rëndësishme, do të ishte edhe normale që prezantimi i këtij ligji të bëjë prej kryeministrit, sepse është ligj që zor mund të futet në kompetencat e vetëm një ministrie dhe jo siç është thënë edhe shprehimisht në shkresën përcjellëse, mund ta shikoni që kryeministrit eventualisht i është rezervuar roli i zëvendësit nëse ministri dhe zëvendësministri i Shërbimeve Publike do të mungonin. Sponsor i ligjeve në Kuvendin e Kosovës është kryesisht Zyra Ligjore e Kryeministrit dhe për ligjet të kësaj natyre, do të ishte mirë që të jetë niveli më i lartë.

Sido që të jetë, Kuvendit i është sjellë një ligj vërtet i mirë dhe do lavdëruar puna e Grupit punues në këtë drejtim. Përkundër kësaj mendoj se nuk ka arritur Grupi punues që t'i evitojë edhe disa mangësi e shmangie të cilat besoj se janë të korrigjueshme dhe ne do t'i korrigjojmë gjatë procesit të amendamentimit. E konsideroj të rëndësishme të them se, mendoj që në këtë proces do të ishte mirë që të punohet jo vetëm prej Kuvendit, por Qeveria dhe ministrinë përkatëse të jenë pjesë e amendamentimit, gjë që nuk na funksionon sa duhet.

Më lejoni që të theksoj shkurtimisht vetëm disa nga vërejtjet që, mendoj se do të duhej t'i kishim parasysh në shqyrtimin e mëtejshëm. Së pari edhe në këtë ligj na është lejuar një gjuhë jo ligjore, jo juridike me formula të këtilla si duhet, do të duhej, e të tjera ose është e drejtë, s'është e drejtë. Ligji dhe gjuha ligjore do shprehje të qarta. Lejohet, nuk lejohet, ndalohej, dënohet e tjera dhe mendoj që gjithkund në tekst këto do të duhej shikuar dhe korrigjuar.

Ligji ka marrë me të drejtë për bazë përvojën e vendeve fqinje dhe mendoj këtu nuk ka asgjë të keqe. E keqja është se nuk është marrë tërë ajo që do të duhej të merrej. Për shembull ligjet tjera i kanë të rregulluara edhe për secilin bartës të funksioneve të rëndësishme, sidomos të funksioneve të larta edhe veprimtarinë, funksionet, veprimet situatat, në të cilat do të mund të vinte konflikti i interesit dhe të cilat duheshin parandaluar. Në ligjin që na është sjellë, kjo mungon. E konsideroj të nevojshme që të plotësohet, duke filluar prej funksionit të presidentit të shtetit, të kryeministrit, kryetarit të Kuvendit, ministrave dhe deputetëve, po ashtu. E konsideroj të nevojshme ta theksoj edhe nevojën aktuale imediate që e kemi për të, sepse vërtet edhe ajo që ka dal kohëve të fundit në opinion për situata që janë jo dinjitoze edhe për bartësit e funksioneve më të larta, nuk i bën nderë as institucioneve të Kosovës as Kosovës si tërësi dhe as deputetëve që ose i tolerojnë ose ndonjëherë lejojnë të jenë pjesë e situatave konfliktuale të interesit që dëmtojnë edhe reputacionin e deputetëve edhe të bartësve të funksioneve tjera.

Konsideroj të nevojshme që në këtë kategori të futen edhe fushat tjera që sikur janë lënë krejtësisht jashtë, siç janë: gjyqësia, prokuroria, policia e të tjera. Ligjet e vendeve tjera i kanë të rregulluara këto dhe ne mund t'i marrim lehtë përvojat e tyre. Mendoj përsëri ta theksoj se deputetët do të duhej të jepnin shembullin pikërisht me qëndrimet

e tyre dhe me zgjidhjet edhe kur janë në pyetje çështjet që e rregullojnë çështjet e tyre dhe eventualisht konfliktin e interesave në funksionimin e deputetit.

Një mangësi tjetër, të cilën unë mendoj se do të duhej ta rishikoni veçanërisht është çështja e sanksioneve që mungon po thuaj se fare në Ligj. Pa këtë ligji atëherë humb edhe kuptimin e tij. Ligji është ligj vetëm nëse edhe është shoqëruar me masat, që në këtë rast edhe duhet të ishin të kombinuara edhe disiplinore dhe gjyqësore, por edhe dispozitat ndëshkimore, siç i kanë ligjet tjera përreth. Mendoj si edhe në ligjet tjera do të duhet bërë, po ashtu edhe përpjekje për të siguruar një lekturë adekuate. Ka shkarje gjuhësore, por ka edhe mospërputhje në përkthim që në versionet ndryshme edhe e humbin kuptimin. Mendoj, që të gjitha këto do t'i arrijmë bashkërisht t'i kompletojmë dhe t'i saktësojmë në procedurën e amendamentimit dhe me këto vërejtje dhe me ato që do të bëjmë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës e mbështet dhe do ta votojë këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. Hyseni. Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Ymer Halimi.

YMER HALIMI - Ju faleminderit kryesues, të nderuar ministra, të nderuar deputetë. Grupi Parlamentar i AAK-së, Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik e ka shqyrtuar me vëmendje dhe në parim e mbështet në procedim në Kuvend.

Ky projektligj e plotëson një fushë mjaft të ndjeshme po edhe të rëndësishme se do ta ngrit përgjegjësinë e zyrtarëve publik. Me këtë projektligj bëhet përcaktimi i rregullave, subjekteve, përgjegjësi dhe kompetencave për identifikimin, trajtimin dhe zgjedhjen e rasteve të konfliktit të interesit publik dhe interesit privat të zyrtarëve gjatë ushtrimit të funksionit publik. Po ashtu bëhet mbrojtja e interesit publik, përcaktohen raportet ndërmjet interesit publik e atij privat të zyrtarit, parashihen detyrimet, kufizimet dhe ndalesat për zyrtarin dhe ushtrimin e funksioneve publike. Rrit në të vërtetë dhe forcohet besimi i publikut në zyrtarë dhe në institucione. Ofrohet qasje dhe kontrolli i institucioneve, por edhe i qytetarëve në punën e zyrtarëve. Këtu është fjala për të gjithë zyrtarët e të gjitha ministrive dhe nuk ndahet ndonjë zyrtar ose segment veç e veç, si e mendoj parafolësi im.

Dispozitat e këtij ligji, përcaktohen rregullat e detyrueshme për t'u zbatuar nga çdo zyrtarë kur ai merr pjesë drejtpërdrejtë apo në mënyrë të tërthorët në një vendimarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik. Është fjala për konflikt të përhershëm apo konflikt i përkohshëm, por fjala për interes të individit.

Projektligji është shoqëruar të them me veprim apo interaktiv me Ligjin kundër korrupsionit dhe Kodit të Mirësjelljes për Nëpunësit Civil. Vërtet Ligji nuk i ka dispozitat ndëshkimore në shkallën që nevojitet. Projektligji është në pajtim me të gjitha standardet dhe marrëveshjet, konventat dhe detyrimet ndërkombëtare, është i përafërt me dispozitat e detyrueshme të Unionit Evropian. Ne si Grup Parlamentar i AAK-së do të japim kontributin tonë gjatë shqyrtimit në leximin e dytë dhe me ato amendamente.

Ju faleminderit për vëmendje, Besoj se ky ligj është mjaft i shkurtër , për të zgjatur më shumë se sa që e thanë të tjerët.

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit zoti deputet! Në emër të Grupit Parlamentar ORA fjalën e ka deputeti Genc Gorani

GENC GORANI – Ju faleminderit z. kryesues, të nderuar anëtarë të Qeverisë, të nderuar zonja dhe zotërinj deputetë.

Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA e mirëpret ardhjen e këtij ligji. Ne konsiderojmë se, ashtu si edhe ligji për anti- korrupsion, ky ligj është dashur të arrijë shumë më herët në Kuvend. Nuk ka dyshim se mungesa e këtij ligji ka shkaktuar paraqitjen e praktikave të dëmshme për interesin publik. Në mes tjerash edhe puna dhe efikasiteti i organeve të hetuesisë në sferën e përndjekjes së rasteve të keqpërdorimit të funksionit publik do të mund të përmirësohej me aktivizimin e këtij ligji. Është për të besuar se edhe qytetarët do ta kenë shumë më lehtë të orientohen në atë, se që quhet situatë e konfliktit potencial në mes të interesit publik dhe privat me adaptimin e këtij ligji.

Janë disa prej komenteve që kisha dashur t'i bëjë me këtë rast, duke filluar prej faktit se edhe pse në dokumentet përcjellëse të shpjegimit të këtij ligji, përmendet në veçanti se punohet në këtë, në disa nene, shqyrtohet çështja e qasjes së publikut në punët e zyrtarëve publik. Megjithatë , numri i dispozitave është i mangët dhe nuk lejon një qasje efikase, veçanërisht të mediave në këtë çështje. Unë shpresoj se do të kemi hapësirë për ta përmirësuar këtë në kuadër të punës dhe Komisionit funksional, natyrisht.

Në disa prej neneve janë disa prej komenteve, Neni 6 përkufizimi i personave të afërt në kuptim të këtij ligji është tepër i përgjithshëm, Ja sepse të konsiderohet se person i afërt me zyrtarin janë edhe të gjithë personat për të cilët, sipas bazave dhe rrethanave tjera konsiderohet se i lidh interesi me zyrtarin, nuk përmban kritere kualifikuese të sakta dhe lë vend për spekulime. Kjo do të ishte, mund ta theksoj shumë më thjeshtë , që të mos lihet vend për interpretime ose keqinterpretime. Përveç kësaj, në nenin 13, thuhet: gjatë kohës së ushtrimit të funksionit publik, zyrtari mund të ushtrojë punë nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit, kulturës dhe veprimtarisë humanitare. Neni 13.2 është fjala është tepër restriktiv dhe nuk shoh shpjegime të nevojshme se pse përjashton të gjitha veprimtaritë profesionale për një zyrtar, përveç atyre nga lëmi i shkencës, sportit, arsimit dhe siç e përmenda veprimtarive humanitare. Duhet të përcaktohen kriteret në nivel parimor. Për shembull të ndahen veprimtaritë në funksion se a janë të natyrës apo jo?

Në neni n 15.2, në rastin e deputetëve të Kuvendit të Kosovës, do të kishim propozuar që të ekzistojë një funksion i përhershëm në kuadër të Kuvendit, për interpretim kompetent të situatave të konfliktit të interesit nga deputetët. Nuk është fjala për atë që të bëhet diçka apo të konstatohet se paska ekzistuar konflikt interesi. Ne jemi duke hyrë në një funksionim të ri për deputetët. Është mirë ta kemi një zyre, të jenë kompetent brenda Kuvendit me të cilin do të kishim mundur të konsultohemi

paraprakisht. Ndoshta, nuk është e thënë që kjo të hyjë në ligj, mirëpo me ndonjë rregullore të aneks rregullores kishim mund ta thjeshtojmë dhe ta vëmë në praktikë këtë lloj të konsultimit për deputetët e Kuvendit të Kosovës.

Më pastaj në nenin 17. Ky nen i përmban 10 pika. Është veçanërisht vështirë i zbërthyeshëm, së paku aq sa jam munduar ta zbërthej në kuptim se bën referenca të tërthorta në nenet e këtij ligji dhe për mendimin tim duhet të punohet që të qartësohet funksionimi konkret i këtyre neneve. Kur them referenca të tërthorta mendoj referenca po ashtu në Ligjin për anti- korrupsion, ku faktikisht Komisioni Funkcional do të duhej të punonte paralelisht në këto dy ligje ashtu si edhe u theksua nga parafolësit e mi.

Kah fundi, neni 21 që ka të bëjë me sanksionet për shkeljet e dispozitave të këtij ligji. Ashtu si u përmend, po ashtu, nga parafolësit e mi nuk përmban dispozita konkrete mbi sanksionet e parapara për shkeljen e këtij ligji. Në fakt nuk përmban asnjë dispozitë të kësaj natyre. Kjo është edhe një mangësi serioze e tekstit të këtij ligji dhe shpresoj se Ministria nuk paragjykon me këtë se nuk do të duhej të ketë dispozita ndëshkuese.

Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA e miraton në parim këtë projektligj dhe do të marrim pjesë aktivisht në kuadër të Komisionit Funkcional për ta korrigjuar ose plotësuar këtë ligj. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. deputet. Fjalën e ka përfaqësuesi i Grupit Parlamentar të LDD-së, zoti Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI - Ju faleminderit! I nderuari kryesues, të nderuar ministra të pranishëm, deputetë. Grupi Parlamentar i LDD-së duke analizuar Propozim ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksionit publik, ka konstatuar me sa vijon: Ky propozim ligj është në pajtueshmëri me parimet e Bashkësisë së Unionit Evropian në këtë fushë, ka qëllim parimor në parandalimin e ndeshjes së interesit publik me atë privat, por në disa raste nuk ia arrijnë këtij qëllimi, Zyrtarit t'i pamundësohet realizimi i interesit privat përmes atij publik në funksionet që ushtron, paraqet zgjedhje solide të rasteve të konflikteve të interesit në të gjitha nivelet zyrtare nëse plotësohet me disa amendamente të tjera.

Pretendimi i sanksionimit të rregullave, subjekteve dhe përgjegjësve me këtë propozim ligj përkrahet nga Grupi Parlamentar i LDD-së. Kjo do të thotë se në fazën e parë të shqyrtimit përkrahja parimore për shqyrtim të mëtutjeshëm dhe me premtim se në fazën e mëtutjeshme do të begatohet dhe plotësohet me amendamente, duke mos i përsëritur kërkesat që këtu u dëgjova.

Grupi Parlamentar i LDD-së, vlerëson anët pozitive të këtij propozim ligji, dispozitat e detyrueshme që duhet të zbatohen në radhë të parë nga çdo zyrtar, pa marrë parasysh pozitën dhe statusin në shoqëri, si dhe faktin se zbatimi i tij nuk shkakton shpenzime financiare fillimisht. Nëse arrijmë të zbatojmë këtë propozim ligj, efektet e tij do të ishin me sa vijon:

- Do të mbrohet interesi i përgjithshëm publik;

- Do të definohet dallimi në mes interesit publik dhe atij privat;
- Ndalimi i këtyre interesave nga ushtruesit e funksioneve,
- Ngritja e besimit në institucionet dhe zyrtarët që ushtrojnë funksionet;
- Realizimi i kontrollimit dhe i përgjegjësisë kolektive dhe asaj individuale gjatë të ushtruarit të punës zyrtare.

Ky propozim ligj gërshetohet mirë në disa raste, por pa u plotësuar edhe me disa amendamente tjera lënë keqkuptime dhe keqinterpretime në mes Ligjit për korrupsion dhe Ligjit mbi shërbimin civil në Kosovë.

Ana negative e këtij propozim ligji është se hyrja fillon me Rregulloren, duke lënë si të dorës së dytë Kornizën Kushtetuese si mbështetje juridike. Nuk përcaktohet kufiri i paanshmërisë në momentet e caktuara të vendimmarrjes së zyrtarëve publik në mes të interesit publik dhe atij privat.

Me nenin 5 të Propozim ligjit nuk mundësohet funksionimi publik, ngase kemi vetëm formulime të përgjithshme që këtu u sqaruan dhe ky është neni më i diskutueshëm bashkë me nenin 10 dhe me nenin 17, të cilat duhet përpunuar, plotësuar po qe se dëshirohet të arrihet efekti i paraqitur.

Parimet e veprimit zyrtar me këtë propozim ligj duhet të jenë të numëruara shprehimisht dhe më të ashpra, si dhe procedurat për Agjencinë kundër Korrupsionit për të vërtetuar gjendjen faktike të konfliktit të interesit, si dhe marrjen e masave dhe formave tjera për keqpërdoruesit apo shkelësit e interesit publik në raport me interesin privat që mund të vinë. Mendojmë se në tërësi ky propozim ligj, parimisht përkrahet, ka nevojë të domosdoshme të amendamentohet dhe të plotësohet, të saktësohet me qëllim që vërtet të kemi një ligj të mirë, ashtu siç u debatua këtu. Me gjithë këto vërejtje parimore unë do të parashtroj edhe në emrin tim, por edhe të Grupit të LDD-së amendamentet, duke rikonfirmuar përkrahjen në parim. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit z. deputet! Në emër të Grupit 6 + fjalën e ka deputetja Shpresa Murati.

SHPRESA MURATI – Hvala! Pozdruvjam sve prisutne. Nacrt zakona o sprečavanju konflikta interesa tokom obavljanje javne funkcije je Zakon od posebne važnosti koji uređuje ovu značajnu oblast. Cilj ovog Narta zakona je sprečavanje konflikta interesa između javnog i privatnog interesa zvaničnika tokom obavljanje javne funkcije.

Predmet ovog zakona je odredjivanjem pravila subjekata, odgovornosti i kompetencije za identifikaciju tretiranje i rešavanje slučajeva konflikta javnog i privatnog interesa zvaničnika tokom obavljanja javne funkcije.

Odredba ovog zakona takodje odredjuje i obavezna pravila za primenjivanja od strane svakog zvaničnika, kada on učestvuje direktno ili indirektno u donošenju neke odluke. U članu 18. ovog Nacrta zakona, centralni nadležni autoritet za primenu ovog zakona je Agencija Kosova za antikorupciju. Medjutim, ono na šta moramo ponovo skrenuti pažnju

jeste to, da je verzija Nacrta zakona koju mi obrađujemo sa puno gramatičkih, pravopisnih i jezičkih grešaka tako da pojedine odredbe ovog Nacrta zakona u potpunosti gube smisao. Primera radi u izvesnim odredbama za termin rukovodilac menadžer koristi se termin starešina, kao recimo u članu 15. i 16. navela sam jedan primed a ima i dosta u čitavom tekstu Nacrta zakona. Verujemo da to nije slučaj sa verzijom na albanskom i engleskom jeziku i nadamo se da ćemo u buduće dobijati bolje obrađene materijale na našem jeziku.

Parlamentarna grupa 6+ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona i daće svoj doprinos u toku njegove dalje procedure. Hvala.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit zonja deputete. Në emër të Grupit Parlamentar për Integritet është paraqitur Vezira Emrush.

VEZIRA EMRUSH – Ja se izvinjavam. Ja se malo izvinjavam ovo kolegama tog ovde sam nešto zaglavila sa ovim. U redu. Mi smo kao Parlamentarna grupa razmatrali ovaj Zakon pročitali smo pažljivo i dajemo doznanja da je Zakon jako konstruktivan i prepotreban ovom kosovskom društvu. Efikasnost svih ovih odgovornosti ju jasno definišane kada su u pitanju konflikti interesa.

Zakon ima 24. člana, definiše cilj zakona, sprečavanje to je u stvari sprečavanje ličnog interesa. Odgovornost počinje od zvaničnika Skupštine do strana lica koje isto imaju odgovornost kada su u pitanju sukobi interesa. Definiše se u ovim članovima Zakona definišu se sve vrste konflikta interesa. Zakon mora da ima sve potrebne konkretne odredbe zakaznene mere što nažalost nema kada se krše javni interesi u koristi ličnih interesa. Zakon se delimično se do sada sprovodio na osnovu UNMIK-ove Uredbe 2001/9 sa ciljem sprečavanja javnog i privatnog interesa tokom vršenja funkcija zvaničnika.

Zakon mora da se definiše mnogo konkretnije i to kada su u pitanju kršeni interesi. Mora se uspostaviti lanac između privatnog interesa, konflikta interesa, blisko lice službenika i samog službenika i kosovske agencije za anti koorupciju. Mislim da se ovde malo ovo suštinski ne definišu pravilno kada su u pitanju finkcije i kršenja prava zakona na ime zaštite zvog ličnog interesa na štetu društvenog interesa i odredba Zakona je namensko ovako preko potrebna kosovskom društvu gde je na scenu sada zloupotreba službenog položaja od najnižeg ka najvišem nivou. Mi ćemo dalje da delimično ponovo razmatramo ovaj zakon i dostavićemo pismeno možda i amandman kako se zajedno ovo sastanemo sa Grupom za integraciju. Hvala!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Deputeti Naser Osmani e ka kërkuar fjalën. Zoti Osmani e keni fjalën.

NASER OSMANI – Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar ministra kolegë deputetë. Projektligji për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik është mjaft gjithëpërfshirës dhe i bazuar në disa nga parimet themelore të përgatitjes së një akti ligjor. Punën e bërë e vlerësoj mjaft lart, por dëshiroj që sado pak

të kontribuoj në një akt ligjor sa më kualitativ që të prodhojë efekte juridike sa më të plota dhe të gjejë zbatim në praktikë. Prandaj, do të ndalem vetëm në tri elemente themelore të këtij drafti.

Elementi i parë. Formulimi dhe konceptimi gjuhësor i disa dispozitave si bazë për interpretimin e drejtë të ligjit, për shembull të pjesa e përkufizimit. Neni 4.1. ka një formulim mjaft kompleks, nocion shumë të ngushtë dhe i akceptuar vetëm nga një kënd dhe me paqartësi gjuhësore.

Neni 7. Formulimi nuk është shumë i saktë, sepse shumë më tepër i përgjigjet nocionit të kryerjes joprofesionale të detyrave të punës dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare përgjithësisht dhe kompetencat e detyrës zyrtare. Në këtë formë tani veç hyjmë në shkeljen e parimeve të përgjithshme ligjore të ushtrimit të funksioneve publike dhe të parimeve të procedurës administrative.

I nderuari kryesues, nëse i qetëson unë e vazhdoj me fol, nëse jo po e ndërpres fjalën. Jo po më pengon zhurma të them të drejtë, po pengon zhurma e tyre të LDD-ës se jo për tjetër.

Konflikti i interesit është koncept që personifikohet në kuptimin personal dhe material me vetë bartësin e funksionit publik ose me të afërmit e tij gjatë ushtrimit të një detyre të caktuar zyrtare, që mund të ndikojë në veprimin procedural ose vendimmarrjen. Sërish në kundërshtim me këtë menjëherë edhe neni 8.2. që nuk është drejtpërdrejtë në përmbajtje të konfliktit të interesit.

Elementi i dytë- pjesa e rregullimit përmbajtjesor normativ është edhe çështja kryesore që rregullon konfliktin e interesit apo pjesa tematike normative e ligjit. Mirëpo, vërej se rregullimi nuk është i plotë, prandaj këtë pjesë më duhet ta trajtojë në dy aspekte dhe atë: nën a) Projektligji është me përshkrime të adaptuara nga fusha të tjera të rregullimit ligjor, siç është për shembull neni 11 ku përshkruhen veprimet e ndaluara për zyrtarin. Këto ndalesa kanë të bëjnë me mos keqpërdorimin e detyrës zyrtare. Pastaj janë tipike të Ligjit për parandalimin e korrupsionit, të Kodit të Mirësjelljes dhe shërbyesëve civil, të parimeve të procedurës administrative të ushtrimit të funksionit publik etj. Por edhe një nga këto parime është edhe konflikti i interesit apo drejtpërsëdrejti nuk kanë të bëjnë asgjë me formën e rregullimit për parandalimin e konfliktit të interesit.

Neni 12 është i paqartë për shkak se është bartur i shkëputur nga aktet e tjera ligjore. Në këtë kuptim është i panevojshëm dhe i pazbatueshëm në praktikë nga aspekti i rregullimit të këtij ligji.

Neni 16.3. është tipik anti – korrupsion dhe nën b) në këtë draft mungon rregullimi esencial i çështjes së parandalimit të konfliktit të interesit. Mungojnë forma dhe procedura, zgjidhja e plotë funksionale dhe operacionale për parandalimin e rasteve të mundshme, obligimi ligjor i parandalimit i shtrirë brenda sistemit institucional dhe i personave kompetent që ta mbikëqyrin këtë proces. Shtrohet pyetje atëherë çka rregullon ky projektligj më shumë se sa që është e rregulluar me parandalimin e konfliktit të

interesit me Ligjin anti-korrupsion, me Rregulloren e shërbimit civil të Kosovës dhe me aktet e tjera ligjore në fushat e caktuara dhe për institucionet e caktuara. Këtu duhet theksuar se vija ndarëse ndërmjet parandalimit të konfliktit të interesit dhe parandalimit të korrupsionit, po thuaj se është e pandarë. Përkundër shumë elementeve të përbashkëta që kanë ,megjithatë këto janë dy kategori të veçanta dhe duhet të rregulluar në mënyra shumë më përmbajtësore ,duke qartësuar kompetencat, përgjegjësitë dhe formën e veprimit procedural.

Primare për këtë ligj duhet të jetë forma e rregullimit të parandalimit të konfliktit të interesit ,zgjidhjes operationale dhe procedurale për kryerjen e funksionit publik në rastin kur ndikohet konflikti. Përndryshe, pas ndodhjes së konfliktit të interesit, atëherë si pasojë, përveç tjerash, do të kemi një kualifikim tjetër juridik dhe çështja hynë në një fushë juridike që është mjaftë e normuar me akte të tjera ligjore.

Dhe elementi i tretë është zbatimi i këtij ligji. Neni 18 përcakton autoritetin për zbatimin e ligjit Agjencinë Kosovare Anti – Korrupsion. Akumulimi i kësaj që është në një masë të caktuar vetëm në këtë institucion e pamundëson arritjen e qëllimit për çka është nxjerr ky ligj. Konflikti i interesit në ushtrimin e funksionit publik edhe detyrave zyrtare është shumë i mundur dhe i natyrshëm të paraqitet në situatat dhe momente të caktuara. Paraqitet edhe në çështje që janë të një peshe më të vogël dhe fillimisht të pahetueshme dhe këtu duhet të pasur parasysh dy situata.

Nën një, esenca e rregullimit me këtë akt duhet të jetë i atij karakteri që parandalon të gjitha veprimet që janë apo mund të janë të natyrës së konfliktit të interesit. Pra, deri në këtë moment nuk kemi shkelje ligjore, por duhet vënë murin që nuk lejon bartësin e funksionit publik të zhvillojë veprime zyrtare që kualifikohen të ndeshura me konfliktet e interesit.

Dhe nën dy, realisht ky akt në pjesën më të madhe rregullon rastet kur veç ndodh konflikti i interesit. Prandaj, edhe drejtpërsëdrejti kalon në fushën e rregullimit me ligje të tjera. Lirisht mund të paragjykojmë se shumë detyra zyrtare mund të kryhen kur ka konflikt interesi, por të mos ndikohen veprime dhe të mos kemi shkelje materiale ligjore. Mirëpo, një ligj i kompletuar nuk guxon të lejojë hapësirë që të merremi vetëm me pasojat, shkeljet aq më tepër kur me këtë ligj duhet të kemi zgjidhjen e përjashtimit të zyrtarëve nga detyra konkrete . Kur ka konflikt interesi bazuar në parimet e përgjithshme ligjore pa marrë parasysh fuqinë e ndikimit të procesit. Shikuar në tërësi vlerësoj se ky ligj duhet të rishikuar edhe një herë në të tri elementet themelore të cilat i përmenda. Të përpunohet dhe të adaptohet sakt në formën dhe natyrën e rregullimit të parandalimit të konfliktit të interesit dhe zgjedhjet e situatave në mënyrë që pastaj të kemi një ligj të efektshëm dhe zbatueshëm në praktikë dhe që arrin qëllimin e nxjerrjes së këtij ligji. Ju falënderoj ,zoti kryesues që patët vëmendjen të më dëgjoni.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit zoti deputet. Për fjalë është paraqitur deputeti Fetah Berisha. I fundit është Gani Koci, si diskutues.

FETAH BERISHA – Zoti kryesues, të respektuar ministra në veçanti zonja ministre, të çmuar kolegë deputetë. Të gjitha ligjet janë të rëndësishme për shtetin e Kosovës, ngase Kosova mëton të jetë shtet ligjor, shtet ku sundon ligji dhe jo individi. Por, projektligji që sot ne në këtë seancë po debatojmë është i një rëndësie të veçantë, ngase bën mbulimin e lëmin e konfliktit të interesit. Në fazën që po kalon Kosova, në rrethanat e zhvillimit të proceseve në Kosovë, në Kosovë mund të ketë edhe konflikt interesash, mund të ketë, mbase edhe ndonjëherë korrupsion. Prandaj, ndërhyrja me këtë ligj për të evituar konfliktin e interesave dhe dobësitë e tjera janë të rëndësishme me ligj. Këtu është me rëndësi të përmendet, sepse të mbrohen dhe interesat publike nga ato individuale dhe private.

Projektligji mbron raportet e drejta ndërmjet interesit publik dhe atij privat. Pastaj janë detyrat dhe përgjegjësitë për funksionimin publik, forcimi i besimit të qytetarëve tek zyrtarët dhe institucionet publike dhe kontrolli i institucioneve nga zyrtarët e ndryshëm. Kjo me qartë shihet te neni 8 deri në nenin 14 ku edhe janë përcaktuar parimet e veprimet e zyrtarëve gjatë funksionimit të raporteve të situatave të ndryshme të konflikteve të interesit. Këtu në nenin 18 është sqaruar çështja e funksionimit dhe e kompetencave të Agjencisë Kosovare Anti-korrupsion. Ky projektligj sado që i ka specifikat e veta është i afërt edhe me ligjet e tjera si është Ligji kundër korrupsionit, Kodi i Mirësjelljes Civile e të tjerë. Për herë të parë për këtë projektligj thuhet se kanë marrë pjesë në përpilimin e tij vetëm ekspertë nga institucionet më të rëndësishme të vendit. Mirëpo, gjithashtu, thuhet se ky projektligj është harmonizuar me standardet ndërkombëtare. Po ashtu, ky projektligj është në pajtueshmëri të plotë me Kornizën kushtetuese. Pastaj ky projektligj nuk cenon asnjë parim të legjislacionit të Bashkësisë Evropiane. Mirëpo, projektligji në fjalë, natyrisht ka edhe të metat e veta. Nenet në këtë projektligj janë të stërzgjatura. Në nenin 5 sidomos duhet të hiqen numrat romakë dhe ato shkronjat me i, Pra, të evitohen shumë gabime gjuhësore, aty kur bëhet numërimi i zyrtarëve të Kosovës. Mirë e tha edhe ministresha se ky projektligj duhet të përpunohet më thuktë gjatë amendamentimit, sepse ka vende që dëshmojnë për zbrazëti të cilat duhet të evitohen.

Sidoqoftë, projektligjin e mbështesim në parim dhe ky projektligj do të votohet në parim në Kuvendin tonë. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Zoti Koci.

GANI KOCI – Faleminderit z. kryesues. Nga shumë diskutues u tha edhe sikur është bërë praktikë se ligji është në përputhje me standardet ndërkombëtare, me konventat, me traktatet, marrëveshjet. Dua t'ju përkujtoj se nuk ka asnjë konventë ndërkombëtare për konfliktin e interesit publik dhe atij privat, nuk ka asnjë traktat, nuk ka asnjë marrëveshje. Janë vetëm disa udhëzime të Organizatës Evropiane për Zhvillim dhe Bashkëpunim mbi bazën e të cilave vendet, siç është edhe vendi ynë, kanë miratuar Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit të shërbyesve civilë ose të administratës shtetërore. Në kuadër të kësaj unë konsideroj se Qeveria ka bërë mirë që e ka prurë këtë projektligj dhe si i tillë do të duhej të miratohet në parim. Problemi ekziston në atë se u tha se nuk të bëjë me korrupsionin ose nuk ka lidhje me korrupsionin si ligj i tillë. Në këto parime dua

ta lexoj vetëm një që t'ua përkujtoj deputetëve këtu. Thotë se: konflikti i interesit nuk është ipso fakto korrupsion, por ka një njohje në rritje të konfliktit midis interesave private dhe detyrave publike të zyrtarëve publikë dhe në qoftë se këto nuk menaxhohen drejt atëherë çojnë deri te korrupsioni. Në qoftë se është kështu, atëherë domosdo ky ligj duhet të futet në pakon e ligjeve që parandalojnë korrupsionin, me një fjalë dhe që krijojnë efikasitet të administratave publike shtetërore.

Unë konsideroj se këtë projektligj e përshkrijnë shumë mangësi. Në përgjithësi është ligj me dispozitat e përgjithësuara, gjë që nuk kanë ligje të tjera, nuk është kështu të ligjet e vendeve të tjera. Në këtë drejtim propozuesi është dashur të ketë parasysh këtë fakt, sepse kështu si i përgjithësuar nuk përcaktohen qartë përgjegjësitë, obligimet, detyrat e shërbyesve civilë në parandalimin e këtij konflikti të interesave publike me ato private.

Ky ligj vetëm në mënyrë të përgjithësuar e përkufizon këtë konflikt. Përkufizimi është marrë drejtpërdrejt nga këto udhëzime që i përmenda pak më herët, që është mirë që është marrë nga ato, por nuk përkufizon se çka interes faktik. Çka është konflikt faktik i interesit. Çka është konflikt në duke interesit që në këto udhëzime i gjen shumë qartë dhe shumë mirë, çka është konflikt i mundshëm i interesit konflikt rast për rast i interesit, konflikt i vazhdueshëm interesit që për gjitha këto raste që edhe si definicione po edhe si dispozita i gjejmë në shumë ligje të vendeve tjera. Unë para vetes kam ligjin e Shqipërisë edhe të Kroacisë që i përshkruajnë këto gjendje dhe këto raste mjaft qartë dhe mjaft decisive.

Po ashtu dispozitat e këtij projektligji nuk i përcaktojnë qartë dhe në mënyrë decisive detyrimet, rregullat që do të duhej të zbatohen zyrtarët, në mënyrë që t'i shmangen konfliktit të interesit.

Agjencia Anti-Korrupsion, si mekanizëm, si institucion që është lanë ta implementojë këtë ligji ose të punojë mbi bazë të këtij ligji, duke pasur parasysh vetë punën e Agjencisë dhe Ligjin anti-korrupsion dyshoj që kjo agjenci me këto kapacitete të veta menaxhuese sot mund ta menaxhojë edhe këtë projektligj. Unë them se ky projektligj do të mund të menaxhojë edhe të implementohet drejt në qoftë se përfshihen të gjitha institucionet vendore dhe bëjnë përpjekje të krijojnë mekanizma që brendapërbrenda ta përcjellin dhe ta regjistrojnë ose ta evitojnë ta parandalojnë konfliktin e interesave. Çdo institucion i administratës publike, varësisht nga natyra aktivitetit të tij duhet që të parandalojë vetë mundësinë e rënies në konflikt. Për këtë arsye duhet ndërtuar edhe mekanizma të brendshëm, gjë që nuk e thotë ligji brenda këtyre institucioneve nëpërmjet akteve të ndryshme, rregullore dhe letrave të tjera, në mënyrë që titullarët e këtyre institucioneve t'i kenë parasysh dhe të veprojnë mbi bazë tyre. Them se Agjencia sot për sot nuk ka kapacitete të mjaftueshme edhe për një fakt. Në shkresën e këtij projektligji thuhet se nuk ka implikime buxhetore. Unë dua t'ju përkujtoj deputetë të nderuar, se me buxhetin që është miratuar për vitin 2007, ajo agjenci nuk është në gjendje ta implementojë as Ligjin anti-korrupsion që e ka detarë dhe obligim të parë.

Qeveria, respektivisht Ministria e Financave nuk ka respektuar as vendimin e këtij Kuvendi lidhur me buxhetin e asaj agjencie kur në vendim të këtij Kuvendi është thanë se

ajo agjenci do të duhej deri në fund të vitit të ketë 35 punëtorë në te, ndërsa sot ka vetëm 8 me mundësi deri në 15. Prandaj ,do të duhej thirrur ministri dhe kryeministri në përgjegjësi pse nuk është zbatuar vendimi i këtij Kuvendi në miratimin e buxhetit për vitin 2007 i datës 23 dhjetor të vitit 2006. Në këtë drejtim duhet të përmendi edhe disa fakte të tjera - pjesa të sanksionet është shumë e paqartë dhe shumë e papërcaktuar. Në një farë mënyre ky ligj nuk ka fare sanksione. Ne e dimë se te konflikti i interesin ndoshta mund të qon deri te kryerja e veprës penale atje ku di unë edhe për cilat përcaktohen me ligje tjera. Por unë konsideroj do të duhej të përcaktoheshin qartë se cilat janë ato masa administrative që duhet të merren ose merren nga zyrtarët, në qoftë se ka gjendje të tilla dhe cilat janë ato masa disiplinore, po edhe në formë të gjobitjeve që kanë edhe praktikant e vendeve të tjera dhe ligjet e vendeve të tjera, të cilat i parashikojnë këto.

Një element tjetër që do të duhej pasur parasysh gjatë kësaj është se duhet të ketë një monitorim të vazhdueshëm në zbatimin e këtij ligji, përndryshe nuk mund të kemi parandalim të konfliktit të interesit dhe as veprime të tjera deri te ato korruptive. Shtetet e tjera kanë edhe ligj të veçantë për regjistrimin dhe mbajtjen e pasqyrave të pasurive të zyrtarëve. Ne e kemi Ligjin anti-korrupsion, por edhe vendet tjera kanë Ligjin anti-korrupsion. Unë konsideroj se do të duhej një ekip ,ndoshta i veçantë, që të bëjë harmonizimin ose përmirësimin e Ligjit anti-korrupsion me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesave dhe nxjerrjen e ligjit të veçantë për regjistrimin dhe mirëmbajtjen e pasqyrave të pasurive, jo në mënyrë periodike ,vit pas viti,por që të jenë të përditshme dhe të përjavshme. Ju faleminderit!

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit zoti deputet. Lus deputetë që nuk janë në sallë të kthehen në qoftë se e shohin të domosdoshme me votua. Regjia, sa deputetë janë në sallë, ju lutem. Në sallë brenda janë 70 deputetë. Zonja ministre do fjalën. Urdhëroni.

MELIHATE TËRMKOLLI – Faleminderit z. kryesues. Unë shpreh një falënderim të madh për gjithë deputetët këtu dhe jam shumë dakord me shumicën e vërejtjeve që janë dhënë, sepse kujtoj janë në funksion të një ligji më cilësor, një ligj shumë i rëndësishëm për Kosovës edhe për institucionet e Kosovës. Ka disa çështje, ndoshta, të cilat është mirë të sqarohen, nuk i referohet ligji vetëm shërbyesve civil por ka të bëjë do të thotë me të gjitha kategoritë e personave që ushtrojnë detyrë zyrtare, përfshirë këtu edhe deputetë, ministrat, prej kryetarit të Kosovës etj. Natyrisht unë edhe një herë po e shpreh keqardhjen për ato të cilat kanë qenë në ligj dhe që dikujt i ka ardhur nxehtë edhe i ka hequr nga ky ligj. I ka ardhur nxehtë edhe në rastin e sanksioneve, sepse shumë mirë kanë qenë të parapara sanksionet ,duke filluar nga masat disiplinore- administrative deri te dorëheqja, largimi, dënimi me të holla edhe te masat e tjerat për rastet më të rënda. Kështu po shpreh një keqardhje ,sepse në mënyrë shumë decrive kanë qenë krejt këto të parapara në dokumentin -variantin e ligjit, i cili është dërguar dhe që është gjymtuar, thjeshtë është gjymtuar kur ka ardhur në Parlament. Unë dua të besoj që Parlamenti do të gjejë zgjidhjen më të mirë dhe to të parashih sanksionet, procedurat edhe formën e zhvillimit apo formën e parandalimit të konfliktit të interesit. Edhe një herë ju falënderoj shumë dhe natyrisht, besoj në përkrahje.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Ju njoftoj se në sallë janë 78 deputetë. Lus regjinë që të bëhet gati dhe bashkë me deputetë për të votuar. Votojmë tani.

Për..... 66;
Kundër..... 4;
Abstenim..... 1.

Konstatoj që Ligji në parim është miratuar.

Prandaj ,në bazë të rregullave 23 dhe 35, Kuvendi ngarkon këto komisione:

Komisionin për Shërbime Publike, Administratë Lokale dhe Media si Komision Funksion dhe Raportues.

Komisionin për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese.

Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe

Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë të shqyrtojnë Projektligjin dhe Kuvendit t'i paraqesin raportin me rekomandime sipas rregullës 35.6.

Tani të nderuar deputetë unë ju kërkoj falje. Ne e kaluam pikën e tretë të rendit të ditës për shkak se u vonua pakës ministri. Tani është kthye në sallë dhe rikthehemi te pika e tretë e rendit të ditës për të shqyrtuar.

3. Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore

Projektligji u është shpërndarë deputetëve më 11 qershor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij në parim.

Ftoj ministrin Ardian Gjini që në emër të Qeverisë së Kosovës para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin. Urdhëron z. ministër.

MINISTRI ARDIAN GJINI - Faleminderit z. kryesues, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës.

Ky ligj vjen si pjesë e pakos së ligjeve të cilat kanë qenë të përfshira në Ligjin për banim, të cilin Kuvendi i Kosovës e ka kthyer më 23.2.2006 me arsyetim se përmban kosto të lartë buxhetore dhe duhet të rishikohet. Ai ligj është ndarë në tri pjesë dhe do të procedohet në Kuvend si vijon ,do të thotë do ta kemi Ligjin për programet e banimit social, Ligjin për shitjen e banesave për të cilat ekziston e drejta e shfrytëzimit dhe Ligjin për shfrytëzimin e administrimit dhe mirëmbajtjen e pjesëve të përbashkëta në ndërtesa dhe të pajisjeve të përbashkëta në ndërtesa.

Ligjin të cilin sot e procedojmë është Ligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore. Do të thotë Ligji rregullon shitjen e banesave për ata njerëz të cilët banojnë në ato banesa për një kohë të gjatë dhe i referohet ligjeve, kryesisht ligjit të vitit 1983 sipas të cilit njerëzit e fituar të drejtën e banimit, mirëpo ato banesa kanë qenë pronë shoqërore dhe nuk kanë mund që t'i përkthejnë në pronë të vetën.. Kjo është esenca

e ligjit .Ajo që tentojmë të rregullojmë me këtë ligj është që të drejtat e shfrytëzuesve të banesave të mos cenohen, mirëpo që në të njëjtën kohë ato të kthehen në pronë të përhershme të shfrytëzuesve, në mënyrë që ata të mund t'i shfrytëzojnë edhe për qëllime të tjera nëse kanë nevojë, jo vetëm për banim.

Ligji përmban elementet të cilat e përshkruajnë mënyrën e shitjes,që i përkufizojnë edhe masa e çmimit të banesës. E përkufizojnë edhe mënyrën e identifikimit të pronarëve ose të shfrytëzuesve të cilët do të kenë të drejtë që t'i blejnë ato banesa e çështje tjera të cilat me siguri se secili prej jush i kemi parë para vetes me këtë projektligj.

Deri më tani nuk kemi pas provizion të tillë. E dimë se ka çështje të cilat do të mund të ishin të ndjeshme në raste të ndryshme, mirëpo unë mendoj tani më është koha që një ligj i tillë, i cili vazhdon të jetë mungesë mund të them që nga viti 1992 – 1993 të procedohet të kalohet në Kuvend dhe të jetë i zbatueshëm. Prej vitit 1983 e këndeje kemi probleme të akumuluar me banim, mirëpo mendoj se jemi në rrugë shumë të mirë që përmes këtij ligji t'i zgjidhim. Faleminderit.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit zoti ministër. Ftoj tani përfaqësuesit e grupeve parlamentare të ngarkuar për të dhënë vlerësime lidhur me ligjin e paraqitur. Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës është paraqitur Shaban Halimi.

SHABAN HALIMI – I nderuari zoti. kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolege e kolegë deputetë. Materia të cilën do ta rregullojë Projektligji për shitjen e banesave me të drejtë banesore është një materie, që ka qenë e rregulluar me Ligjin mbi banimin të vitit 92 të ish -pushtetit dhe të Ligjit mbi marrëdhëniet banesore të vitit 83 dhe ndryshimet të cilat janë bërë në vitin 86. Me këto ligje që i përmenda qytetarët e Kosovës në përgjegjësi janë pru në raporte jo të barabarta me qytetarë të tjerë ,të cilët kanë konsideruar veten pronarë . Unë mendoj se ky projektligj rregullon një çështje jashtëzakonisht të rëndësishme për shitjen e banesave të cilat kanë të drejtën banesore. Ky ligj përcakton shumë qartë rregullat , normat dhe procedurat administrative gjatë shitjes së banesave. Gjithashtu jo vetëm të banesave, por edhe të hapësirave të tjera që shoqërojnë banesat, hapësirat dhe pajisjet e tjera që gjenden në këto banesa. Gjithashtu me këtë ligj rregullohen dhe çmimet, por fitimi i së drejtës banesore. Unë mendoj se kjo problematikë ka qenë aktuale në përgjithësi për organet tona pas luftës, sepse kemi pasur organizata shoqërore dhe organizata të tjera publike të cilat me participim të punëtorëve kanë bërë ndërtimin e banesave ku qytetarët tanë në përgjithësi shqiptarë kanë fituar të drejtat e banimit dhe më pastaj u është marrë ajo e drejtë që edhe më tepër ka vështirësuar punën dhe jetën e atyre qytetarëve. Pra ky Ligj është jashtëzakonisht i rëndësishëm, sepse rregullon një çështje mjaft të rëndësishme për qytetarët tanë ,e që është edhe e rëndësishme edhe për institucionet tona gjyqësore.

Prandaj ,Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike jep votën e vet pro në parim dhe sigurisht se do të marrë pjesë aktive në komisionet funksionale gjatë amendamentimit .Pra, do t'i kemi parasysh të gjitha vërejtjet që do të jepen nga ana e deputetëve në këtë Parlament. Faleminderit zoti kryesues.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit. Në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, deputetja Nerxhivane Dauti.

NERXHIVANE DAUTI – Ju faleminderit zoti kryesues. Rë nderuar kolegë deputetë ,ju përshëndes të gjithëve. Ligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore rregullon një fushë të rëndësishme, me qenë se në Ligjin e banimit të Serbisë të vitit 1992 shumë punëtorë të Kosovës janë privuar nga e drejta e privatizimit të banesave për shkak të largimit të dhunshëm nga marrëdhënia e tyre e punës . Me anë të këtij projektligji krijohen parakushte në krijimin e të drejtave të barabarta me privatizuesit e banesave deri në vitin 1999.

Qëllimi kryesor i këtij projektligji është zgjidhja përfundimtare e çështjes së shitjes së banesave në pronësi shoqërore . Me krijimin e kësaj baze ligjore përfundon një proces sa i rëndësishëm aq edhe i ndërlikuar nga fusha e banimit. Ligji i propozuar përcakton rregullat dhe procedurat administrative për mënyrën e shitjes së banesave në të cilat ekziston e drejta banesore së bashku me pjesët e përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës, si dhe mënyrën e përcaktimit të çmimit shitës të banesës dhe shuarjen e të drejtës banesore.

Ligji ia ofron mundësinë çdo bartësi të së drejtës banesore, shfrytëzuesit të banesës në pronësi shoqërore apo publike që të mund të paraqesë kërkesë me shkrim për blerjen e banesës bartësit së të drejtës që ka në dispozicion banesën në pronësi shoqërore ,përkatesisht pronarit të banesave publike. Ligji në mënyrë precize e parasheh edhe afatin kohor për mundësinë e lidhjes së kontratës së shitjes e në rastin konkret ky afat është tre muaj. Në qoftë se shitësi refuzon ose nuk e lidh kontratën brenda afatit të paraparë blerësi fiton të drejtën që në procedurën jashtë kontestimore të kërkojë nga gjykata kompetente që të marrë vendim, i cili e zëvendëson kontratën në tërësi. Blerësi fiton të drejtën e pronësisë mbi banesën me rastin e regjistrimit të banesës në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, por në ato raste kur blerësi ka kontraktuar mënyrën e pagesës së çmimit blerës në këste e drejta e regjistrimit të pronësisë në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme fitohet me pagesën e kështit të parë, mirëpo nuk mund ta rishes banesën ose të disponojë me atë përmes punëve juridike që quhen intervivos të subjekteve deri në ditën e pagesës së kështit të fundit. Është rregull se nëse prona e paluajtshme nuk është e regjistruar në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme ose nëse në regjionin përkatës nuk është i organizuar regjistri përkatës mbi pronën e paluajtshme e drejta e pronësisë mbi banesë fitohet me vërtetimin dhe regjistrimin e kontratës në organin kompetent në territorin e së cilës gjendet banesa.

Të dispozitat ndëshkuese gjohet në të holla në lartësinë prej 500 deri në 1000 euro duhet ngritur lartësia e tyre, sepse është fjala për personat të cilët vendosen në banesë ose në bashkësinë hapësinore banesore të ndërtesës pa bazë juridike. Prandaj, mendoj se këto duhet të ngritën zoti ministër. Po ashtu edhe gjohet në të holla për personin juridikë janë ,po ashtu, të ulëta këto duhet ndryshuar me amendament të veçantë.

Në nenin 46 të këtij Ligji thuhet se Kuvendi i Kosovës duhet në afatin prej dy vitesh nga dita e zbatimit të këtij ligji të adaptojë ligje të veçanta lidhur me organin e autorizuar për të udhëhequr me të dhënat apo regjistrat e banesave. Në këtë rast është e paqartë se cilat

ligje duhet adaptuar dhe të cilat konsiderohet si lekspecialis në këtë fushë. Duhet theksuar se për t'u implementuar me sukses ky ligj Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor duhet t'i nxjerr aktet nënligjore që do të rregullojnë mënyrën e zbatimit, përcaktimit të çmimit shitës të banesës që është objekt i shitjes.

Ligji i propozuar plotëson një zbrazësi juridike të konsiderueshme ashtu që krijon një infrastrukturë ligjore të domosdoshme të harmonizuar me ecuis - komunitaria. Ligji që tani po e shqyrtojmë do të përbënë një bazë të fortë ligjore që dot të eliminojë shumë probleme në praktikë dhe do të bëjë zgjidhjen e shumë konflikteve të rënda pronësore së bashku me Ligjin për të drejtat sendore që së shpejti do të kemi në shqyrtim në këtë Kuvend.

Riformulime dhe korrigjime të konsiderueshme duhet bërë në shumë nene të Projektligjit ,megjithatë marrë në tërësi Ligji plotëson kushtet për t'u miratuar në shqyrtim të parë.

Në emrin tim person dhe të Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës konsiderojmë se ligji duhet miratuar, ndërsa kontributin tonë do ta paraqesim në fazën e amendamentimit të tij. Ju faleminderit për vëmendje.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit zoja deputete. Në emër të Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës është paraqitur deputeti Mazllom Kumnova.

MAZLLOM KUMNOVA – Zoti kryesues, ministra. Grupi Parlamentar i AAK-ës në këtë Kuvend e ka shqyrtuar këtë projektligj dhe me këtë rast ka konstatuar .Së pari si një përmbajtje përafërsisht me një kontest më të gjerë për banimin në formën e Projektligjit e patëm kaluar në leximin e parë në fillim të vitit të kaluar në këtë Kuvend dhe gjatë procedimit në komisione Projektligji mbi banim u kthye hartuesit, jo vetëm pse përbënte një kosto, por se mund të zbërthejë në disa projektligje. Sot pra kemi në dorë nga kjo përmbajtje një projektligj që pretendon të rregullojë shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, mënyra e përcaktimit të çmimit të banesave dhe zgjedhja e të së drejtës së banimit. Kështu Ministria me këtë projektligj ka filluar të rregullojë me ligj një fushë të rëndësishme si është definimi i statusit pronësor të bartësve të drejtës banesore. Nga kjo e arritur do të formohet edhe krijohet edhe të hyra financiare për programet e banimit social për të cilat Kosova ka nevojë të konsiderueshme.

Së dyti besoj se kjo Ministri ka pasur mundësi sot të sjell një pako tri projektligje, përveç këtij projektligji dhe dy të tjera atë të banimit social si dhe projektligjin për shfrytëzimin dhe administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve dhe pajisjeve të përbashkëta në ndërtesa. Mirëpo, ka vlerësuar me prioritet këtë projektligj dhe duhet pranuar edhe pse si Grup Parlamentar apelojmë që sa më shpejtë të përgatitet edhe këto dy projektligje të tjera.

E treta, arsye përse e mbështesim këtë projektligj është se e zgjidhim problemin e një numri të konsiderueshëm të familjeve si bartës së të drejtës banesore për të blerë banesën e tyre që deri më tani ka qenë e diskriminuar e drejta që e kanë zgjidhur qe sa kohë edhe shtetet e rajonit.

Zoti kryesues, ne mendojmë se gjatë procedimit duhet kushtuar kujdes nenit 3 dhe 44 ku i referohet Ligji për marrëdhënie banesore të vitit 83 dhe 86 besojmë se duhet t'i shmangemi këtij referimi.

Si Grup propozojmë që t'i hapim rrugët këtij projektligji për miratim. Kaq. Faleminderit!.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit zoti deputet. Në emër të Grupit Parlamentar ORA është paraqitur Gazmend Muhaxheri.

GAZMEND MUHAXHERI – Faleminderit zoti kryesues. Grupi Parlamentar ORA i jep mbështetje këtij projektligji, mirëpo ka vërejtje në nenin . Siç duket dikujt po i ngutet që edhe ato pak toka që janë mbet pa u shit me i shit. Në nenin 4 të këtij Projektligji ka paraparë që njeriu që e blen banesën e blen edhe tokën që shkon me atë ndërtesë, që është një lajthitje. Pro, ky Kuvend edhe komisioni, i cili do ta trajtojë këtë projektligj duhet këtë klauzolë të nenit 4 ku thotë se së bashku me banesën pronari blen edhe tokën e ndërtesës ajo është e pamundur pa u rregulluar ligji mbi pronën. Për pjesë tjera nuk kemi vërejtje esenciale dhe e përkrahim në parim këtë projektligj.

KRYESUESI XHAVIT HALITI – Faleminderit zoti Muhaxheri. Në Emër të LDD-ës fjalën e ka deputeti Milazim Haliti.

MILAZIM HALITI – Faleminderit z. kryesues, të nderuar ministra, të nderuar kolegë deputetë. Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë me vëmendje ka shqyrtuar Projektligjin për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore dhe ka vlerësuar se ky projektligj është i konceptuar mjaft mirë. Është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm që të miratohet në Kuvend.

Ekziston një numër i konsiderueshëm i shfrytëzuesve të banesave, të cilët nuk e kanë fituar të drejtën për blerjen e banesës, sepse këtë ua ka pamundësuar Ligji për banim i Serbisë i vitit 1992, me rastin e largimit të dhunshëm nga puna ku këta të punësuar janë privuar nga e drejta për blerjen e banesës. Tani me këtë projektligj iu mundësohet e drejta e blerjes. Qëllimi kryesor i këtij projektligji është procesi i privatizimit të banesave dhe atë për të gjithë shfrytëzuesit e banesave, pastaj përcaktimi i rregullave dhe procedurave administrative, mënyra e përcaktimit të çmimit, shitja e banesave në pronësi shoqërore ku ekziston e drejta banesore.

Me fillimin e zbatimit të këtij projektligji do të realizohen mjetet e konsiderueshme nga shitja e këtyre banesave ,ku 55% të këtyre mjeteve do të derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës dhe do të përdoren për nevoja banimi. Projektligji ,gjithashtu, parasheh mundësinë që blerësi të bëjë pagesën e menjëhershme, por edhe lënë mundësinë që pagesa të bëhet e afatizuar për 20 vjet. Projektligji në një mënyrë blerësve u krijon kushte të favorshme edhe me rastin e caktimit të çmimit të banesës ku merren parasysh rrethanat që janë të favorshme për blerësin me rastin e caktimit të çmimit të tyre.

Ky projektligj ka nevojë edhe për disa plotësime e korrigjime të cilat duhet të bëhen nga ana e Komisionit gjatë amendamentimit .Me këtë rast po theksoj disa nga vërejtjet që janë në këtë projektligj.

Së pari që në hyrje të projektligjit pas arsyetimit bazë thuhet: Kuvendi i Kosovës miraton pastaj vazhdohet me kreun e parë dhe dispozitat e përgjithshme. Nuk thekson fare titullin e projektligjit, pavarësisht se nënkuptohet se për cilin Projektligj është fjala.

Pastaj neni 4 duhet dhënë kuptimin e duhur kur thuhet banesa shitet në pjesë të përbashkëta dhe pajisjet e ndërtesës si tërësi së bashku me tokën në ndërtesë. Këtu duhet të bëhet një riformulim i duhur dhe i qartë, pastaj nenet tjera që duhet plotësuar janë: neni 11, paragrafi 2. si dhe neni 46 paragrafi 2. parasheh nxjerrjen e akteve nënligjore por nuk është paraparë afati për nxjerrjen e tyre që mendoj se, edhe kjo duhet të përcaktohet me projektligj.

Grupi parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë, përkrahë në pari miratimin e këtij projektligji dhe do të japë kontributin e vetë gjatë procedurës së mëtutjeshme të amendamentimit nga ana e Komisionit funksional. Ju faleminderit për vëmendje!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit zoti Haliti, fjalën e ka në emër të 6+ deputeti Rifat Krasniq

RIFAT KRASNIQI - Ju faleminderit zoti kryesues, të nderuar deputetë, të nderuar ministra. Unë do të foli në gjuhën turke, kërkoj falje

Sayın başkan, değerli bakanlar ve milletvekilleri

Konut Satımına ait Yasa Tasarısı

Sayın milletvekilleri, barınma hakkına sahip olan toplumsal konutların satımına ilişkin yasa tasarısı elimize geldi. Demek ki geçmiştin kalan bir konuyu temizlemek durumundayız, öyle ki bu yasanın bir an önce kabul edilmesi gerekir. Ancak bu, yasanın eksikleriyle kabul edilmesi anlamına da gelemez. Edindiğimiz bilgilere göre barınma hakkını iade edenlerin çoğu Sırbistanın ayrımcı yasaları nedeniyle 1999 yılına kadar bu konutları satın alma hakkını kazanamamıştır. Öyleki benim uyarım, bu haksızlıkların bir daha tekrarlanmamasın engellenmesi konusuna aittir. Ben özel düşünceme göre, milletvekilin bazılarının sözkonusu yasa tasarısının hükümete geri çevrilmesi gerektiğini ileri sürdüm. Buna rağmen, özellikle Kuzey Mitroviçada ve Sırların yaşadıkları Kosovanın diğer yerlerinde Sırbistan zamanında yapılan haksızlıkların ve yasaya saygısızlıkların yapılmayacağını bu yasayla tasdiklayan yetkili bakanlığa sahip olduğumuzdan dolayı bu yasanın geri çevrilmesinin yerinde olmayacağını düşünüyorum. İki konuyu fark etmeliyiz, yasamanın gerçekten tamamlanmasına ihtiyaç var, ancak bu yasamanın, herhangi bir yasayla tamamlanmamasına da izin vermememiz gerektiğini bilmeliyiz. Bana göre bize pahalıya mal olacak veya çok pahalıya mal olacak yanlışlıklar asla yapılmamalıdır. Örneğin, bu yasa tasarısının işlevsel komisyonlarda aylarca belki de yıllarca nihayi hali saptanmassa bugün bu yasa tasarısının kabul edilmesinin de anlamı olmaz ve bununla hiç bir şey kazanmamış oluruz.

Öyle, komisyonlarda gereksiz geciktirmelere neden olabilecek anlaşmazlıkları engellemek için bu yasa tasarısının 15. maddesinin tamamlanıp tamamlanmaması konusunda bugün tartışmamız gerektiğini düşünüyorum.

Teşekkür ederim

Sayın başkan, değerli bakanlar ve milletvekilleri

Genetik Değişikliklere neden olan organizmalara ait Yasa Tasarısı

Sayın milletvekiller, sözkonusu yasa tasarısı, ilk sırada besin konusunda, özellikle ise yasa tasarısının da sözü geçen Avrupa talimatlarına göre genetik değişikliklere neden olan organizmalardan korunmaktan söz edilmesi dolayısıyla, Kosova'nın, uluslararası ve Avrupa Birliği standartlarını yerine getirmesine yol açmaktadır.

İnsan sağlığının korunması ve uluslararası standartlara saygınlıktan söz edildiğinden dolayı ben, bu yasa tasarısının prensipte kabul edilmesini öneriyorum.

Teşekkür ederim

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit, grupi për integrime ka dikush me thënë diçka, nuk ka, - a Vezira Emrush, urdhëroni,

VEZIRA EMRUSH - pozdravljam, ovaj Nacxrt zakona o prodaju stanova za za koje postoje stanarsko pravo mi smo isto tako ovo dobro iz analizirali i došli smo do konstatacije da je Zakon jako osjetljiv i da zadire u interese ne samo albanskog naroda već i je značajan za sve ostale građane Kosova.

Zakon definiše status ne samo imovine, to je stana, i ostalih pomoćnih prostorija, kako privatne tako i društvene svojine, a zakon sam definiše i status korisnika stana. Zakon znači definiše prodvca kao vlasnika, i kupca koji teba da stekne pravo na stan kupovinom, u gotovom novcu ili u ratama na 20 godina sa 1% kamate. Stan znamo da je svojina kupca, kada plati prvu ratu za stan, stiče pravo registrovanja stana kao svojine koju može sa konačnom isplatom da otuđ tj. da proda. Zakonima cilj rešavanja konflikta interesa kada je u pitanju proces privatizacije.

Zakon vidimo da ima 4 važna poglavlja, i opisan je ukupno u 45 člana. Vidimo da je Ministarstvo za prostorno planiranje, nadležno za sprovođenje zakona. Ovde ističem u ime grupe i svoje ime, da je Zakon jako važno, radi se zaštići o zaštiti svojine, i svojinskih interesa. Mora da se pazi kada je u pitanju imovina. Zakon je unačelu dobro urađen ali nema osnova za svoje sprovođenje. Sve do konačnog statusa Kosova. U svoje ime mislim da nećemo mnogo pomoći korisnicima stanova kada znamo kakva je situacija na terenu. Kada ima slučajeva da je prodavac sada nepoznat, da se prenosi vlasništvo na opštinu. Ovaj zakon treba da sačeka na svoje sprovođenje, kako ne bi stvorili još veću konfuznu situaciju na terenu. Ja lično imam, dajem doznajanja ovde svim kolegama u parlamentu da sam ja slučaj koji imam kupljeni stan, ne od društvene svojine, iz 1992.god. u Prizrenu, i koji nisam mogla da legalizujem sve do danas.

Ali ipak smatram da je pametnije da se sačeka na analizi i donošenja ovog zakona, radi njegove konačne upotrebe, zpotarebe u zakonodavstvu, i radi sprečavanja manipulisanja, u privatizaciji ovog stambenog fonda koji je značajan za naše društvo. Hvala!

KRYESUESI XHAVIT HALITI - Ju faleminderit. Për fjalë është paraqitur deputetja Naxhije Doçi.

NAXHIJE DOÇI- Ju faleminderit zoti kryesues. I nderuari zoti kryesues, të nderuar ministra, kolegë të nderuar deputetë.

Projektligji për shitjen e banesave në të cilat ekziston e drejta banesore, është një projektligj pak sa i veçantë për ne në Kosovë, pasi lënda e tij përkon vetëm me kërkesat dhe me problemet tona, si vend i dalë nga një sistem socialist, totalitar, si dhe si vend i dalë nga një robëri e gjatë nën pushtuesin serb. Në Bashkësinë Evropiane nuk ka ekzistuar një fenomen i tillë, se edhe nuk ka pasur probleme të tilla atje, si dhe ky projektligj nuk e cenon tërësinë e ligjeve të Unionit evropian, apo të quajtur Aki-komuniter. Është një punë e mirë e Ministrisë së Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor, që ka ofruar këtë projektligj për vlerësim dhe për miratim në Kuvendin e Kosovës, ngase që moti është ndier nevoja për rregullimin e procesit të privatizimit të banesave, në mënyrë të drejtë për të gjithë bartësit e të drejtave banesore të ish ndërmarrjeve shoqërore dhe të institucioneve publike në Kosovë.

Është një projektligji i mirë që përfshinë standardet më të mira për hartimin e legjislacionit tek ne. grupi punues që ta bëjë këtë projektligj sa më të përshtatshëm dhe sa më të harmonishëm për domosdoshmëritë tona legjislative ka pasur për-bazë ligjin për shitjen e banesave në Bosnje e Hercegovinë, si vend me fat të njëjtë dhe me peripeci të njëjta si dhe ne në Kosovë. Ky projektligj krahas të mirave që përmban duhet ti ketë edhe disa të dhëna të veçanta, sepse deri në vitin 1999, u janë bërë shumë të pa drejta shqiptarëve të Kosovës për privatizimin e banesave ashtu siç thuhet edhe në memorandumun shpjegues të këtij Projektligji në pikën 3. citoj: si pasojë e aplikimit të ligjeve dhe të politikës diskriminuese të Serbisë. Serbia gjatë dhjetë viteve 1989-1999 ka bërë diskriminim të madh ndaj punëtorëve shqiptar, por edhe të tjerëve, jo serb, duke i përjashtuar kolektivisht nga puna, por edhe duke ua marrë banesat me të pa drejtë, dhe duke i lënë në rrugë punëtorët, që e kanë gëzuar deri atëherë të drejtën e banimit, në banesën e vetë.

Grupi punues i këtij projektligji është dashur në nenet e posaçme të parasheh se si për të vepruar edhe me rastet kur Serbia i ka detyruar banuesit e banesave që ti blejnë banesat e veta, dhe për këtë blerje përfaqësuesit e institucioneve të Kosovës, vetë banuesit apo edhe përmes avokatëve është dashur të shkojnë në Beograd t'i paguajnë të hollat për banesë dhe të ligjin atje kontratë për banesat në Kosovë. Gjithashtu, ka raste kur punëtori ka qenë i detyruar dhe ka paguar pjesëmarrje për ndërtimin e banesës dhe tash që organizatat janë privatizuar si ti kërkojë punëtorit të hollat e paguara për banesë, apo duhet të paguaj më pak të holla e tjera, sepse banuesi mund të bëjë edhe kontest gjyqësor për të hollat që i ka paguar për banesën e vetë.

Këto janë disa specifika të veçanta që duhet të parashihen në këtë projektligj në mënyrë më të qartë dhe që të mos ketë dyshime dhe probleme rreth së kaluarës dhe rreth së ardhmes për shitblerjen e banesave. Në nenin 10, paragrafi 4 thuhet: marrëveshja bëhet në formë të kontratës me shkrim dhe vërtetohet në organin kompetent. Mendoj se këtu duhet treguar palëve se cili është organi kompetent, gjykata komunale, komuna etj. e jo për ti lënë palët të dyshimtë se kah të orientohen.

Në paragrafin 3. të nenit 20, është caktuar vlera mesatare e ndërtimit për banesa është 300 €, me të gjitha ato elementet e tjera shtesë, 300 € m², që mendoj mbasi është fjala për banesa shoqërore, që do ti ndërtojë komuna. Mendoj se institucioni publik përkatës duhet të bëjë kontratë me punëtorët blerës të caktuar që janë punëtor me kontratë dhe që do të dëshmojnë se banesën po e blejnë për familje e jo për përfitime me rishitje. Pra organi kompetent të mos bëjë kontratë me biznesmen që mund ta blejnë krejt ndërtesën dhe pastaj ta shesin menjëherë 800 deri 1000€ m². Në nenin 36 theksohet se me shitjen e banesave 55% e mjeteve derdhen në buxhetin e konsoliduar të Kosovës në llogari të veçantë për banim dhe 45% të mjeteve i mban komuna për raste enkas.

Te pika e 4. dhënë nga departamenti i buxhetit të konsoliduar të Kosovës me nëntitullin paqartësitë, kujtoj se bëhet vërejtje me të drejtë se citoj: duhet sqaruar se kush do të menaxhojë me këto mjete? Mendoj se duhet caktuar saktësisht se cila ministri apo cili institucion tjetër në Kosovë do ti mbajë dhe do ti funksionalizoj këto mjete për rastet enkas, sepse është fjala për shuma të mëdha mjetesish prej 25 apo 36 milionësh për, me shitjen e rreth 6000 banesave brenda 2 vitesh pas miratimit të këtij ligji. Mendoj se një nen i veçantë duhet të parashihet edhe për mirëmbajtjen e ndërtesave me banesa, sidomos të mirëmbajtjes së pastërtisë si të shkallëve të ndërtesave bodrumeve, oborreve etj. se kujtoj se duhet të ketë punëtorë të rregullt me të ardhura personale mujore.

Gjithashtu një nen i posaçëm duhet t'i parasheh edhe kushtet se cilat banesa e sidomos ato përdhese mund të përshtaten në dyqane dhe në lokale afariste, në mënyrë që të mos prishen apo dëmtohen ndërtesat të cilat mund të rrezikohen edhe që rrëzohen. E njëjta gjë vlen edhe për mbindërtimet, prandaj nenit në fjalë duhet shtuar edhe një paragraf, ku do të sqarohen qëndrueshmëria e ndërtesave shoqërore për ndërtimet nën-kulme. Në fund po theksoj se projektligjin e përkrah në parim dhe mendoj se pasi të merren parasysh vërejtjet plotësuese në Komisionin Funkcional dhe në komisionet e tjera kontribuuese do të jetë një ligj i mirë, i domosdoshëm dhe i dobishëm për ne në Kosovë. Ju faleminderit shumë!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit, fjalën e ka deputetja Nekibe Kelmendi, le të përgatitet deputeti Gani Koci.

NEKIBE KELMENDI – Ju faleminderit zoti kryetar, i nderuari (ndërhyrje kryetari) – le të përgatitet deputeti Ramadan Kelmendi, (tash ju e keni rendin, por në vend të Gani Kocit është Ramadan Kelmendi.)
Ju faleminderit!

Unë e kam lexua kështu për shpejtë këtë ligj. Kam të njëjtën vërejtje sikur që e pati kolegu Gazmend Muhaxheri, në nenin 4, të këtij ligji ku thuhet se së bashku me ndërtesën ku gjenden banesat shitet edhe toka mbi të cilën është ndërtuara ndërtesa, kjo për faktin se ne nuk e kemi akoma ligjin për denacionalizimin dhe toka shoqërore, toka urbane nuk mund të jetë në qarkullim, pra nuk mund të shitet. Kështu që nga, ky nen duhet të hiqet, shitet së bashku edhe toka.

Kam një vërejtje edhe në nenin 10 të këtij ligji, kur bën fjalë për bashkëbanuesit. Ky nen duhet të jetë më i qartë, Bashkëbanues janë bashkëshortët dhe anëtarët e familjes së ngushtë, por shtrohet pyetja a janë ata bartës të së drejtës banesore të gjithë. Nëse banon dikush ilake, që nuk bën pjesë në familjen e ngushtë ai nuk mund ta ketë fituar të drejtën banesore. Andaj edhe nuk mund ta ketë fituar të drejtën për blerjen e banesës, kështu që ky nen duhet të qartësohet më shumë.

Pastaj, neni 20, i cili bënë pjesë për vlerën, për përcaktimin e vlerës së çmimit, apo çmimin e shitjes së banesës, për mendimin tim është një vlera mesatare e kostos së ndërtimit prej 300 € që duhet të merret është çmim tejet i lartë nën 1.

Nën dy. Duhet dalluar çmimin e tregut nga çmimi i kostos së ndërtimit dhe duhet marrë edhe elementet tjera, të cilat ndikojnë në lartësimin e çmimit siç është zona ku gjendet ajo, amortizimi i banesës, kati në të cilin gjendet etj. Të gjitha këto janë elemente të cilat ndikojnë në përcaktimin e çmimit të kostos së një banese- shitjes së banesës. Më pastaj kam vërejtje në nenin 29 paragrafi 1, në të cilin thuhet se: komuna përmes autoritetit të cilin e cakton, kryen verifikimin e përcaktimit ligjor të çmimit shitës të banesës në pronësi publike dhe shoqërore.

Tash jemi me një ekonomi të tregut të lirë edhe nuk mundet komuna në mënyrë administrative me ndërhy në përcaktimin e çmimit të kostos, ose kostos së blerjes së banesës .Dhe krejt në fund mendoj se ka mbet një çështje e pa rregulluar me këtë projektligj, e kjo është çështja e bashkëpronësisë. Kur e them këtë kam parasysh se një numër jo i vogël i banesave janë në bashkëpronësi. Një pjesë është ndërtuar dhe është fituar e drejta pronësore me bashkimin e mjeteve, kurse pjesa tjetër i është dhënë në shfrytëzim nga ndërmarrja. Pjesa që është fituar me bashkëpronësinë nuk mund të jetë objekt i shitblerjes, mund të jetë vetëm pjesa tjetër që ka mbet në pronësi shoqërore . Kemi një rast jashtëzakonisht interesant që, Habitatit për çudi ka marrë një qëndrim jashtëzakonisht diskriminues, kur janë në pyetje shqiptarët.

Fjala është për atë se, kemi pasur institucionet tona qendrore, deri në shpërbërjen e autonomisë së Kosovës, në mënyrë të dhunshme. Dihet se ndërtimet janë vonuar, atëherë nuk janë ndërtuar shumë shpejtë, por janë kontraktuar dhe janë pagua mjetet nga institucionet shtetërore të Kosovës.Mirëpo mbas suprimimit të autonomisë, atëherë ato institucione më nuk kanë ekzistuar, kurse punëtorët i kanë marrë vendimet për shfrytëzimin e banesave dhe për shkak të suprimimit të autonomisë nuk kanë mundë të lidhin kontratën me ndërmarrjen e banesave, sepse iu ka pushuar edhe marrëdhënia e punës në ato institucione.

Çka të bëhet me ato banesa? Kemi rastin e 3500 policëve. Nuk them se të gjithë janë problem, por një pjesë shumë e madhe e tyre janë problem, sepse ata të parët, më 16 prill 1990 janë larguar nga puna dhe i ka marrë të gjitha kompetencat Ministria e Punëve të Brendshme e Serbisë. Raste të tilla keni edhe në fushën e shëndetësisë, të arsimit ,të Këshillit Ekzekutiv të Kosovës, të Kuvendit të Kosovës të atëhershëm etj. Duhet të gjejmë një zgjidhje në këto, nëse i ka zgjidhur këto Habitatit, atëherë duhet të rishikohen ato vendime nëse janë diskriminuese apo jo, sepse edhe Habitatit ka pasur për detyrë që t'u japë përparësi atyre personave, të cilët kanë qenë të diskriminuar me vendime për ndarjen e banesave ose nuk kanë mund me ardhë deri te lidhja e kontratës mbi shfrytëzimin e banesës për shkak të largimit të dhunshëm nga puna. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Ramadan Kelmendi, le të përgatitet Gani Koci.

RAMADAN KELMENDI – Ju faleminderit, i nderuari kryetar, të nderuar ministra, kolegë deputetë!

Në veçanti do të pajtohesh me pjesën e fundit të paraqitur nga Nekibja, lidhur me kontestet që mund të prodhon ky propozim ligj me rastin e aplikimit në të ardhmen. Edhe qëllimi është pikërisht ky. Propozim ligji është i domosdoshëm dhe në këtë nuk ka diskutim. Në parim dhe në rrethana normale, do të duhej pranuar pa asnjë vërejtje, por megjithatë, ne duhet ti shtrojmë problemet që mund të rezultojnë nga aplikimi i tij i mëtutjeshëm. Por duke u mbështetur në aktvendimet e Habitatit dhe mbështetur në padrejtësitë që janë bërë shqiptarëve, nga e drejta e punës, pra marrëdhënia e punës dhe e drejta banesore, pas vitit 1999, duhet shikuar që më këtë propozim ligj të definohen qartë disa raporte juridike, si e drejta banesore. Dy- e drejta e shfrytëzimit të banesës dhe e drejta e pronësisë së ndërmarrjeve të shumta shoqërore të kohës, të cilat ishin edhe investitorë dhe ndërtues të këtyre banesave shoqërore, të cilat u janë ndarë punëtorëve të dëbuar tani me dhunë pastaj dhe ata më nuk kanë pasur mundësi t'i shfrytëzojnë ato banesa.

U mur vesh de u kuptua sa është numri në shërbim policor, në administratë dhe institucione tjera, por një çështje e tillë do të reflektohet shumë negativisht, në Mitrovicë në veçanti, ku vetëm në kombinatin “Trepça” janë 932 banesa të tilla të kontestuara, të cilët janë vetë investitorë me shqiptarët. Kanë ndarë nga pagat e tyre dhe nuk kanë pasur mundësi t' lidhin kontratat. Ata janë vetëm vendime mbi të drejtën e shfrytëzimit të banesës, ndërsa nuk ka pasur mundësi në bazë të ligjeve diskriminuese, të gëzojnë të drejtën e blerjes së banesës, për shkaqe tanimë të njohura.

Në veçanti Ligji mbi pronën, definimi i bartësit të drejtës banesore, definimi i drejtë i shfrytëzuesit të banesës, prona e investuar në banesat e përbashkëta, pjesëmarrja në ndërtimin me vetë kontribut dhe bartësi i parë i të drejtës banesore para vitit 1990, duhet të definohet ,se përndryshe do të kemi implikime të natyrave të ndryshme procedurale gjyqësore e ku ta di unë edhe me e keqe të konflikteve. Unë vetëm do të thosha bartës i të drejtës banesore, person i cili është ndarës i banesës është dhënës dhe shfrytëzues dhe i cili ka lidhur kontratë, por nuk e shpjegon për atë që vërtet kanë vendime gjyqësore të pas vitit 1990, vendime nga gjykatat e ndryshme të Serbisë, të cilat tani veç gëzojnë të drejtën

e bartësit banesor dhe ai e shet banesën, ku nuk ka qenë as investitor as nuk ka qenë punëtor i ndërmarrjes që e ka ndërtuar. Prandaj duhet definuar kjo dhe së fundi, vetëm edhe një vërejtje parimore. Kemi përjashtim nga e drejta për blerjen e banesave. Të gjitha banesat e blera pas vitit 1990, tani flas pikërisht për Mitrovicën, janë banesa të kontestuara dhe banesa që Habitatit u ka dhënë palëve të treta, me ligje dhe vendime gjyqësore që nuk kanë ekzistua dhe janë në kundërshtim me të gjitha parimet e investimit të punëtorëve për ato banesa.

Shikuar në tërësi, unë e përkrah në parim, por do të kisha kërkuar nga sponsori dhe vetë ne komisionet funksionale të kemi shumë kujdes në këtë sepse në Kosovë janë një numër i madh i banesave që janë të kontestuara dhe kontestuese, pikërisht nga vendimet jo të drejta të Habitatit dhe si të tilla do të prodhojnë efekte negative. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Fjalën e ka deputeti Gani Koci, kandidati i fundit.

GANI KOCI – Ju faleminderit zoti kryesues. Është mirë që më në fund ky ligj prapë u gjend në duart tona dhe në bankat e Kuvendit këtu. Ka më duket më shumë se sa tre vjet, që kemi miratuar në parim një projektligj të tillë dhe i është nënshtruar të gjitha procedurave të Kuvendit dhe si i tillë nuk na erdhi, por u bë një ligj i dytë tash, një projektligj i dytë dhe si ti tillë mirë që ka ardhur. Po unë do të thosha zoti ministër, në qoftë se keni marrë për bazë Ligjin për shitblerjen e banesave të distriktit të Bërçkos, të Bosnjës dhe Hercegovinës, është dashtë bile ta përshkruani komplet siç është ai. Besoj se kishte me dalë më mirë edhe pse gjendja e banimit dhe çështjet e banimit në Kosovë, realiteti i Kosovës nuk është i njëjtë me realitetin prej nga e keni kopjuar pikë për pikë këtë ligj.

Unë mund t'ju them tash, prej nenit të parë, me përjashtim të nenit 6. është i kopjuar dhe as në pikë dhe as në presje nuk ka dallime, absolutisht. I kam të dy në dorë, mund t'ua jap në fund, por kjo është çështje tjetër. Është mirë që është ky ligj që më në fund që vërtet, gjendja e krijuar në çështjet e banimit, e cila është krijuar gati për dy dekada, që nga viti 90 deri në kohën e largimit të Habitatit, i cili kishte për detyrë rregullimin e kësaj gjendje dhe jo që i ka rregulluar, po e ka lënë probleme shumë më të mëdha, gjë që ky ligj nuk mund ti zgjidhë ato probleme. Nuk mund t'i zgjidhë ato probleme, sepse kontekstet janë shumë të hapura dhe pa një studim të mirëfilltë në terren të kësaj gjendje, një analizë të mirëfilltë, nuk besoj se do të mund kështu shkel e shko me një ligj të tillë të zgjidhet kjo çështje.

Unë konsideroj se do të ishte mirë vërtet, ekspertët që e njohin çështjet e banimit, po sidomos rrethanat në Kosovë, na kenë pasur në dorë këtë edhe ta kenë punuar dhe do të kishte dalë një ligj vërtetë shumë i mirë. Pa dashur të them ose të përsërisë atë që thanë parafolësit, në radhë të parë ky ligj nuk definon se ç'është banesë shoqërore dhe ç'është banesë publike. Para luftës, para vitit 1999 ose deri në vitin 1992 është dallua mirëfilli çështja çka është kuptuar banesë shoqërore dhe çka është banesë publike. Këto sikur janë ngatërrua, këto dy nocione dhe veprohet njëjtë në të dy rastet, gjë që për mua nuk është kjo drejtë.

Është një element tjetër, përveç atyre që i thanë parafolësit te gjendja e banesave. Shumë ndërmarrje shoqërore, po them, ndërmarrje shoqërore atëherë, se tash quhen ndërmarrje publike, nga fondet e tyre për banesa kanë pasur të kontraktuara para lufte banesa të tëra, numër të caktuar të banesave, të cilat banesa janë përfundua në prag të luftës, ose edhe pas luftës dhe në cilat banesa sot punëtorët e atyre ndërmarrjeve kanë fituar të drejtën e banimit, mbi bazë të rregullave të ligjeve pozitive, që janë , ndërsa ky ligj u mohon ose i lenë anash se si të veprohet, me këtë kategori të banesave ose bartësit e të drejtës banesore pas vitit 1999.

Unë e kuptoj që është marrë si prerje, pse viti 1999, por banesat që kanë pasur status të banesës shoqërore, po e përsëris që kanë qenë të ndërtuara , ka përfunduar ndërtimi i tyre në prag të luftës, ose kanë vazhduar ndërtimi i tyre edhe pas luftës, ato duhet të gëzojnë të njëjtin status, sikurse banesat ose me banesat që është vendosë gjer më 24 qershor, siç e thoni ju të vitit 1999. Këtë element duhet ta keni parasysh. Ka edhe Posta, ka edhe Aeroporti, ka edhe KEK-u banesa të tilla, që është investuar para lufte, por punimet janë kryer pas lufte. Është mirë të diskutohet dhe të bisedohet me kompanitë e tilla rreth statusit të këtyre banesave.

Një çështje tjetër- te çështja e përjashtimit të blerjes të banesës. Mua po më duket sikur në një dispozitë atje, është përsëritur ajo e viteve të komunizmit -Ke shtëpi, kthe banesën ose ke banesë falma shtëpinë, shtëpinë s' ta falë askush. Nuk e dini një gjendje për 20 vjet, që ka pasur të drejtën e shfrytëzimit të banesës, po ndoshta për ato 10 vjet ose 20 vjet, ai ka krijuar edhe një pasuri dhe ka të drejtën e shfrytëzimit. Ai nuk paska të drejtë, ka bërë edhe një shtëpi dhe ai nuk paska të drejtë ta blejë banesën që e ka të drejtën banesore nga vitet 80 ose fundi i viteve të 80-ta. Kjo për mua është diskriminuese dhe na qon në ato kohërat- atë që e përsërita - e ke njërën, merre njërën e lere tjetrën. Këtë fakt duhet ta keni shumë parasysh, sepse krijohen konflikte të reja, krijohen situata të reja, për të cilat ligji nuk parasheh zgjidhjen e tyre. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit, urdhëro minister.

ZËVENDESMINISTRI TOMË HAJDARAJ - Ju faleminderit zoti kryetar, deputetë të nderuar të Kuvendit të Kosovës, Shumë shkurt. Fillimisht dua të pajtohem me deputeten Dauti se duhet të rriten gjobat. Pse kanë dalë ato gjoba asi soji është për shkak se nëpër grupet punuese njerëzit kanë mendua se janë të mëdha ama parimisht unë si zëvendës ministër definitivisht pajtohem që nëse Kuvendi vendos ashtu- të rriten. Çështje tjetër është se do të pajtohem në fund edhe me deputetin Koci. Prapë ka qenë një çështje e tillë, na kthen ekzakt aty thatë ju, e di. Mendoj se edhe nëse Kuvendin vendos prapë do të ishte mirë që provizion të ndryshohet. Kisha tërhequr vërejtën këtu është ekzakt te neni 15. Ekzistojnë provizione te neni 15, të cilat ndërlidhen edhe me përmendjen e ligjeve të vitit 82-86 dhe 92 në këtë ligj. Absolutisht nuk kemi kurrfarë dëshire apo simpati për mendje të ligjeve të tilla, në ligjet tona, mirëpo na shkurton shumë kohë, për shkak se gjendja e krijuar në terren, është si rezultat i atyre ligjeve dhe përmes atyre ligjeve, ka qenë e definuar se çka është e drejta e banimit, ose e drejta e banesës. Si e kanë fituar njerëzit të drejtën e banimit dhe në të cilat raste, banesat kanë qenë në shfrytëzim të përkohshëm, jo

me të drejtë banimi, mirëpo për raste sociale, që do të thotë se në të ardhmen një pronë e tillë nuk do të trashëgohet.

Në këto raste për të cilat flasim ne, prona e cila kalon dhe blihet, atëherë trashëgohet. Kjo është një çështje, është e vërtetë, përmenden edhe rastet e amortizimit, përmendet kati. E kemi nenin e saktë në ligj ku përmenden vlera prej 300 € ,mua më duket e lartë si nominale, mirëpo në treg është e pa mundur sot që të blihet një banesë çfarëdo qoftë në vlerë prej 300€. Nëse e marrim parasysh që ligji parasheh amortizimin, pagesën e qirasë të cilën e kanë marrë, participimin eventual të mëparshëm, mendoj se vlera e banesave do të jetë shumë e kapshme për blerësit. Po ashtu, nëse ia shtojmë kësaj çështje edhe çështjen edhe aspektin se mund të paguhet edhe deri në 20 vjet një banesë e tillë.

E fundit është. Ju kisha lutur që të keni kujdes, se përmes këtij ligji ne nuk e përcaktojmë kush janë njerëzit të cilët e kanë të drejtën banesore. Kjo është përcaktuar me ligjet tjera, qoftë të zbatueshme , qoftë me elemente të tjera. Në fund të fundit, definitivisht se do të ketë raste gjyqësore, se do të ketë konteste, mirëpo nuk mund t'i zgjidhim me automatizëm me këtë ligj këto konteste, për shkak se qëllimi i këtij ligji është, shitja e banesave të cilat mund të shiten dhe për të cilat nuk ka kontest. Të tjerat do të shiten me siguri, pas zgjidhjes së kontestit. Edhe një element, vetëm sa më ra ndërmend gjatë bisedimeve që ka dalë është bashkëbanuesit. Është e vërtetë ka qenë një term pakëz ashtu kompleks, mirëpo kemi raste të cilat p.sh. ta marrim një njerëz edhe një nip i burrit të jetojnë të njëjtën banesë. Nuk kemi ditur si t'i quajmë, i kemi quajtur bashkëbanues, për shkak se banesat janë marrë në shfrytëzim një kohë shumë të gjatë më parë dhe njerëzit do të thotë kanë kaluar dhe kanë ndryshua shumë në këtë kohë. Këto janë çështje të cilat do të definohen me njerëz të cilët e kanë vjen e drejtë, prej momentit kur është fituar e drejta e banesës. Fundi i fundit, prapëseprapë do të ketë raste gjyqësore për të gjitha. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Pasi nuk ka diskutues tjerë, kalojmë në votim,

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim. Në sallë i kemi 72 deputetë. Votojmë tash:

PËR	69
KUNDËR.....	2
ABSTENIM.....	0

Me 69 vota për dhe dy kundër, miratohet në parim Ligji për shitjen e banesave, për të cilat ekziston e drejta banesore. Ju faleminderit!

Në bazë të rregullave 23 dhe 35 Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor si Komision Funksional dhe raportues,
2. Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
3. Komisioni për Buxhet dhe Financa, dhe

4. Komisioni për komunitete.

Komisionet duhet në afat jo më vonë se dy muaj, nga shqyrtimi i parë, ta shqyrtojnë projektligjin dhe Kuvendit ti paraqesin raportet me rekomandimet e tyre.

Shkojmë në pikën vijuese

Shqyrtimi i parë i projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht.

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve me 20 qershor 2007 dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtim dhe miratim të tij në parim.

Ftoj zëvendës ministrin Tomë Hajdaraj që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë projektligjin .

ZËVENDËSMINISTRI TOMË HAJDARAJ – Ju faleminderit zoti kryetar. Të nderuar deputetë, ministra prezent. Më lejoni që shkurtimisht të bëj prezantimin e Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht , duke u nisur nga qëllimi i nxjerrjes se ligjit dhe tutje.

Qëllimi i këtij Projektligji është krijimi kornizës ligjore për mbrojtjen e shëndet të njeriut dhe mjedisit në rastet kur kryet lirimi i qëllimshëm i organizmave të modifikuar gjenetik në mjedis dhe kur vendosen në treg prodhimet të cilat përmbajnë apo konsistojnë nga organizmat e modifikuar gjenetik.

2. Fusha e veprimit të Projektligjit. Fushëveprimi i këtij projektligji është e nevojshme që të krijohet një infrastrukturë e përshtatshme ligjore për çështje që kanë të bëjnë me organizmat e modifikuar gjenetikisht në nivel sa më të avancuar, si në aspektin profesional dhe atë praktik,sa me të përafërt dhe në përputhshmëri me BE-në dhe standardet e njohura ndërkombëtare.

Nevoja për Projektligjin

Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht, është i një rëndësie të veçantë ,sepse Kosovës i mungon legjislacion i përshtatshëm, i cili i referohet mbrojtjes nga organizmat e modifikuar gjenetikisht .

Arsyetimi për Projektligjin

Arsyet për propozimin e këtij projektligji janë eliminimi i zbrazëtirave ligjore që kanë të bëjnë me mbrojtjen nga organizmat të modifikuar gjenetikisht. Është një realitet i ri në shoqërinë demokratike, sidomos në Kosovë dhe i nevojshëm për secilin vend për vendosjen e kornizës ligjore për standardet të cilat duhet të respektohen në punën me organizmat e modifikuar gjenetik.

Çështjet e adresuara nga projektligji

Projektligji ka për qëllim që t'i adresojë të gjitha çështjet ,të cilat kanë të bëjnë me kuptimin e një strukture komplete gjithëpërfshirëse dhe përmbajtjesore

Projektligji është i shtjelluar në IV kapituj,

Kapitulli I. përmban dispozitat e përgjithshme,

Kapitulli II. lirim i organizmave të modifikuar gjenetikë për cilindo qëllim, tjetër përveç vendosjes në treg,

Kapitulli III. Vendosja në treg e organizove të modifikuar gjenetik si të tilla apo prodhime dhe

Kapitulli IV. Konfidencialiteti

Kapitulli V. Mbikëqyrja e zbatimit të ligjit,

Kapitulli VI Dispozitat ndëshkimore dhe

Kapitulli VII, Dispozitat përfundimtare.

Harmonizimi i projektligjit është bërë në përputhje me Rregulloren e punës së Qeverisë, gjegjësisht neni 36. dhe konform direktivës 2001/18 të Parlamentit Evropian.

Harmonizimi i Projektligjit me standardet dhe ligje tjera është konform IPVQ-ve dhe në Kornizën Kushtetuese ,përkatësisht Rregulloren 2001/19 dhe shtojcën 10 të kornizës ligjore.

Versioni final i Projektligjit është konceptuar nga zyrtarët vendorë. .Nuk ka pasur shpenzime buxhetore,por mendoj që shikuar vetë natyrën e këtij projektligji dhe risinë për herë të parë në Kosovë,kërkoj nga ju,të nderuar deputetë,që ta miratoni në parim këtë projektligj..

Përmbajtja e projektligjit

Projektligji për Organizmat e Modifikuar Gjenetiki është ka një strukturë gjithëpërfshirëse dhe përmbajtësore, të shtjelluar në shtatë kapituj me gjithsej tridhjetë e nëntë nene dhe shtatë anekse.

I. Dispozitat e përgjithshme

Neni 1 , 2, 3, dhe 4. të këtij kapitulli ka të bëjë me qëllimin e këtij projektligji i, përkufizimet, përjashtimet, obligimet e përgjithshme që nuk do të aplikohen për organizmat e fituar përmes teknikave të modifikimeve gjenetike në Aneksin IB të këtij projektligji.

II. Lirimi i OMGJ-ve për cilin do qëllim tjetër përveç vendosjes në treg

Neni 5, 6, 7, 8, 9, 10, dhe 11 i këtij kapitulli bënë fjalë për parimet e përgjithshme, për kushtet e lirit të OMGJ-ve, procedurat standarde të autorizimit, procedurat e diferencimit, trajtimin e modifikimeve dhe informatave të reja, konsultimet dhe informimin e publikut dhe shkëmbimin e informatave me autoritetin kompetent dhe komisionin.

III. Vendosja në treg e OMGJ-ve si të tilla apo në prodhime

Neni 12, 13, 14, 15, 16,17,18,19,20, 21, 22, 23, dhe 24 bëjnë fjalë për procedurat e lajmërimit që duhet të përgatiten nga autoriteti kompetent i cili do të vërtetojë datën e

pranimi të lajmërimit, të dhënat apo rezultatet nga lirimet e OMGJ-ve, raportin vlerësues se përputhshmërisë së tij me këtë ligj, procedurat standarde të miratimit, refuzimit, ripërtirjes, kriteret për OMGJ-te, etiketimin, qarkullimin e lire, masat e sigurisë dhe informatat për publikun.

IV. Konfidencialiteti

Neni 25, 26, 27, 28, 29, 30, 31 dhe 32 bëjnë fjalë për dispozitat ligjore të informatave konfidenciale, të drejtën e pronësisë intelektuale që konsiston se ekziston rreziku për dëmtimin e konkurrencës që trajtohen si konfidenciale si dhe përfshijnë vërejtjet lidhur me rrezikun e OMGJ-ve për shëndetin njeriut, apo mjedisit, konsultimet me Këshillin shkencor, etik dhe procedurat e shërbimit të informatave, implementimin e protokollit të kartogjenes për boisigurine e OMGJ-ve.

V. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit

Neni 33 dhe 34 i këtij Projektligji bëjnë fjalë për mbikëqyrjen inspektuese që kanë të bëjnë me zbatimin këtij projektligji nga inspektorët e autorizuar nga Ministritë përkatëse për inspektimin e OMGJ-ve të liruar sipas këtij projektligji.

VI. Dispozitat ndëshkimore

Neni 33, 36 dhe 37 i këtij kapitulli përcakton gjobën dhe lartësinë e sajë për kundërvajtjet të personave fizik dhe juridik që nuk i përmbahen këtij ligji.

VII. Dispozitat përfundimtare

Neni 38 dhe 39 të këtij kapitulli përcakton dispozitat për nxjerrjen e akteve nënligjore dhe përfundimtare.

Hartimi i projektligjit në përputhje me nenin 36

Projektligji është harruar në përputhje me nenin 36 të Rregullores për punën e Qeverisë së Kosovës -Rregullore e Qeverisë Nr. 1/2007.

Gjate hartimit të këtij projektligji si model baze është marrë ligji slloven, austriak dhe ai gjerman. Baze për hartimin e Projektligjit për organizmat e modifikuar gjenetikisht ka shërbyer Direktiva 2001/18/EC e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit për lirin e qëllimshëm në mjedis të organizmave të modifikuar gjenetikisht

Harmonizimi i projektligjit me standardet e hartimit të legjislationit

Projektligji ka formën dhe strukturën standarde që përdoret për legjislationin e IPVQ-ve, është në pajtim me Kornizën Kushtetuese dhe Rregulloren e UNMIK-ut nr 2001/19, dt. 13 shtator 2001 shtojca X, dhe është në interesin e përgjithshëm të bujqësisë së Kosovës dhe popullit të Kosovës, si dhe ky projektligj krijon stabilitet legjislativ për fushën të cilën e rregullon. Projektligji është në harmoni të plotë me parimet kryesore të *acquis communautaire* të BE-së.

Projektligji nuk ka elemente diskriminuese.

Projektligji është i harruar në tri gjuhë (shqipe, serbe dhe angleze).

Versioni final i Projektligjit për OMGJ-te

Shpenzimet për hartimin e këtij projektligji nuk ka pasur, pasi që në hartimin e tij janë angazhuar ekspertet vendor nga MBPZHR.

Zbatimi i këtij projektligji në pjesën më të madhe të tij nuk ka implikime financiare në Buxhetin e Kosovës, pasi që organet e parapara në kW projektligj janë të themeluara me pare.

Shpenzime mund të dalin nga zbatimi i këtij projektligji, rreth formimit të komisioneve të këshillit shkencor dhe këshillit etik që do të themelohen me akte të veçanta nënligjore.

Si do që të jete, konsiderojmë se me zbatimin e këtij projektligji, pritet që të hyrat të jene me të mëdha se sa shpenzimet e Via.

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Në emër të LDD-së Lulzim Zeneli-

LULZIM ZENELI - I nderuari zoti kryetar, i nderuari zoti zëvendësministër, të nderuar deputetë, Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht është një projekt i hartuar mirë, gjegjësisht ofron një bazament të mirë ligjor, duke konfirmuar si pjesë e segmentit të sigurisë së ushqimit saktësisht në segmentin e bio-sigurisë dhe të mjedisit.

Vlerësojmë se ky projekt është i hartuar në atë mënyrë që adreson në mënyrë të qartë përgjegjësitë, duke krijuar njëkohësisht obligime për autoritetet përkatëse në fushën e sigurisë dhe bio -sigurisë , gjegjësisht në fushën e mjedisit. Është një projekt i cili, siç tha edhe zëvendësministri nuk krijon obligime financiare të mëdha dhe njëkohësisht është i harmonizuar me të gjitha ato mundësitë, duke ia përshtatur specifikave të Kosovës me standardet e Bashkimit evropian. Amendamentet në procedurën e amendamentimit, të gjitha vërejtjet përkatëse në do t'i procedojmë dhe për fund më lejoni në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Dardanisë e përkrah në miratim këtë projektligj. Ju faleminderit!

KRYETARI KOLË BERISHA - Ju faleminderit. Në momentin kur e thirra Lulzim Zenelin nuk ishte asnjë kandidat i paraqitur në monitorin tim. nga PDK-ja. Fjalën e ka Jusuf Sutaj, LDK.

JUSUF SUTAJ - I nderuari kryetar, të nderuar zëvendësministra, të nderuar kolegë deputet dhe ju mysafirë.

Sot kemi përpara një ligj specifik, Ligjin mbi organizmat e modifikuar gjenetikisht ose mbi organizmat gjenetikisht të modifikuar.

Për Kosovën kjo është një lëmi e re, si lëmi shkencore po njëkohësisht edhe si lëmi që aplikohet sot në Kosovë. Do të thotë nuk kemi ndonjë rast të Diktohet që Kosova është ndonjë prodhues i ndonjë organizmi gjenetikisht të modifikuar. Sa i përket qëndrimeve të popujve dhe shteteve të ndryshme ndaj këtyre organizmave janë në divergjencë, do të thotë shumë kush i pranon këto organizma si një mundësi e mirë e të ardhmes për rritjen e kategorisë së ushqimeve. Dikush i pranon si organizma që do ta shtojnë rrezikshmërinë e përhapjes dhe lirimit të tyre në ambient. Pra ,do të thotë qasjet janë të ndryshme.

Çka është organizmi gjenetikisht i modifikuar? Do të thotë një definicion më i thjeshtë do të ishte- Çdo organizëm që del në dritë dhe merr funksionin e funksionimit të tij biologjik jashtë metodave dhe mënyrave natyrale, por i prodhuar në laborator apo Institut është organizëm i modifikuar gjenetikisht. Do të thotë këtu duhet të bëjmë një dallim në mes të organizmit të modifikuar gjenetikisht dhe hibrideve. Këto dallojnë, do të thotë nuk janë të njëjta, sepse në organizmin gjenetikisht të modifikuar drejtpërsëdrejti intervenohet në bërthamë ose edhe më larg ,do të thotë intervenohet në gjen, në ADN apo në ARN.

Ligji si ligj është i përpiluar mirë ,por ka disa ngarkesa. Do të thotë kapitujt e mëvonshëm ose pasues thirren shumë në alinetë dhe paragrafët e neneve përpara. Po kjo ndodh edhe me kapitujt apo nenet pasues të përparshëm të cilët thirren në paragrafët e neneve pasues. Do të thotë kjo është një ngarkesë e ligjit.

Ligji ka pajtueshmëri me disa elemente të konventave evropiane, por ka edhe mos pajtueshmëri me disa konventa apo vendime të Unionit Evropian. Ato të cilat nuk janë në pajtueshmëri është si rezultat zakonisht i mos përcaktimit të hapësirës së Kosovës, do të thotë hapësira e nuk është e definuar dhe ata nuk lejojnë këtë të hyrë në ato konventa, pasi që nuk e kemi hapësirën as ajrore as tokësore plotësisht të definuar.

Ky ligj kërkon përpunim të hollësishëm, sepse thashë edhe në interpretimin logjik edhe të informacioneve që kemi në Kosovë kemi mangësi, edhe aq më vështirë është tani që ti jepet interpretimi juridik i këtij ligji. Prandaj unë kisha propozuar që në amendamentimin e këtij ligji ne të bëjmë edhe një dëgjim publik së paku të thërrasim njerëz që kanë njohuri më të mira rreth kësaj fushe po si iniciativë edhe si ligj ky duhet të përkrahet në parim dhe në emër të LDK-së edhe timin e përkrahu në parim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Në emër të PDK-së Selviqe Halimi.

SELVIQE HALIMI – Ju faleminderit! Grupi Parlamentar i PDK-së mendon se në parim ky ligj duhet të përkrahet, mirëpo para se të punojë Komisioni Funkcional në këtë ligj, Ministria duhet t'i hyjë një përpunimi teknik me qëllim të shkarkimit të ligjit dhe me qëllim të krijimit të mundësive të interpretimit më të saktë dhe më të lehtë të ligjit gjatë aplikimit, duke pasur parasysh se ky ligj, përveç asaj që rregullon një lëmi që është e re në Kosovë, në mënyrë direkte dhe indirekte ndikon në shëndetin e njeriut.

Ne deri më tash asnjë herë nuk e dimë se po e marr si shembull sa populli i Kosovës përdorë ushqim të sigurt dhe që mund të ketë në ushqim organizma të tillë. E kam fjalën si për ato të prodhimeve bimore edhe ato të prodhimeve shtazore. Andaj, duke pasur parasysh e mora këtë shembull vetëm për të alarmuar rrezikun për këtë dhe për atë kërkoj që duhet një përpunim shumë i kujdesshëm teknik i ligjit me qëllim të lehtësimit dhe krijimit të mundësive të interpretimit të drejtë të këtij ligji. Gjithashtu, Ministria përkatëse duhet që të kontaktojë me zyrat të cilat lëshojnë deklaratën për pajtueshmërinë e legjislacionit, i cili aprovet në Kosovë me legjislacionin e BE-së, me qëllim që të plotësohet ky ligj, qoftë në aspektin parimor, por edhe në aspektin e direktivave të BE-së. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! Në emër të AAK-së Xhevdet Neziraj.

XHEVDET NEZIRAJ – Ju faleminderit! I nderuari z. kryetar të nderuar ministra dhe kolegë deputetë.

Me këtë projektligj eliminohet një zbrazëti ligjore që ka të bëjë me organizmat e modifikuar gjenetikisht dhe krijohet një infrastrukturë ligjore e përshtatshme dhe bashkëkohore që ka për qëllim të bëjë mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit ku jetojmë dhe veprojmë, në rastet kur kryhet lirimi i qëllimshëm i organizmave të modifikuar gjenetikisht në mjedis kur vendosen në treg.

Gjatë hartimit të këtij projektligji janë marrë modelet e shteteve pse janë anëtare të BE-së, me qëllim që të jetë i përafërt dhe në përputhshmëri me legjislacionin e Bashkësisë Evropiane dhe me standardet ndërkombëtare.

Grupi i Aleancës do të kontribuojë në leximin e dytë se ky projektligj të jetë sa më komplet dhe në harmoni me BE-në. Dhe përveç që të jetë ky ligj me BE-në do të kontribuojmë që të jemi shumë shpejtë edhe shtet në kuadër të BE-së. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit! në emër të ORA, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku.

FATMIRE MULHAXHA -KOLLÇAKU – Ju faleminderit z. kryetar. Edhe ne pajtohemi për domosdoshmërinë e nxjerrjes të këtij projektligji mu për faktin se projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht është i një rëndësie të madhe për Kosovën ,se mungon një legjislacion i përshtatshëm, i cili i referohet mbrojtjes nga organizmat e modifikuar gjenetikisht . Në fakt si u cek edhe në memorandum shpjegues që ky është një realitet i ri në shoqërinë bashkëkohore demokratike dhe i nevojshëm për secilin vend.

Megjithatë nuk mund ta anashkalojmë deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së , kur në mënyrë laksative theksohet ku për këtë projektligj për bazë është marrë vetëm një rregullore dhe ajo rregullorja 2001/18, ndërsa nuk janë respektuar një sërë rregulloresh që e rregullojnë këtë fushë. Prandaj, duke u nisur nga kapaciteti i Ministrisë ku ka ekspertë të cilët kanë shumë më lehtë mundësi që të bëjnë inkorporimin e pjesëve të rëndësishme nga rregulloret e përmendura në deklaratën e pajtueshmërisë me legjislacionin e BE-së, ne mendojmë që ky ligj duhet t'i rikthehet në përpunim Qeverisë, do të thotë Ministrisë përkatëse, mu për shkak se ka ekspertë të cilët mund t'i rikthehen edhe një herë një vërejtje që është e shkruar në këtë deklaratë dhe ta rikthejë për miratim në Kuvend të Kosovës. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit!. Kush do ta marrë fjalën?

ZËVENDËSMINISTRI- TOMË HAJDARAJ - Ju faleminderit të gjithë deputetëve për kontribut dhe për mbështetje Faleminderit edhe zojës deputete nga ORA për

kontributin, vërejtje dhe sugjerimet. Mirëpo sa i përket asaj që kush ka marrë pjesë në hartimin e këtij projektligji, domethënë në Komisionin e Qeverisë, unë e them me kompetencë se kanë marrë pjesë tri ministratë me ekspertët më të mirë -Fakulteti i Bujqësisë dhe Instituti i Shëndetit Publik të Kosovës. Andaj ,mendoj që për mangësitë eventuale që i shprehi edhe zoti Sutaj që unë jam pajtuar edhe para se të hymë këtu, ne sigurisht që gjatë punës në komisione do t'i përplotësojmë, ndërsa sa i përket asaj që duhet të kthehet, unë mendoj që nuk ka bazë për dy fakte.

Ne, më 27 shtator do të jemi pjesëmarrës në Organizatën Botërore të Ushqimit ku do ta kemi kusht edhe miratimin e këtij ligji që momentalisht në Kosovë është edhe komisioni i TAEKS-it që sot e ka pas edhe njërin nga versionet e punëve të sigurisë dhe biosigurisë së ushqimit dhe është fat i mirë që deri në atë kohë Kosova do të jetë e pajisur edhe me laboratorin e ushqimit, me shkallën e tretë të bio-sigurisë, Andaj edhe një herë ftoj deputetët që ky ligj të miratohet sot në parim dhe në komisione të jepen vërejtjet, Ju faleminderit z. kryetar.

KRYETARI KOLË BERISHA –Ju faleminderit!. Lus deputetë që janë jashtë salle të kthehen në sallë të votojnë për ligjin.

Në sallë kemi 68 deputetë. Shkojmë në votim. Lus regjinë dhe deputetët, 65, 66- lus regjinë dhe deputetë të përgatiten për votim. Votojmë tash

Për.....60,
Kundër 6.

Miratohet në parim Projektligji për organizmat e modifikuar gjenetikisht.
Në bazë të rregullave 23 dhe 35 Kuvendi ngarkon këto komisione.

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural dhe Planifikim Hapësinor, si Komision Funksional dhe Raportues,
Komisioni për Çështje Gjyqësore, Legjislacion dhe Kornizë Kushtetuese,
Komisioni për Buxhet dhe Financa dhe
Komisioni për Komunitete.

Komisionet duhet që në afat jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë i Projektligjit t'ia paraqesin Kuvendit raportet dhe rekomandimet për te.

Shkojmë në pikën e 6 të rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për rrugët

Mungon ministri që duhet ta prezantojë këtë.
Shkojmë tutje.

Vetëm për ato vende që nuk ka ministër, pranohet zëvendësministri të raportojë. Këtu ekziston ministri.

Shkojmë me pikën tjetër të rendit të ditës.

7. Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës,

Në pajtim me nenin 55 të Ligjit për veprimtarinë kërkimore- shkencore, Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport pas shqyrtimit të propozimit nga Qeveria vendosi që Kuvendit t'i rekomandojë shqyrtimin e propozimit të Qeverisë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës.

Rekomandimi i Komisionit dhe propozimi i Qeverisë bashkë me biografitë e këtyre kandidatëve u janë shpërndarë deputetëve.

Ftoj kryetarin e Komisionit raportues, respektivisht zëvendëskryetarin, deputetin Nimon Alimusaj ta marrë fjalën, në emër të Komisionit.

NIMON ALIMUSAJ – Ju faleminderit z. kryetar. E nderuar zonja ministre, të nderuar kolegë.

Fillimisht duhet të sqaroj një çështje. Në këtë pikë që është titulluar Shqyrtimi i rekomandimit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji e tjerë për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës, nuk qëndron, sepse Komisioni nuk e ka dhënë këtë rekomandim, por Komisioni e ka diskutuar në një mbledhje të vetë më 12.6.2007 një vendim të Qeverisë së Kosovës për emërimin e këtij Komisioni. Ne në atë Komision kemi konstatuar se dispozitat e Ligjit për veprimtarinë kërkimore- shkencore të ligjit nr. 2004/42 e parashohin themelimin e Këshillit Kombëtar të Shkencës. Së dyti, Komisioni ka vlerësuar dhe ka konstatuar se propozimi i vendimit të Qeverisë të Kosovës nr. 7/2444 të datës 7.6.2007 për emërimin e anëtarëve të Këshillit, është në pajtim me dispozitat e nenit 53, 54, 55 dhe 56 të Ligjit për veprimtarinë kërkimore shkencore, andaj e ka miratuar si ligjor këtë vendim të Qeverisë.

Komisioni nuk i ka propozuar ata emra, por nuk ka pasur asnjë vërejtje lidhur me ata emra atë ditë. Megjithatë, Komisioni ka pasur disa vërejtje dhe sugjerime në parim. P.sh. nuk është respektuar barazia gjinore, sepse në atë komision për 15 veta është vetëm një e gjinisë femërore dhe ka pasur një sugjerim që të mos krijohet si praktikë që të njëjtit individë të emërohen në shumë borde. Këto kanë qenë vetëm si vërejtje parimore, Përndryshe, ky nuk është rekomandim i Komisionit dhe as lista nuk është propozim i Komisionit, por është e Qeverisë.

Komisioni nuk i ka diskutuar veç e veç emrat, sepse ka konstatuar, ka menduar se kjo i mbetet Kuvendit dhe Kuvendi tash do të emërojë këta, do t'i votojë a s'do ti votojë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit profesor. Ne e kemi marrë si rekomandim të Komisionit, materialin që e ka secili deputet me vete e ka rekomandim . Pika 2 e këtij rekomandimi thotë.

Komisioni i rekomandon Kryesisë së Kuvendit të Kosovës se çështje e emërimit të kandidatëve për anëtarët e Këshillit Kombëtar të Shkencës sipas Ligjit për veprimtarinë kërkimore shkencore të radhitet për shqyrtim në një nga seancat e radhës të Kuvendit të Kosovës. Urdhëroni. Nimon Alimusaj e ka fjalën prapë

NIMON ALIMUSAJ – Në mbledhjen e datës 12.06.2007 të Komisionit nën pikën 3 figuron rendi i ditës me këtë tekst: Shqyrtimi i vendimit të Qeverisë së Kosovës për formimin e Këshillit Kombëtar të shkencës sipas Ligjit për veprimtarinë kërkimore shkencore nr. 2004/42. Ne, po sa e pamë këtë rend të ditës Komisioni u mbledh brenda pushimit dhe konstatoi se Komisioni e ka vlerësuar se dispozitat ligjore të veprimtarisë kërkimore- shkencore e kërkojnë themelimin e këtij këshilli dhe se Qeveria me të drejtë i ka respektuar ato nene të Ligjit për emërimin e këtij këshilli, dhe ne jemi pajtuar për këto dy vlerësime .Si ka dalur kjo në emër të Komisionit, unë nuk e kam të qartë. Mbledhjen që e pati komisioni brenda pushimit nuk qëndron kjo çka po shkruan këtu se Komisioni ka vendosur këta emra edhe ka kërkuar nga Kuvendi i Kosovës që të emërohen. Komisioni është shumë e vërtetë se nuk ka pasur kurrfarë vërejtje për asnjë kandidatë që është propozuar këtu.

KRYETARI KOLË BERISHA – Profesor edhe një sqarim. Pikërisht në mbledhjen e 12.06.2007 thotë shqyrtojë propozim vendimin e Qeverisë së Kosovës për emërimin e anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Shkencës dhe lidhur me këtë Kryesisë së Kuvendit të Kosovës ia paraqet këtë rekomandim.

Urdhëroni z. Alush.

ALUSH GASHI - Ju faleminderit z. kryetar. Ne fatmirësisht e kemi një propozim të mirë i cili ka ardhur nga Qeveria dhe sipas procedurave parlamentare ka qenë në shqyrtim të komisionit funksional . Sipas këtij raportimi Komisioni funksional nuk ka vërejtje në kandidatë që do të thotë që janë kryer të gjitha kushtet z. kryetar, që na të votojmë për listën e propozuar të ofruar nga Qeveria, miratuar nga komisioni, dhe seanca plenare mund të marrë vendim përmes vote. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Ftoj për votim deputetët. Kush ka vërejtje? Shkojmë në votim.Votojmë tash:

74 deputetë janë prezentë. Rezultati është 40 për, 15 kundër, andaj konsideroj se miratohet lista e kandidatëve. Vazhdojmë më tutje.

Shqyrtimi i Propozimit për ndryshim dhe plotësim e Rregullores së punës së Kuvendit të Kosovës

Plani i parë për plotësimin e standardeve, i cili është miratuar në Kuvendin e Kosovës më 1 qershor të vitit 2006 ka qenë vetëm një pjesë e ndryshimit të nevojshëm për plotësimin e standardeve në Rregulloren e punës së Kuvendit të Kosovës. Materialin që e keni marrë me vete, plotësimi i standardit të dytë është një mundësi për të siguruar.

1. Përmirësimi dhe efikasitet gjatë seancave plenare posaçërisht lidhur me përcaktimi e rendit të ditës brenda Rregullores së punës.
2. Transparencë më të madhe të Kuvendit për publikimin e rregullit të programit të punës, projektligjeve emocioneve, rezolutave e tjera.
3. Krijimin e mundësive për fjalim legjislativ deputetëve në Kuvend, duke i përcaktuar si pikë të rregullt e fjalimit nga deputetët e grupet parlamentare në agjendën e secilës seancë.

Plotësimi i standardit 2 është paraqitur në pajtueshmëri me Rregulloren e punës sipas rregullës 58.1, e cila cek se Kryesia e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime që mendon se janë të nevojshme.

Me këtë rast Kryesia e Kuvendit të Kosovës ka prezantuar ndryshimet në Rregullore, tekstin e së cilës e keni marrë me ftesat për material.

E hapi diskutimin. Sabri Hamiti e ka fjalën.

SABRI HAMITI – Ju faleminderit zoti kryetar i Kuvendit. Unë po flas edhe në emër tim edhe në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës. Ne, këtë iniciativë dhe këtë miratim të rregullave të ndryshuara për Rregulloren e Kuvendit të Kosovës, që është ndërmarrë nga Kryesia e Kuvendit e kemi përkrahur, pa asnjë vërejtje në grupin parlamentar dhe unë këtu saktësisht përcjell opinionet e këtij grupit parlamentar, që i shohim këto ndryshime nën ndihmesë të punës së Kuvendit. Pra, përmes ndreqjes së Rregullores së Kuvendit dhe kemi përfaqësisht një vërejtje që ka të bëjë me fjalimet e grupeve parlamentare dhe të deputetëve.

Në amendamentin 5 thuhet dhe precizohet çdo të thonë këto. Këto janë një traditë e shprehjeve të opinionëve individuale të deputetëve dhe të opinionëve të grupeve parlamentare, Herën e parë deputetët kanë drejtën e fjalimit një minutë, herën e dytë grupet parlamentare ose përfaqësueset e tyre dy minuta. Këtu nuk lejohet replika. Unë kisha një dilemë dhe këtë dilemë pak a shumë e shtruan dhe në Grupin Parlamentar dhe e kishin edhe kolegët e mij në situatën e tashme të komunikimeve publike tonat, edhe në këtë Parlament dhe përtej këtij Parlamenti nuk di a duhet të shqyrtohet pak më thellësisht që në këtë rast të jetë e pamundshme replika. Arsyet janë të ndryshme, unë nuk dua t'i zhvillojë të gjithë tash, po në gjitha rastet tjera kur deputeti e merr fjalën në këtë Parlament është e mundur replika. Në këtë rast përjashtohet.

Unë them ndoshta pikërisht në këto raste ka me qenë e domosdoshme replika, në këtë rast përjashtohet.

Unë them që ndoshta pikërisht në këto raste ka me qenë e domosdoshme replika, prandaj unë thërras që shkurt të mendojmë të gjithë për këtë problem. Përndryshe, në tërësi. Grupi Parlamentar i LDK-së i pranon këto ndryshime dhe mendon që në disa pika precizojnë punën e Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit!, PDK-ja, Hydajet Hyseni.

HYDAJET HYSENI- Ju faleminderit z. kryetar. Më lejoni që duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit, për të hequr çdo keqkuptim, të theksoj krejt qartë se Grupi Parlamentar i PDK-së dhe unë personalisht mbështesim pa rezervë çdo përpjekje që janë evidente dhe i çmojnë për ta racionalizuar, për ta organizuar më mirë punën e këtij Kuvendi. Edhe kjo çka ndodhi sot shkon në favor të saj.

Megjithatë, tërheq vërejtjen që në fillim se kjo nuk mund të bëhet me shkelje edhe gjatë procedurës së amandamentimit dhe përmirësimit të rregullave të procedurës. Unë që në fillim tërheq vërejtjen se me amendamentin 32 të Rregullores sonë është paraparë shprehimisht që kur mocionet janë amendamente, duhet të dorëzohen 8 ditë para debatit në Zyrën për Parashtresa. Zoti. Kryetar, kjo kërkesë nuk është përmbushur. Për pasojë, deputetët tekstin e kanë marrë të hënën dhe nuk kanë pasur asnjë mundësi as institucionale se s'është lënë hapësirë, por edhe kohore sa duhet për të shqyrtuar dhe për kontribuar përmirësimit të propozimit të dhënë, të cilin në parim natyrisht gjithë e mbështesim.

Dhe e dyta. Ia përkujtoj Kuvendit se për miratimin e ndryshimeve eventuale në Rregulloren e Kuvendit kërkohet mbështetja e shumicës së deputetëve të Kuvendit. Prandaj, për të evituar ndonjë situatë ngatërrimi Kuvendi sot e shqyrtoi dhe nuk e shqyrtojë këtë çështje në fazën e parë në fillim të seancës. Unë dua të bëj dy propozime. Një që ky shqyrtim eventualisht nëse Kuvendi insiston të qëndrojë në qëndrimin që ishte në fillim të seancës, do ta thotë që ta shqyrtojë, që ta konsiderojë si prezantim të propozimit dhe shqyrtim në parim edhe miratim në parim pse jo, me vërejtjet që u dhanë. Zoti. Hamiti e dha një, unë i kam edhe nja 7 ose 8 dhe po të më krijohet hapësira do t'i them. Nëse ne merremi vesh për të ndjekur një procedurë që ne e ndjekim për aktet e ngjashme Rregullorja është ligj i Kuvendit, ka fuqi ligjore. Prandaj, ne duhet të japim shembullin e zbatimit të rregullsisë në ligjvënien, sidomos kur kemi të bëjmë me ligjin për Kuvendin. Propozimi është do të thotë, që pas shqyrtimit të parë, që do të bëhet sot me vërejtjet që do të jepeshin në parim, tekstit i bartet një komisioni, ma së miri të riaktivizohet komisioni për rregullore, i cili pastaj të prezantojë përfundimisht tekstin e propozuar. Nëse kjo nuk pëlqehet do të ishte e arsyeshme që të autorizohet komisioni për Çështje Legjislative, Kushtetuese e të tjera që edhe është me Rregullore i autorizuar dhe e mbulon këtë fushë, por do të ishte presedan i rrezikshëm që kjo çështje të shqyrtojë për një shqyrtim paraprak në komisione.

Për më tepër propozimet që janë të mira janë të motivuara mirë dhe unë duhet ta mbështesë edhe UNDP-i për ndihmën që na ka dhënë, megjithatë duhet korrigjuar në shumë aspekte.

P.sh. unë do të përmend kalimthi vetëm disa vërejtje. Sugjerohet ajo që në anglisht quhet Order Paper të quhet program, nuk është adekuate. Kemi shprehjen kalendar dhe se përjashton kalendarin programin. Në vendet tjera i kanë edhe njërin edhe tjetrën, pse mos t'i kemi edhe ne. Reduktohet diskutimi për agjentin vetëm në shefat e grupeve parlamentare. Jam dakord që të sforcohet diskutimi në këtë mënyrë, por kjo nuk mund të përjashtojë deputetët individualë, që te ne janë të shumtë se na e kemi grupin me 6 anëtarë, Sllovenia me dy, Kroacia me tre, Mali i Zi me dy, dhe çka të bëjë me deputetët që nuk janë brenda? Te ne ka mundësi çdo deputet të ngreh një çështje si çështje urgjente në fillim dhe ai s'ka drejtë të flasë për çështjen e tij kur flitet për agjendën. 6 deputetë kanë të drejtë të bëjnë një mocion për të shtruar një çështje si e kishim sot, s'kanë ata të drejtë pastaj të flasën për atë çështje. Duhet korrigjuar këto, zoti kryetar.

Dhe fjalimet që mendoj duan përshëndetur si një pjesë e seancës që vendet tjera kanë një orë për këtë, te ne është reduktuar, vërtetë në absurd 15 minuta e sa. Një minutë nuk mund të flasë deputeti, pse mos të e bëjmë si në Slloveni 3 minuta e tjerë. Është propozim i imi.

Dhe, ndonjë propozim tjetër të cilin unë do të dëshiroj që t'i apelojë Kuvendit që ta krijojë mundësinë për shqyrtim në komisione dhe vërtet ta përmirësojnë Rregulloren dhe praktikën tonë parlamentare. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit zoti Hyseni, Në emër të AAK-së Gjylnaze Syla

GJYLNAZE SYLA – Ju faleminderit z. kryetar. Ne, Grupi Parlamentar i Aleancës i ka kuptuar këto ndryshime dhe plotësime, me qëllim të fuqizimit të punës së Kuvendit dhe natyrisht edhe të racionalizimit të punës dhe funksionimit më të mirë të Kuvendit. Megjithatë është e qartë se grupet parlamentare kanë disa vërejtje për këto ndryshime. Prandaj, me qëllim që të pajtohemi lidhur me këtë dhe me qëllim që këto ndryshime t'i përgjigjen punës sonë, ne propozojmë që sot faktikisht në parim ta pranojmë dhe pastaj t'i kalohet Komisionit për Legjislacion, i cili mund t'i bëjë një propozim ose rekomandim Kuvendit, duke i marrë parasysh vërejtjet që mund t'i kenë grupet parlamentare. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! ORA, Gazmend Muhaxheri.

GAZMEND MUHAXHERI – Ju faleminderit z. kryetar. Grupi Parlamentar i Partisë Reformiste ORA është në parim që të avancohet puna e Kuvendit dhe të miratohen ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit, por jemi që kjo procedurë e ndryshimit të shkojë përmes Komisionit. Mos të krijohen presedane të tjera, d.m.th. projekt propozimet për ndryshimin e Rregullores të kalojnë nëpërmjet Komisionit ad-hoc dhe Komisioni i krijuar ad-hoc të punojë edhe në ndryshimet e reja dhe përmirësimin e kualitetit të Rregullores së

punës. Mos të mbeten vetëm këto ndryshime, por të parashihen edhe ndryshimet e tjera që të shërbejnë si bazë për Rregulloren e punës të këtij Kuvendit dhe përbërjes së Kuvendit të ri.

Prandaj, propozojmë që kjo punë t'i kalohet një komisioni ad-hoc. i cili do të shqyrtojë edhe këto propozime dhe do t'i marrë propozimet e reja për ndryshimin e Rregullores së punës së Kuvendit të bëra nga individët, nga deputetët e Parlamentit të Kosovës, por edhe nga grupet parlamentare. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Në emër të LDD-së Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI - I nderuari kryetar, është e kuptueshme se ndryshim plotësimi i Rregullores së punës mund të bëhet nga Kryesia, por me një procedurë paraprake . Unë vlerësoj dhe Grupi jonë se nuk janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara me rregullën 32 të Rregullores së punës që të aprovohet në votim të drejtpërsëdrejti. Në veçanti kur dihet se disa çështje janë të hapura, duke filluar që nga kalendari i punës, deri te reduktimi i diskutimeve rreth çështjeve për të cilat edhe u diskutua këtu paraprakisht dhe në veçanti çështjet e hapura që kanë të bëjnë me replikën. Bazuar në këto edhe unë dhe ne mendojmë se kjo duhet në parim të miratohet, por të trajtohet në komisione në grupet parlamentare dhe në Komisionin për Çështjet Kushtetuese. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Mahir Jagcilar

MAHIR JAGCILAR – Ju faleminderit z. kryetar. Ne si Grup Parlamentar mendojmë që duhet të përkrahim në parim këto ndryshime. Gjithashtu mendojmë se sot nuk jemi të përgatitur të gjithë, duhet të kalojë ose përmes grupeve parlamentare ose përmes Komisionit të unifikohet qëndrim dhe të votohet në një seancë tjetër. Ju faleminderit

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Vetëm të shpjegojë edhe një herë.

Rregulla 58 thotë: Ndryshimi i Rregullores së punës. Kryesia e shqyrton vazhdimisht Rregulloren e punës dhe kohë pas kohe mund t'i propozojë Kuvendit ndryshime që mendon se janë të nevojshme.D.m.th. ka bazën ligjore, Kryesia ka dhënë ndryshimet e propozuara- ndryshime në Rregullore që Kuvendi mund t'i aprovojë, edhe,.. Sadudin Berisha e ka fjalën.

SADUDIN BERISHA – Ju faleminderit kryetar. Pikërisht unë desha ta shpjegoj atë që paraprakisht ju e thatë se: askush nuk e konteston të drejtën e inicimit të procedurave për ndryshim dhe plotësimin e Rregullores së punës së Kuvendit. Ajo e drejtë i është garantuar nga deputeti, grupet parlamentare dhe strukturat tjera kuvendare dhe po e njëjta e drejtë i është bartur me mundësi të plotë ndryshimi dhe plotësimi të Rregullores së punës edhe Kryesisë së Kuvendit ,të cilën gjë e ka bërë në harmoni me kapitullin 15 rregulla 58, andaj proceduralisht ndryshimi dhe plotësimi i Rregullores është çdo gjë në

rregull sepse këtë Rregullore ne e kemi miratuar dhe askush tjetër, Andaj mbi bazën e kësaj rregullore proceduralisht është proceduar krejt në rregull. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhevat Bislimi.

XHEVAT BISLIMI – Ju faleminderit z. kryetar që më në fund e lëshove zemrën. E para, unë jam kundër ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit për arsye që nuk është korrekte që në fund të mandatit dikush të iniciojë ndryshime të rregullores, E dyta, jam kundër, sepse edhe me këto ndryshime edhe me gjithë punën e juaj po dëshmoni dhe po bëni përpjekje të instaloni një demokraci të komanduar, siç ka ndodhur edhe në institucionet tjera. Po bëni përpjekje të instaloni një demokraci të shefave, prandaj unë mendoj që është mirë që të bëhet një grup parlamentar i veçantë i shefave në njërën anë dhe deputetët të gjitha partive ta bëjnë një grup të veti në anën tjetër, që t'i shfrytëzojnë drejtat e tyre. Ju edhe sot e dëshmuat edhe shumë herë tjera se po instaloni një demokraci të komanduar edhe deputetit nuk i jepet fjala ose i mohohet e drejta e fjalës për të shprehur mendimin e vet edhe për një çështje të rëndësishme siç ishte Këshilli Kombëtar Shkencor, Kjo është vërtet më shumë se e pandershme, më shumë se e papranueshme dhe e dënueshme për ju dhe për imazhin që po ia jepni këtij Kuvendi dhe demokracisë parlamentare në Kosovë.

Prandaj, ju ftoj ata që ende e kanë pak demokraci dhe mendje demokratike që t'i kundërvihen kësaj tendence të kohës që po instalohet nëpër parti, në Parlament dhe gjithkund tjetër. Ju faleminderit,.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! edhe për fjalorin që e përdorët.. Fjalën e ka deputeti Behxhet Brajshori.

BEHXHET BRAJSHORI – Ju faleminderit kryetar, të nderuar kolegë deputetë. Unë mbështes çdo nisëm për avancimin e punës së Kuvendit për rritjen e efektshmërisë së punës së Kuvendit, transparencës dhe sidomos në këtë rast unë përshëndes përpjekjet për t'u dhënë hapësirë më shumë deputetëve sikur që është fjala edhe me nenin, përkatësisht me amendamentin 5.

Ajo që unë e konsideroj këtu është e mangët, është koha e deputetëve prej një minute, nuk është e mjaftueshme dhe konsideroj se për fjalime publike zakonisht duhet paraqiten tema tematike. Është e pamundur që brenda një minute të përfshihen tema tematike dhe duke përfshirë edhe mundësinë që eventualisht nëse paraqitet nevoja për replikë në moment të caktuar të rregullohet edhe ajo në kuadër të amendamentit 5 që ka të bëjë me fjalimet e deputetëve. Kjo është vërejtja ime, përndryshe përshëndes çdo nismë për avancimin e punës së Kuvendit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputetja Gjylnaze Sylja.

GJYLNAZE SYLA - Ju faleminderit z. kryetar. Kur propozova me i kaluar Komisionit për Legjislacion unë i referova letër të cilën e keni dërguar, pasi që ORA propozoi me formuar komision ad-hoc . Mendoj që në letër thuhet që paralelisht do të formojmë një

komision ad-hoc, prandaj nuk ka nevojë me u formuar një komision i posaçëm. Për atë ishte edhe propozimi, pasi kemi të bëjmë me 6 amendamente, që Komisioni për Legjislacion ta bëjë një rekomandim për Kuvendin. Ju faleminderit. Mendoj që kjo duhet të vihet në votim.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Nazim Jashari e ka fjalën.

NAZIM JASHARI – Ju faleminderit z. kryetar, që të gjithë këtu nuk po e kontestojnë nevojën për ndryshim të Rregullores. Kontestimi i vetëm është mënyra e punës z. kryetar. Edhe ju, edhe unë kur kemi qenë anëtarë të Komisionit që kemi hartuar Rregulloren e punës, me të cilën jemi duke punuar. Edhe ju edhe unë e dimë se sa energji kemi shpenzuar në mënyrë që ajo Rregullore e punës të miratohet me konsensusin më të gjerë të mundshëm në atë komision ad-hoc, i cili ka punuar në rregullore të punës. Prandaj, nuk është e udhës z. kryetar që Rregullorja e punës të miratohet me mbivotim. Mos e shtyni punën përpara pa nevojë me mbivotim edhe t'i politizoni edhe çështjet, të cilat nuk duhet të politizohen. T'i jepet kohë Kuvendit që ta ndërtojë pajtueshmërinë sa më të madhe të mundshme, në mënyrë që ta miratojmë dokumentin pa rezistencë. Kjo është kërkesa që kam ndaj jush edhe kërkesa ndaj kolegëve të tjerë deputetë. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Deputeti Alush Gashi e ka fjalën.

ALUSH GASHI – Ju faleminderit z. kryetar. Mendoj se angazhimi i Kryesisë për ndërrim dhe plotësim të Rregullores së Kuvendit të Kosovës ka hasur në mbështetje të plotë të deputetëve të Kosovës.

Mënyra e debatit të sotshëm lidhur me këtë pikë të rendit të ditës z. kryetar është fund e krye, ashtu siç debatohet në leximin e parë. Të gjitha grupet parlamentare dhe deputetë individualë kanë biseduar në parim dhe një debat i tillë është lejuar sot. Zakonisht, kur bisedohet për amendamente si është kjo ne kemi shkuar drejtë në votim. Unë ju përgëzoj për respektimin e Rregullores së punës, unë mendoj se me rregullore aktuale, Kryesia e Kuvendit ka vepruar drejtë që ka dhënë një propozim për seancën plenare. Por debati i sotshëm tërheq vërejtjen se deputetët kanë nevojë që me këtë çështje të merren edhe pak, në veçanti kur në seancë plenare diskuton kryetari i Komisionit funksional për këtë çështje, unë për veti e marrë me një respekt të posaçëm. Andaj z. kryetar, duke u thirr në diskutimin e zotëri Sabri Hamitit në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së ku e shtroi çështjen për të cilën ne kemi nevojë për formulim, mendoj se nuk është shkelje e procedurave të punës dhe të Kuvendit të Kosovës nëse kjo çështje sot pranohet në parim dhe sugjerimet qoftë Kryesia e Kuvendit, qoftë konferenca me shefat e grupeve, qoftë komisioni funksional, qoftë grupi punues me një fjalë ashtu si ju do të vendosni me këshilltarët e juaj që të epet kohë për riformulim të disa çështjeve për të cilat u biseduar sot.

Sugjerimi im është që sot të pranohet në parim, ndërsa në seancën kur kjo do të vjen në rend dite të votohet amendament sipas amendamenti. Nëse ju z. kryetar e vlerësoni që duhet të votohet sipas amendamenteve, atëherë ne do të hyjmë në një diskutim të gjatë

për riformulim të amendamenteve. Andaj në fund ju lutem që ta merrni në konsideratë votimin në parim. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Fjalën e ka deputeti Xhavit Haliti.

XHAVIT HALITI - Z. kryetar, të nderuar kolegë edhe kolege. Unë dhe ju e kemi miratuar Rregulloren e kaluar pa e diskutuar, pa e miratuar nen për nen dhe pa amendamente fare. Thotë mangësitë e Rregullores vetë të cilën funksionojmë po tregojnë për çdo ditë edhe sot kemi humbur dy orë debat për një çështje e cila ka mundur me u rregulluar brenda për brenda procedurave të Kuvendit. Çdo herë po dëgjojmë që këtu duhet ta miratojmë edhe disa organe të cilat as nuk janë në Rregullore as në Kornizë Kushtetuese, dëgjova edhe një konferencë ashtu një konferencë kështu. Tani këtu me Kornizë Kushtetuese me Rregullore i kemi të qartë dhe të ndara punët. Kush do që nuk i pëlqen dikujt mundet me e shkarkuar po nuk mundet me e mohuar ekzistimin e organeve kompetente për me vepruar dhe për me vendos çështjet e caktuara. Mendoj që vërejtjet nuk janë vetëm të deputetëve të Kuvendit të Kosovës, po janë edhe të monitoruesve të Kuvendit dhe të atyre që janë duke na ndihmuar që t'i rregullojmë procedurat më mirë, dhe në interesin tonë të përbashkët nuk është në pyetje a ka kaluar përmes një komisioni apo s'ka kaluar. Prandaj, edhe sugjerimet janë që ne të formojmë një komision ad-hoc ose komisioni funksional ose kryesia ose kush do që ne bijmë në dakord që ta bëjmë rregulloren e re, dhe mendoj që ky Kuvend edhe pse është në fund të mandatit si po dëgjojmë pra e ka për obligim që t'i ndihmojë vetë vetes sepse besoj që një pjesë e madhe e deputetëve që janë sot këtu do të jenë edhe në legjislaturën e ardhshme dhe t'i ndihmojmë edhe kolegëve që vijnë pas nesh që ta kenë një rregullore të pranueshme. Prandaj, unë nuk po e kuptoj pse sugjerimet e mira për me na i hapur mundësit dhe me na i krijuar hapësirën për të vepruar si Kuvend më mirë po hasim në pengesë pse nuk kanë kaluar përmes një komisioni. Askush askujt nuk mundet me ia ndaluar që të bëjë amendamente dhe unë mendoj që për t'i miratuar amendamentet e propozuara nuk ka nevojë ku me ditë se çfarë konsensusi dhe nuk ka nevojë që të takohemi edhe një herë në nivele të partisë në nivele të partisë në nivele kryetarësh grupeve parlamentare dhe ku e di unë se çfarë.

Mendoj se do të duhej që të kalojmë. Ndoshta është e pranueshme që të pritët ndonjë amendament shtesë për seancën e ardhshme dhe që të miratohet në seancën e ardhshme, por për veten time jam kundër që amendamentet e propozuara në rregullore të kalojnë në komision pas komisioni dhe të na vijnë pasi ta përfundojmë mandatin. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Shkojmë me propozimin e z. Xhavit Halitit që të kemi një kohë shtesë për të amendamentuar ose për të korrigjuar amendamentet që janë dhënë në te për seancën e ardhshme, të votojmë për te, kryesisë i drejtohet, propozues në këtë rast është Kryesia e Kuvendit.

Urdhëro profesor Hamiti.

SABRI HAMITI – Këtu i dëgjuam disa ide dhe është normale që ka plot ide. Ka njerëz që thonë që do të duhet të krijohet Rregullorja e re. Brenda Rregullores ekzistuese thuhet

që legjislatura e re e bënë rregulloren e re. Ka njerëz që thonë që duhet vetëm të perfeksionohet . Ka njerëz që thonë që është fundi dhe s'ka nevojë. Normalisht gjithë i kanë idetë e reja dhe të vetat, megjithatë ne për me qenë pak më serioz në trajtim në emër të gjithë kryesisë e kemi pruar një propozim Kuvendit. Dëgjuam vërejtjet e shefave të grupeve, në përjashtim të PDK-së se nuk e di kush ka folur në emër të shefit, por megjithatë dëgjuam dy- tri ide. Atëherë unë sot dëgjova tre shefat e grupeve pak a shumë e thanë të njëjtën gjë që ta pranojmë si lexim të parë të amendamenteve, në mënyrë që herën tjetër t'i aprovojmë në një korrigjim, në anën tjetër z. Haliti, unë dëgjova në bazë përgjithësisht çka tha që thirri për votim të përnjëhershëm. Nëse unë kuptoj mirë dhe dëgjoj mirë, pra nuk është propozimi i Halitit ajo që e qitni ju ,por është i grupeve parlamentare, nëse ai pajtohet mirë po unë them dëgjova , z. Haliti tha -S'kemi arsye të mos e votojmë në tërësi, kështu që vetëm ta kemi të qartë çka po votojmë. Kaq.

XHAVIT HALITI – Nuk i pranojmë diversionet brenda Grupit Parlamentar, sepse prej mëngjesit po dëgjojmë këso lloje llafesh që ne i kemi dy palë qëndrime. Unë mendoj që jam deputet dhe kamë të drejtë të flas në emër timin dhe në qoftë se flas në emër timin nuk e prishi mendimin e Grupit Parlamentar. Sido qoftë unë thashë se kam biseduar me propozuesin për ta shtyrë për të arritur konsensus. U dhanë mendime të ndryshme. U tha mendimi që duhet me kaluar përmes Komisionit Funkcional dhe unë e mbështeta mendimin. Nuk është me rëndësi a e kanë thanë grupet a kush, por e shpreha mendimin që meqenëse janë dy- tri çështje të cilat u diskutuan këtu a duhet me qenë apo nuk duhet me qenë. Duhet me u zgjat minutazhi apo nuk duhet me u zgjatë. Duhet me pas replikë apo nuk duhet me pas dhe nuk e di a pat tjetër vërejtje ku me dit se çfarë. Thashë se ta shtyjme për seancën e ardhshme dhe t'i votojmë këto vërejtje që u thanë. Në qoftë se vijnë me shkrim në emër të grupeve parlamentare, ose për mua nuk prish punë me e votuar edhe sot nuk kam kundërshtim. Propozimi im është që grupet parlamentare deri në seancën e ardhshme ,do të thotë pesë ditë para seancës së ardhshme ,t'i sjellin propozimet në emër të grupeve parlamentare dhe vërejtjet në amendamentet që kanë ardhur. Në qoftë ka, në qoftë se nuk ka, unë nuk e besoj që është në rregull që të votojmë tash a duhet interpelancë a nuk duhet interpelancë sot, a duhet me zgjat një minutëshin me bë dy apo tre minutash apo nuk duhet me e zgjat, sepse po bëhet tërkuzë edhe kjo rregullore.. Unë po insistoi në atë që të formojmë një komision për ta bërë rregulloren e re. Ne nuk kemi rregullore të Kuvendit. Kemi rregullore ,e cila i është përshtatur individit. Ju faleminderit.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Hydajet Hyseni, deputet.

HYDAJET HYSENI – Ju faleminderit z. kryetar, të nderuar deputetë.

Unë edhe një herë po i referohem amendamentit ose nenit të Rregullores që kërkon që për amendamentet e kësaj natyre për mocione kur janë amendamente kërkohet 8 ditë, nuk është përmbushur. Do të thotë ne jemi ashtu- kështu të obliguar që ta shtyjme shqyrtimin e saj, nëse nuk duam të gabojmë . E dyta për t'i miratuar ndryshimet në Rregullore ,siç janë quajtur në tekstin tuaj z. kryetar, e amendament janë quajtur në tekstin tjetër s'është e njëjta gjë duhet shumica e deputetëve të Kuvendit ndarja e votave, llogaritni çka do të thotë . E treta, ne kemi një praktikë si e theksojë shefi i Grupit Parlamentar të LDK-së sipas të cilës Kuvendi punon në seancë plenare dhe në

komisione. Nuk di pse duhet të bëhet për herë të dytë, edhe për kushtetutën është bërë dhe tash për herë të dytë është bërë dhe tash për herë të dytë bëhet përjashtim vetëm komisionin ndër çështjet legislative/ S'më prish punë, bëjeni, por duhet atëherë të aktivizohet Komisioni për rregullore, sepse e kemi pasur dijen këtu janë njerëzit dhe ai mund ta bëjë fare lehtë, por nuk ka asnjë logjik që të përjashtohet kjo mënyrë. Ne kemi pasur para dy jave debat dhe pse nuk ishte e paraparë e autorizuar komisionin përkatës që ta bëjë, pse mos ta bëjë të njëjtën gjë tash, çka ka të keqe këtu. Unë prandaj propozoj që propozimi që u dha të hidhet në votim dhe të ecim tutje. Në mbledhjen e ardhshme do ta kemi tekstin dhe është e vërtetë që shumica e propozimeve do të mbështeten, sepse po pajtohem, disa korrigjime duhet të bëhen dhe s'ka absolutisht të keqe dhe ecim tutje. Ju faleminderit zotërinj.

KRYETARI KOLË BERISHA – Ju faleminderit! Propozimin e shefit të Grupit Parlamentar të LDK-së z. Alush Gashit që të shtyhet për seancën e ardhshme të radhës dhe të plotësohet për amendamente e tjera, në qoftë se ka dikush ka vërejtje dhe kjo në këtë rast. Kryesia është sponsor i këtyre amendamenteve, ndryshimeve. Nga 77 deputetë që gjenden momentalisht në sallë,

Kush është për.....55,
Kush është kundër18.

Miratohet propozimi që për seancën e radhës të përgatiten amendamentet plotësuese. Ju faleminderit. Me kaq përfundon seanca.